

# Edukata familjare

Islam Dizdari  
Bahri Aliu





© L O G O S - A

2 0 0 7



S H K U P  
PRISHTINË  
TIRANË



Islam Dizdari  
Bahri Aliu



Edukata familjare



► Islam Dizdari  
► Bahri Aliu



► Edukata familjare

# Përbajtja:

<b>Parathënie .....</b>	<b>9</b>
<b>Hyrje .....</b>	<b>13</b>
<b>Objekti i pedagogjisë familjare .....</b>	<b>15</b>
<b>Vendi i edukatës familjare .....</b>	<b>15</b>
<b>Parimet e edukatës familjare .....</b>	<b>19</b>
<b>Disa nga parimet themelore të edukimit janë:.....</b>	<b>21</b>
<b>Edukimi i drejtë i fëmijëve është një veprimtari shumë më e lehtë se riedukimi .....</b>	<b>22</b>
<b>Marrëdhëniet e drejta familjare faktor me rëndësi edukimi.....</b>	<b>28</b>
<b>Autoriteti i prindit .....</b>	<b>37</b>
<b>Çfarë kuptojmë me autoritet të prindit? Ku e ka burimin? ....</b>	<b>37</b>
<b>A mund të ketë autoritet çdo prind? .....</b>	<b>39</b>
<b>Po cilin duhet të dëgjojë fëmija?.....</b>	<b>41</b>
<b>Autoriteti i shtypjes, i ndrydhjes së ndërgjegjes së fëmijëve .</b>	<b>42</b>
<b>Përbajtja edukatës familjare .....</b>	<b>45</b>
<b>1. Çfarë kuptojmë me përbajtje të edukatës familjare?.....</b>	<b>45</b>
<b>2. Pjesët përbërëse të edukatës janë të lidhura me njëra – tjetrën .....</b>	<b>46</b>
<b>Edukimi fizik .....</b>	<b>53</b>
<b>1. Rëndësia dhe detyrat e edukimit fizik .....</b>	<b>53</b>
<b>2. Cilat janë detyrat e edukimit fizik?.....</b>	<b>55</b>
<b>Regjimi ditor .....</b>	<b>61</b>
<b>Disa dukuri që vihen re .....</b>	<b>63</b>
<b>Edukata e punës i ka rrënjet në familje .....</b>	<b>71</b>
<b>1. Rëndësia dhe detyrat e edukatës së punës .....</b>	<b>71</b>

<b>2. Në familje vihen themelët e edukatës së punës .....</b>	<b>76</b>
<b>3. Disa këshilla për prindërit lidhur me edukatën e punës ....</b>	<b>78</b>
<b>Edukimi mendor .....</b>	<b>81</b>
<b>Detyrat e edukimit mendor .....</b>	<b>88</b>
<b>Disa probleme specifike të edukimit mendor në familje. ....</b>	<b>94</b>
<b>Sot vihen re disa dukuri që duhen pasur parasysh.....</b>	<b>101</b>
<b>Edukimi estetik .....</b>	<b>103</b>
<b>Detyrat e edukimit estetik .....</b>	<b>103</b>
<b>Krijimin e së bukurës nga vetë fëmijët.....</b>	<b>110</b>
<b>Edukimi moral.....</b>	<b>116</b>
<b>Brendia e edukimit moral.....</b>	<b>121</b>
<b>Marrëdhëniet e njeriut me shoqërinë.....</b>	<b>124</b>
<b>Metodat e edukimit .....</b>	<b>133</b>
<b>C'janë metodat dhe çfarë kuptojmë me mjete edukimi? .....</b>	<b>133</b>
<b>Metoda e bindjes .....</b>	<b>134</b>
<b>Kërkesa pedagogjike .....</b>	<b>136</b>
<b>Ushtrimi .....</b>	<b>141</b>
<b>Metoda e nxitjes dhe e frenimit .....</b>	<b>143</b>
<b>Frenimi dhe ndëshkimi .....</b>	<b>146</b>



## **Parathënie**

Kujdesi parësor në jetën e besimtarit, veçanërisht në jetën e atyre që Krijuesi u ka mundësuar të jenë prindër, është kujdesi për trashëgimtarët e tyre - fëmijët, se çfarë besimi, kulture, civilizimi dhe edukimi do të pranojnë për të jetuar në këtë botë me nderë dhe dinjitet njerëzor si besimtarë myslimanë. Angazhimi për edukimin e fëmijëve është kategori kurancore dhe obligim i traditës islame e kërkuar nga Muhammedi a.s., prandaj edhe përkushtimi ndaj këtij aktiviteti në jetën besimtare duhet të jetë parësor dhe i pa ndërprerë, aq me tepër në kohën tonë dhe në vendin, ambientin dhe situatën ekonomike e politike që e jetojnë besimtaret shqiptarë.

Prindërit duhet parë realitetin e kohës kur fëmijëve të tyre u ofrohen të gjitha mënyrat e jetës që nuk përkojnë me edukatën dhe kulturën islame. Atyre u ofrohet mënyra e jetës së ftohtë në emër të një kulture të dëmshme për jetën dhe ardhmërinë e tyre, me të cilën tentojnë që edukatën prindërore ta zëvendësojnë me jetën e lirë e të pakontrolluar, që edukatën e shenjtë islame ta zëvendësojnë me edukatën e rrugës, moralin profetik ta zëvendësojnë me moralin e të degjeneruarve etj. Të gjithë prindërit myslimanë ashtu si e kanë obligim t'i ushqejnë fëmijët e tyre, e kanë obligim hyjnor edhe të kenë koncept të edukimit të tyre. Ky koncept edukimi duhet të jetë i bazuar në Librin e shenjte – Ku'ranin, në Sunet-traditën e Pejgamberit, në mendimin e dijetarëve islamë

gjatë historisë, si dhe në mendimin e dijetarëve islam të kohës në të cilën jetojnë. Është njohur në historinë e njerëzimit se fëmija atë që nuk e merr, nuk e thith, nuk e sheh, nuk e pranon dhe nuk inspirohet nga prindërit, askund nuk do ta ndjejë në jetë.

Edukimi familjar islam nuk fillon me këtë libër te shqiptarët, por mund të themi se metodika shkencore-pedagogjike islame fillon me këtë libër i cili realisht është i bazuar në shkencën e edukimit islam. Nuk guxojmë që fëmijët tanë t'i bëjmë instrumente degraduese të familjes, fesë dhe traditës tone kombëtare kur dihet se norma më relevante në historinë tonë ka qene morali, bujaria dhe fisnikëria që e mbulojnë Besën Kombëtare dhe amanetin Islam. Kur islami u pranua në trojet tona, ai te ne gjeti moralin e lartë popullor, traditën e mbulesës, lidhjen e gjakut, marrëdhëniet fqinjësore të cilat i kultivoi edhe më shume në fryshtësinë islame. Megjithatë fatkeqësisht paraqiten mekanizma të ndryshëm antifetarë dhe antikombëtarë që angazhohen që këto virtute të larta tradicionale fetare dhe kombëtare t'i përkëmbin e në vend të tyre ta sjellin „Kulturën” e banalizuar, duke menduar se gjithçka mund të jetë kulturë me sjellje dhe qëndrime të pakufizuara individuale familjare dhe shoqërore. Duke devjuar ne edukimin e fëmijëve, arritëm që ta realizojmë mendimin e një rabini hebraik i cili thotë „Se mbjellja e ateizmit është fitorja fillestare e hebraizmit”.

Prandaj kujdesi prindëror për të shpëtuar fëmijët nga ateizmi është më se i nevojshëm dhe i domosdoshëm. Për fat të mirë të të rinxve besimtarë na paraqiten dy dijetarë - bashkautorë në kohen tonë Islam Dizdari dhe Bahri Aliu që të na ofrojnë një libër në të cilin e prezantojnë edukimin familjar bazuar në të vërtetën uranore dhe në traditën e Profetit për nevojën tonë në këtë jete.

“Edukata Familjare” e shkruar nga studiues dhe pe-

dagogë tē fesë islame na mundëson që ta kuptojmë dhe tē lidhemi pēr edukimin familjar islam pēr tē shpētuar vetveten dhe trashëgimtaret tanë nga ligësia e kësaj bote dhe e shoqërisë që na rrethon. Ky libër favorizon mendimin dhe qëndrimin islam se familja është e shenjte dhe nē rrugë tē tillë duhet tē drejtohet edhe fëmija që është krijesa më e mire e dhuruar nga Perëndia. Prandaj duhet tē kujdesemi shumë, ngase këtë edukim njeriut ia ka besuar Krijuesi.

Autorët Islam Dizdari dhe Bahri Aliu nē ményrë shumë islame, shumë tē kulturuar dhe shumë bindëse përmes materialit tē prezantuar nē libër na jepin tē kuptojmë se çka do tē thotë tē jesh prind me obligime islame dhe si mund tē edukosh një fëmijë dhe një familje me edukatë fetare islame.

E veçantë nē këtë libër pēr mendimin tim është kapitulli “Edukimi Estetik” që është vështirë ta gjejmë nē ndonjë libër fetar deri tash tē shkruar nē gjuhën shqipe, kuptohet duke mos e nënçmuar edukimin fizik, mendor, moral, edukatën e punës etj. Sa i takon anës estetike e cila është më se e nevojshme nē kohën nē tē cilën jetojmë besoj se plotësohet dhe prezantohet një virtyt shumë i lartë i Muhammedit a.s i cili e ka aplikuar dhe i ka dhënë peshë anës estetike tē personalitetit profetik. Estetika si virtyt profetik realisht gjatë historisë te myslimanët e këtyre trojeve nē një ményrë apo tjetër është neglizhuar. Kështu me këtë libër do tē na mundësohet ta kuptojmë estetikën islame që tē kemi besimtarë reprezentativ me prezantim tē vërtetë islam.

Me leximin e këtij libri lexuesi do tē mund ta realizojë thënien kuranore “*O besimtarë! Ruajeni veten tuaj dbe familjen tuaj nga zjarri i xbebenemit...*”

*Mr. Ruzhdì Lata  
Myfti i Dibrës Madbe*



## Hyrje

Në kushtet e sotme problemet e edukimit dalin gjithnjë e më shumë në plan të parë. Tashmë si shoqëria, ashtu edhe familja po e kuтоjnë seriozisht se krahas nivelit ekonomik dhe mirëqenies, krahas arsimimit dhe punësimit të breznive të reja, po duket qartë domosdoshmëria e një preokupimi serioz dhe me pikësynime të qarta edhe për problemet e edukimit. Aq më tepër se edhe vetë bërtama bazë e shoqërisë, familja, ka pësuar shumë të çara dhe është lëkundur mjaft këto vitet e fundit. Familja shqiptare nga dita në ditë po pëson tronditje serioze, që vijnë si rrjedhojë e një mendjelehtësie për të përvetësuar ato forma jetese, gjoja përparimtare dhe të emancipuara që na i servir bota e huaj perëndimore, pa marrë aspak parasysh traditat tona, kushtet tona dhe mundësitë tona. Vini re gjymtimet e familjeve, kur një pjesë e madhe e të rinjve janë në mërgim, vini re ndarjet e dhunshme të burrave nga gratë, të baballarëve nga fëmijët, qoftë edhe për arsyen ekonomike, vini re divorcet e shumta, martesat e mitura, pa përmendur këtu plagët e rënda të prostitucionit, të drogës, të alkoolizmit dhe të shumë sëmundjeve tjera shoqërore, që në radhë të parë prekin e dëmtojnë familjen. Janë pikërisht këto arsyen që na shtyjnë ta trajtojmë këtë problem, jo thjesht për të prekur plagën që është majisur dhe na dhëmb fort, por për të kërkuar ato mundësi shërimi që janë të domosdoshme.

Asnjë këshillë nuk vlen për këtë si mjet shpëtimi. Çdo rast është një dukuri më vete specifike dhe do të zgjidhet

nga vetë ajo familje, nga vetë ai prind, nga vetë ai fëmijë që po rritet dhe është futur në rrugën e vështirë të jetës. Traditionale edukative familjare, përvoja e shkollës, mjetet e shoqërisë janë të shumta, por përfat tonë të keq për një kohë të gjatë këto u ndanë, mohuan dhe nënveftësuan e madje përcmuani mjetet që na ofron besimi, feja jonë Islame. Në shumë raste edukata familjare e në përgjithësi edukata shoqërore me të gjitha mjetet që ajo ka në dispozicion, iu kundërvu edukatës fetare dhe traditës që ajo kishte kriuar, e luftoi dhe në vend që të merrej me zgjidhjen e problemet edukative që po krijuhet, luftonte ndikimin e traditave dhe të riteve fetare aq të dobishme në fushën e edukatës së fëmijëve. Ky problem nuk është kapercyer, gjallon edhe sot e kësaj dite. Puna që bën p.sh Medreseja, propaganda dhe kultura fetare nënçmohet e madje në shumë raste është në kundërshti me një tendencë gjoja liberalizimi që duket sot në familjen, në shoqërinë dhe në kulturën shqiptare e që përfat tonë të keq është institucionalizuar edhe nga mjetet shtetërore të edukimit. Vini re sjelljen morale të të rinjve, qëndrimin ndaj së mirës dhe së keqes e dukurive tjera të ndjenjave dhe cilësive morale, vini re veshjen dhe paraqitjen e jashtme të breznive të reja e sidomos të vajzave, qëndrimin ndaj alkoolit, ndaj duhanit, ndaj sjelljes qytetare, ndaj të të moshuarve e ndaj familjes në përgjithësi, vini re ashpërsinë dhe intolerancën e njerëzve e sidomos të meshkujve në veçanti. Të gjitha këto e shumë të tjera si këto e kanë trënjën në edukatën familjare që do ta kemi objekt tonin. Qëllimi është t'u vijmë në ndihmë prindërve. Ata mund të janë edukatorë të mirë, ata mund të bëhen edukatorë të mirë. Kjo edhe fitohet në praktikën e jetës. Sot ka një mungesë të theksuar informacioni në këtë fushë, prandaj ne po lëshojmë një rrëze drite duke synuar që problemet e edukatës familjare t'i trajtojmë në aspektin pedagogjik dhe në mënyrë të organizuar.

## **Objekti i pedagogjisë familjare**

Pedagogjia familjare si degë e pedagogjisë së përgjithshme ka një objekt të gjerë. Ajo përfshin problemet e përbajtjes së edukatës në familje, parimet e organizimit të saj, mjetet, metodat dhe format e punës edukative, lidhjet e familjes me të gjitha mjetet e institucionet edukative, veçoritë e punës edukative, kërkesat ndaj prindit si edukator etj. Familja është një organizëm edukativ që i zgjidh detyrat e veta të posaçme duke bashkëvepruar me të gjitha mjetet tjera që ka në dispozicion shoqëria.

## **Vendi i edukatës familjare**

Në mendimin pedagogjik botëror ka pikëpamje të ndryshme lidhur me vendin që zë edukata familjare dhe për rolin që luan ajo në të gjithë sistemin e edukimit të brezit të ri. Dy janë pikëpamjet themelore:

*Drejtimi i parë*, e ngre rolin e edukatës familjare mbi të gjithë faktorët tjerë duke theksuar se interes i prindërve dhe i familjes në edukim është parësor dhe determinues, madje arrihet deri në atë shkallë sa të minimizohet roli i shkollës dhe i institacioneve tjera. Edhe në vendin tonë ka tendenca të tillë për të shhangur në një farë mënyre rolin e shkollës, mësimin në kushtet e klasës me mësimin individual të organizuar në shtëpi nga prindi apo nga mësues privatë. P.sh. Ka filluar në mënyrë disi masive mësimi i gjuhë-

ve të huaja me mësues privatë, në shumë raste edhe paralelisht me atë që bëhet në shkollë. E jo vetëm për gjuhët e huaja, por edhe për disa lëndë si matematika etj. Natyrisht shkalla e lartë e interesimit të prindit për ngritjen kulturore të fëmijëve është një tendencë shumë e dobishme, por nuk mund të shkojë në drejtim të kundërt me shkollën, ta nënqleftësojë dhe ta minimizojë rolin e saj. Kemi vënë re që hapen kurse për mësimin e besimit dhe të arabishtes. Një gjë shumë e dobishme. Por nuk e kuptojmë se si në këto kurse ka edhe nxënës të Medresesë, të cilët zhvillojnë një program shumë të gjerë dhe marrin njohuri të plota në vartësi me programin mësimor duke i kapërcyer shumë herë ato të kurseve fillestare. Në aspekte tjera të edukimit kjo tendencë është edhe më e dukshme. P.sh. në fushën e edukimit moral. Në disa fusha të edukatës prindi dhe familja i kundërvihen shkollës dhe madje edhe shumë mjeteve tjera të komunikimit masiv. Kjo jo thjesht për dobësi të përbajtjes së punës së këtyre institucioneve, por në kundërshti, në mospërputhje konceptesh dhe pikëpamjesh.

**Drejtimi i dytë**, përpinqet ta minimizojë rolin e familjes dhe të mbivlerësojë edukimin jashtë ndikimit të prindërve. P.sh. vlerësohet ndikimi i mikromjedisit, si ai i shoqërisë së rrugës, shokët e shoqet e fëmijës. Disa të tjerë vlerësojnë rolin e shkollës dhe të mësuesve si specialistë të punës edukative me fëmijët etj. etj. Jo vetëm moralisht, por edhe ligjërisht, gjithnjë edhe sot prindi përgjigjet për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve. Tagret e prindit e të familjes për mirërritjen e fëmijës do t'i trajtojmë më poshtë, por këtu duam të theksojmë se në shumëlojshmërinë e faktorëve që ndikojnë në edukimin e breznive të reja, familja është një faktor shumë veprues dhe se në etapa të veçanta të moshës së fëmijëve dhe për probleme të veçanta luan një rol vendimtar. Kjo shpjegohet po të kemi parasysh disa arsyet:

*Së pari*, kur familja ngrihet mbi baza të shëndosha, kur krijohet një atmosferë e shëndoshë familjare me marrëdhënie të drejta mes pjesëtarëve të saj, e sidomos mes nënës e babës, fëmijëve dhe prindërve; kur ekziston rregulli dhe respekti në marrëdhëni mes pjesëtarëve të familjes, kur ndërgjegjja e prindit për edukimin e fëmijëve është e një shkalle të lartë e kjo shoqërohet me rritjen e interesit për edukim e me kujdesin e nevojshëm në këtë fushë, natyrisht e shoqëruar me traditën e mirë familjare, me kulturën dhe përvojën e nevojshme, me nivelin e kënaqshëm material dhe komfortin familjar. Në të gjitha këto rrethana edukimi i fëmijëve në familje gjen kushtet e përshtatshme dhe niveli i punës tritet e si rrjedhim frytet nuk vonojnë të duken. Shtysat e para dhe shpeshherë vendimtare në fushën e edukatës fëmija i merr në familje.

*Së dyti*, familja ka përparësi në disa fusha dhe drejtime të edukatës, sepse ka kushte shumë të natyrshme edukative. Bashkëjetesa, marrëdhëni mes prindit dhe fëmijës, lidhjet e gjakut krijojnë kushte për një afërsi të natyrshme mes pjesëtarëve të familjes. Si rregull kjo afërsi ruhet për të gjithë jetën, prandaj autoriteti i drejtë, interesimi i prindit, përvoja jetësore dhe dashuria prindërore bëhen një faktor shumë i rëndësishëm ndikues në edukatë.

Në arsimimin dhe në formimin e përgjithshëm të fëmijëve shkolla luan rol kryesor dhe drejtues me planet dhe programet e veta mësimore. Roli i familjes në këtë drejtim padyshim është ndihmës. Por në edukatë ka pamje të tilla, ku përparësia e prindit dhe e familjes dalin në pah më shumë se shkolla. Në edukimin filletar shëndetësor dhe fizik familja dhe posaçërisht nëna është e pazëvendësueshme, gjithashtu në edukimin e disa cilësive morale. Në një hadith Hazreti Muhammedi a.s shprehet: “Nën këmbët e nënës është Xhenneti”. Nëna me dashurinë e saj që e ka burimin tek amësia, i mëkon fëmijës së vet së bashku me

qumështin e gjirit ndjenja të tilla, si butësia, dashuria, mëshira, zemërgjerësia, dhembshuria etj. Ajo i drejton fëmijët në rrugën e vështirë, por të sigurt, drejt Xhennetit.

Me të drejtë poeti shprehet:

*Me se rrojnë fosnjat, ç' i rrit çilimijtë?  
Dashuri e mëmës dbe përkëdhelitë.*

Po kështu ngjet në zhvillimin fillestar intelektual dhe të aftësive për të folur. Cila shkollë mund ta zëvendësonte familjen në përpjekjet e para për belbëzim që zhvillohen tek fëmija? Fëmija futet në klasën e parë me një sistem të plotë zhvillimi të aftësive shprehëse gjuhësore. E natyrisht shkolla këto i mbreh dhe i përpunon në të gjitha strukturat e veta. Më shumë se në familje nuk mund të luftohen disa vese të këqija si parazitizmi, përtacia, kryeneçësia, etj. Një fëmijë që nuk merr në familje shprehitë e para për kulturën dhe disiplinën e punës, do të vuaj tërë jetën, sepse edhe disa veprime krejt të thjeshta, që dikush i kryen me një frymë, atij do t'i duken tepër të rënda e të mërzitshme. E mendoni se ka plot fëmijë deri në një moshë relativisht të lartë shkollorë që nuk dinë të ushqehen, të vishen e të mbathen vetë, e jo më të kryejnë punë të tjera për veten e të tjerët. A nuk bëhen të bezdissħem disa djem që edhe pér gjérat më të thjeshta kërkojnë gjithnjë shërbimin e nënës dhe të motrës së vet?

*Së tjetri*, puna edukative në familje ka vazhdimësi më të madhe në krahasim me çdo mjet tjetër edukimi. Ndikimi i saj fillon që në moshë të njomë, kur hidhen themelët e edukatës, vazhdon gjatë të gjithë periudhës që fëmijët ndjejin shkollën, madje edhe më vonë. Në kushte të tilla puna e prindit ka vazhdimësi më të madhe se sa puna e mësuesve dhe e edukatorëve të çdo kategorie shkolle.

## Parimet e edukatës familjare

Fëmijët janë dhungi nga All-lahu xh. sh. Pra këtë dhungi prindërit duhet ta kenë emanet të cilin duhet kultivuar, duhet edukuar, duhet përgatitur për jetën që ata i pret. Mu për këtë All-lahu xh. sh. Prindërit i urdhëron: “*O ju që besoni! Ruani veten dbe familje tuaja nga zjarri, karburante (lëndë djegëse) të të cilit janë njerëzit dbe gurët, dbe të cilin e mbi kqyrin engjëjt e fuqishëm dbe të ashpër, të cilët nuk u kundërshtojnë urdhërave të Perendisë dbe të cilët punojnë për atë që urdhërohen.*” (Kuar’ani: Tahirim, 6)

“*Është dëshirë e përjetshme e baballarëve të shobin të realizuar tek bijtë e vet dy jetë, atë që u takon vetë bijëve dbe atë që kanë lënë pa realizuar në jetë vetë baballarëf*”, -thotë shkrimtari dhe filozofi i shquar gjerman **Gëte..** Pikërisht këtu qëndron edhe thelbi i edukatës familjare, parimet themelore të saj. Detyra kryesore e kësaj edukate është tritja dhe edukimi i mirë i fëmijëve. Të rinxve u takon e ardhmja. Ata do të jetojnë në periudha më të përparuara, prandaj edhe duhen përgatitur më mirë, duhen aftësuar për të përballuar detyrat dhe punët e së ardhmes që do të jenë gjithnjë e më të vështira, sepse zhvillimi e përparimi kërkon njerëz më të aftë. ‘*Përgatitini fëmijët tuaj, mësojini fëmijët më mirë se ju, sepse atyre u takon e ardhmja*’,-na mëson poeti ynë, **Naim Frashëri**.

Fëmijët do të jenë qytetarët e ardhshëm të vendit, ata do të jenë nënët e baballarët e rinx. Fëmijët tanë janë edhe shkopi i pleqërisë. Edukimi i mirë i tyre janë edhe pleqëria jonë e lumtur. A ka kënaqësi më të madhe sesa të kesh fëmijë të denjë, trashëgimtarë të devotshëm të traditave më të mira të besimit islam, të familjes dhe të prindërve? Nga tradita Pejgamberike e **Hazreti Muhammedit** a.s. mësojmë: ”*Fëmijët e edukuar mirë janë një kapital i madh dbe pasuria më e mirë. E kush ka fëmijë të miredukuar nuk duhet t’i frikësobet var-*

*férise nē pleqérinē e vet. Fémijét e rritur tē edukuar janē pensioni mē i mirē".* Pér këtë ai éshtë kujdestar i ngarkuar me shumë pér-gjegjësi. Pejgamberi ynë na mëson: "Tē gjithë ju jeni barinj dbe tē gjithë ju do tē pyetet pér kopenë tuaj; sunduesi éshtë bari dbe do tē pyetet pér kopenë e vet; njeriu éshtë bari nē familjen e vet dbe do tē pyetet pér kopenë e vet; gruaja éshtë bareshë nē shtëpinë e burrit fē vet dbe do tē pyetet pér kopenë e vet..." Pérndryshe rezultatet do tē janë tē dyshimta, sepse fémijét e edukuar keq janë hidhërimi ynë. A ka fatkeqësi mē tē madhe se sa tē kesh fémijë tē edukuar keq? Mendoni sa lot derdhin ato nëna, kur shohin tek bijtë e vet sjellje tē padenja. Çdo njeri mund tē gabojë, madje edhe mund tē bëjë një punë keq, por e kuption gabimin dhe e ndreq atë. Po mendoni tē edukosh keq një njeri, sesa e vështirë éshtë, nē mos e pamundur tē ndreqet. Disa vese tē këqija, një karakter i keq duan pérpjekje tē mëdha pér t'u riedukuar. Edukimi i keq nuk éshtë vetëm hidhërimi i pleqërisë, por edhe përgjegjësi para All-lahut xh. sh. xh.sh., para njerëzve tē tjerë, para shoqërisë, para at-dheut, prandaj edhe ka norma morale e detyrime ligjore para prindit. Ata janë përgjegjës pér mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve tē vet.

Baballarët, prindërit kanë pérvojë tē gjatë jetë, kanë kluar shumë prova, kanë pasur suksese nē jetë, por edhe dështime, prej tē cilave kanë nxjerrë shumë mësime, prandaj edhe, kur shohin një veprim tē gabuar nē jetën e fëmijëve tē vet, ata mundohen e pérpiqen t'i mbrojnë nga e keqja, nga dështimet, pérpiqen t'i këshillojnë, t'i urdhërojnë e t'i ndalojnë pér tē mos rënë nē vorbullën e jetës, grushti goditës i së cilës shpesh éshtë i rëndë dhe ka peshë tē difishtë pér këtë jetë dhe pér nē amshim. Prindërit jo rrallë janë tē pakënaqur nga qëndrimet dhe veprimet e bijve, prandaj edhe ka mospérputhje e kundërshti mes brezit tē vjetër dhe brezit tē ri, mes etërve dhe bijve. Nuk duhet harruar se bijtë kanë jetën e vet, ata kërkojnë ta jetojnë dhe tē

formojnë përvojën e vet në rrymat e jetës. Nuk duhet harruar se ndonjëherë kujdesi i tepruar i prindërve kthehet në një tutelë që shpesh herë paraqet tregiqë. Prindi në emër të edukimit i fut fëmijët, si të themi nën sqetull, i mëkon, ua shtron rrugën e ata rriten si në serat e ngrohta. E, sa fillojnë të dalin në ajër të pastër thyhen nga vështirësitë më të vogla. Një gjë ka rëndësi, fëmija që në moshën më të njomë duhet të stërvitet të masë forcat e veta, duhet të dijë sesa është i zoti të bëjë, sa i vlen lëkura.

## **Disa nga parimet themelore të edukimit janë:**

- *Edukimi i drejtë është një veprimtari shumë më e lebtë sesa riedukimi.*
- *Prindi është përgjegjës për edukimin e mirë të fëmijëve.*
- *Të formohen marrëdhënie të drejta familjare midis burrit dbe gruas, midis prindit dbe fëmijës, midis të moshuarve dbe të të rinjve.*
- *Krijimi i një atmosfere të shëndoshë edukative në familje.*
- *Organizimi i mirë i jetës në familje.*
- *Takti i mirë dbe autoriteti i drejtë i prindit janë faktorë me rëndësi në edukimin e fëmijëve.*
- *Përpunimi dbe zgjedhja e metodave të edukimit në familje duhet bërë me kujdes e në përshtatje me vëçoritë e fëmijëve.*
- *Kultura familjare dbe traditat e mira të edukimit kanë vlerën e vet në edukim.*

Të gjitha këto probleme do të trajtohen veçanërisht, por ne këtu sa i përmendëm.

## **Edukimi i drejtë i fëmijëve është një veprimtari shumë më e lehtë se riedukimi**

Pejgamberi **Muhammed** a.s na ka këshilluar që t'i edukojmë mirë bijtë tanë, sepse kjo do të jetë dhurata më e çmuar për ta. Për këtë në një hadith thuhet: "Babai nuk mund t'i dburojë asnjë më të bukur fëmijës së vet sesa edukatën e mirë", ndërsa shoku i ditur i Muhammedit a.s., **Abdullahu, i biri i Omerit** r.a. thotë: *Edukoje bukur birin tënd, sepse për të je përgjegjës sesi e ke edukuar dhe me çka e ke edukuar.*

Edukimi i fëmijës fillon shumë vite para lindjes së tij, madje Pejgamberi ynë i nderuar thotë se edukimi i tij fillon 20 vjet para lindjes. E kjo lidhet me të gjitha përgjegjësitë dhe kushtet familjare në fushën e edukatës që nuk krijohen për një çast, por janë një vazhdimësi hall-kash të pafund, të ndërlidhura fort njëra me tjetrën në të gjithë traditën e mirë të edukatës familjare. Çdo gabim apo pakujdesi në një hallkë të këtij procesi të pandërpër-rë krijon shumë vështirësi e pengesa që shpesh janë tēpër të vështira të kapërcehen. Nga këto kuptohet lehtë se edukimi mund të jetë i drejtë, por edhe i gabuar. Çdo fëmijë lind i pastër, i papërlyer nga asnjë ide apo mendim, ai lind i paqtë, islam, por është në dorën e nënës, të familjes apo edhe të shoqërisë që ai të jetë i mirë apo i keq, të përqafojë njérën apo tjetrën ideologji, njérën apo tjetrën fe. All-llahu xh. sh. Në Kur'ani kerim thotë: "Drejtobu me përkushtim në fenë e drejtë, krijimtarinë e Perëndi-

*së, sipas të cilit Ai ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim në krijimtarinë e Perëndisë. Kjo është fe e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.*" (Kur'ani: Rum, 30). Në lidhje me këtë Muhammedi a.s. thotë: "**Fëmijtë lindin në fitren (parakushtin natyror të pastër të Islamit). Gjatë zhvillimit të tyre prindërit i bëjnë të jenë hebrenjë, të krishterë ose zjarputist.**" Që në fëmijërinë e hershme, madje, që apo lind fëmija duhet treguar i gjithë kujdesi dhe interesimi i duhur për mirërritjen dhe edukimin e tij. Në këtë mes nëna është themeli i dukatës. Por shpesh vetë nënët me kujdesin e tyre të tepruar, me dashurinë e dhembshurinë e tyre bëhen shkak që fëmija të fitojë disa shprehi negative që është tepër vështirë të korrigohen. Po sjellim ndonjë shembull. Pedagogu i famshëm **Rusoi** në veprën e vet "**Emili**" thotë se ...*dhurata e parë që prindërit u bëjnë fëmijëve, janë bekurat*. E vërtetë, është bërë zakon që nënët e reja, që para lindjes përgatitin pelenat dhe kondakët me të cilët i mbështjellin dhe i lidhin foshnjat që mbas banjës së parë. A nuk keni vënë re sesa kënaqësi ndien fëmija kur lirohet nga gjithë ata vargoj që e kanë shtrënguar për disa orë, si shpihet e kënaqet duke i gjuajtur me këmbë e me ato duar të vogla? A nuk i keni vënë re nënët e gjora duke i marrë mbrapa fëmijët e vet me pjatë në dorë për t'ua mëkuar ushqimin? A nuk keni vënë re sa e sa fëmijë që, kur vjen koha të shkojnë në shkollë presin të kenë çdo gjë gati, edhe ushqimin, edhe rrobat, edhe këpucët, madje shpeshherë edhe librat e fletoret? Nënët shpeshherë i mbysin fëmijët me dashurinë e kujdesin e tyre të tepruar. Dhembshuria dhe sakrifica janë dy virtute të rralla që burojnë nga amësia, por edhe këto duhet të jenë me masë. Çdo nënë dëshiron ta ushqejë sa më mirë foshnjën e vet, por edhe për këtë ka një këshillë: mos e teproni! Çdo mjek i këshillon nënët e reja që t'i ushqejnë foshnjat në një orar

të caktuar e, sidomos natën ato nuk duhet t'u japin të pinë. Këtu nuk po flasim për arsyet higjenike mjekësore, por ka edhe ndonjë arsyet që tjetër po kaq me rëndësi. Nëna është e lodhur gjatë ditës, natën duhet të pushojë, të rimarrë forcat, sepse e pret një ditë e re plot punë. Ajo vetë duhet të jetë e qetë, që të ketë qumështin e mjaftueshëm për foshnjën e vet. Po ç'ngjet në fakt? Ajo nga kujdesi dhe dhembshuria e tepruar për fëmijën, apo lëviz ai apo, apo nxjerr zë, e merr në dorë dhe i jep gji. Fëmija që i vogël ka nevojë për një regjim të caktuar ushqimi, pastrimi, banjoje e aq më tepër gjumi e pushimi. Janë vetë nënët që ua prishin fëmijëve mundësinë e krijimit të këtij regjimi.

Edukimi i drejtë i fëmijëve është një veprimtari normale, nuk është një punë dhe aq e vështirë sa u duket shumë prindërve. Këtë mund ta bëjë çdo njeri, çdo nënë e çdo baba. Kjo bëhet lehtë, nëse duam ta edukojmë vërtetë, nëse i përkushtohemi kësaj pune në çdo moment të jetës së fëmijës, nëse e bëjmë vazhdimisht e njëlloj, me kërkesa unike e të vazhdueshme. A nuk shihni në shtëpitë tuaja që njëri e ndalon ose e urdhëron e madje edhe e dënon, e tjetri e miklon dhe e përkëdhet? A nuk shihni shumë nëna që tashti i kërcnohen e në të njëjtën kohë e rrrokin dhe e puthin fëmijën?

Fëmijët duke qenë të paaftë e nën kujdesin e vazhdueshëm të prindërve dhe të të rriturve në familje "*ulin në gjunjë gjigantëf*" e kështu, pak e nga pak me paaftësinë e tyre e me pamundësinë e tyre mësohen të hanë me lugën e të tjerëve dhe u hipin në qafë të rriturve. A nuk shihni shumë fëmijë që duke ua kuptuar debulesën prindërve bëhen tiranë mbi to, kërkojnë t'u plotësohen tekat? Nuk mund t'i bërtas, -thoshte një nënë, -sepse fëmija merr vaj dhe e nxjerr tërë ushqimin. Kurse në të vërtetë fëmijët shumë herë shtihen e shkrehen në vaj vetëm që t'u

plotësohen tekat.

Në qoftë se fëmija nuk është edukuar drejt, nëse ju ka rrëshqitur diçka, nëse jeni munduar pak për to ose edhe jeni dembelosur, e keni lëshuar fëmijën, atëherë shumë gjëra duhet të ndryshohen e të ndreqen. Mirëpo ndreqja, riedukimi nuk është një punë edhe aq e lehtë. Riedukimi kërkon edhe më shumë forca, më shumë njo-huri, por edhe më shumë durim. Për fat të keq jo të gjithë prindërit i kanë këto. Riedukimi është një punë jo vetëm e vështirë, por sjell edhe më shumë kokëçarje dhe pakënaqësi tek prindërit, jo rrallë ua prish atyre qetësinë, ua acaron nervat e madje ndikon për keq në harmoninë familjare. Zënkat e shqetësimet familjare rrjedhin në shumë raste nga sjelljet e këqija të fëmijëve. Prindërit akuzojnë njëri-tjetrin për dobësitë e fëmijëve.

Pedagogët e të gjitha kohëve theksojnë që prindërit duhet të përpiqen gjithmonë që t'i edukojnë fëmijët në atë mënyrë që mos t'u qëllojë më vonë të ndreqin asgjë, që në fillim gjithçka të jetë bërë drejt. Populli e shpreh shumë bukur vështirësinë në edukim: "Me çue një fëmijë në kambë, asht si me çilë një pus me gjylpanë". Edukimi i fëmijëve kërkon shumë sakrifica dhe një interesim të vazhdueshëm nga prindërit. **Pestaloci** i shkruan një mikut të vet për punën që bënte me jetimët në shkollën e tij: *Më së pari më dubej të fitoja besimin dhe dashurinë e fëmijëve; zemra ime ishte dhënë mbas tyre, lumturia e tyre ishte lumturia ime, gëzimi i tyre ishte gëzimi im, këtë fëmijët dubet ta shibnin që nga mëngjesi e deri në mbrëmje në ballin tim e në buzët e mia. Prej mëngjesit e deri në darkë vonë isha gjithnjë me ta, lotët e mi rriddin me lotët e tyre; kur ishin mirë nga shëndeti, unë isha në mes tyre, kur sëmureshin, nuk ndahesha prej shtratit të tyre. Në mbrëmje isha i fundit që bija të flija e në mëngjes i pari që ngribeshë. Vini re çfarë zemre e çfarë zelli.*

Edukimi është i lehtë, kur bëhet çdo ditë, çdo orë,

çdo minutë, në çdo rast, në çdo rrethanë, pa nënvleftë-suar asgjë, natyrshëm, me durim e me këmbëngulje, duke sakrifikuar nga pak, por pa ankesa e pa lavdërimë. Në fund të fundit për fëmijët tanë punojmë e lodhemi. E do të jetë shumë e vështirë në rast të kundërt jo vetëm shumë e vështirë, por edhe me plot andralla e dështime që krijojnë shqetësimë të pafund.

Këto vështirësi rriten në ato familje ku ka mungesë harmonie mes prindërve e sidomos në familjet e divorcuara. Lidhur me këtë janë shumë aktuale fjalët e Muhammedit a.s. "Veprat e lejuar më e urrejtur tek All-llahu është divorci". Jeta është plot zigzage, në familje mund të ketë edhe mosmarrëveshje, ndodh që prindërit të ndahen nga njeri-tjetri, por pavarësisht nga kjo është fatkeqësi shumë më e madhe braktisja e fëmijëve ose ç'është më keq zënkat në sy të fëmijëve. Është shumë e padrejtë, madje e dhimbshme që prindërit, pa marrë parasysh asnje normë morale flasin për partnerin, burrin apo gruan e ndarë një mijë të këqija. Mendoni se çfarë pasojash kanë këto fjalë të hedhura pa kujdes për fëmijët që dëgjojnë e ndjejnë çdo gjë që ngjet në familje. Shumë herë dëgjohet shprehja që prindërit janë gati të sakrifikojnë gjithçka për fëmijën e vet, por, kur vjen puna që të jenë pak më delikatë në marrëdhëniet bashkëshortore, ata e harrojnë zotimin. Në qoftë se prindërit i duan vërtetë fëmijët dhe synojnë t'i edukojnë sa më mirë, në emër të kësaj dashurie, për hatër të fëmijëve të vet duhet që të përpiqen që mosmarrëveshjet dhe kontradiktat të mos i thellojnë, të mos e çojnë perin deri në të këputur, sepse në këtë mënyrë, veç tjerash do t'i vënë fëmijët e vet në pozita shumë të vështira. Pra në këto raste bile së paku nuk duhet harruar porosinë hyjnore të All-llahut xh. sh. xh. sh. "Meshkujt udhëheqin (dhe përkujdesen) për gratë, Perëndia i ka graduar (meshkujt) me disa cilësi (si fuqia fizike

*e tyre) mbi ato, - dbe, meqë ata shpenzojnë pasurinë e tyre (për furnizim). Gra të mira janë ato që i përulen (Perëndisë), ruajnë fshehtësitë (sekretet), që ka urdhëruar Perëndia. E, për ato gra që i droni përkushtimit (të tyre), - këshilloni ato, bojkotoni në shtrat dbe rrithni ato (lehtas. Si p. Sb. Me brushë të dhëmbëve...). E nëse ato ju bindën, atëherë mos ndiqni kundër tyre kurrfarë rruge (mos ua kujtoni gabimet). Se perëndia, me të vërtetë, është i lartësuar dbe i madhëruar!" (Kur'ani: Nisa, 34) në lidhje me komentin e këtij ajeti Pejgamberi a, s. Ka thënë: "**Më e mira e grave, është ajo grua, të cilën kur e shikon të gëzon, kur e urdhëron për ndonjë gjë bindet. Kur nuk gjendesh pranë saj, ajo ruan pasurinë tënde.**" Nga ajeti i sipërpërmendur dhe hadithi nuk duhet kuptuar vetëm ruajtjen – përkujdesjen materiale por duhet kuptuar edhe fshehtësitë e tyre familjare, morale etj.*

Për fat të keq në shumë familje vihet re një mungesë e theksuar preokupimi për edukimin e fëmijëve. Mos mendoni se çdo gjë bëhet vetvetiu. Kur gabon fëmija apo bën një faj, në vend që prindi të preokupohet seriozisht, e kalon lehtë, mendon se fëmija është i vogël dhe i bën lëshime. Pastaj shpesh prindi çuditet kur gjërat trashen e fëmija pak nga pak rrëshqet. Prindi duhet ta ketë të qartë se çfarë duhet të edukojë tek fëmijët e vet, duhet t'i ketë të qarta synimet dhe dëshirat në këtë fushë. Mendojeni njëherë mirë këtë çështje dhe do të shihni sa shumë gabime keni bërë e sa shumë shtigje të reja e të drejta keni përpara. Mos harroni, ju jeni bari në familjen tuaj.

## **Marrëdhëni e drejta familjare faktor me rëndësi edukimi**

Çdo njeri është në lidhje e marrëdhënie trepalëshe: me vetveten, me shoqërinë dhe me All-llahun xh.sh. Marrëdhëni e familje duhen parë si një aspekt i tyre, prandaj edhe problemin në fjalë duhet ta shohim në tre aspekte:

*Së pari*, njeriu është në lidhje e në marrëdhënie me vetveten. Në mendimin pedagogjik ky problem është aq i vjetër sa edhe vetë edukata. Një pedagog i shquar thotë: "S'është gjë më e rreptë dhe më e vështirë se sa të luftosh me veten, por s'është fitim më i bukur e ngadhënjam më i madh, sesa kur njeriu e mund veten". Kur doherë në thellësinë e ndërgjegjes lufton e mira me të keqen, e drejta me të padrejtën, gjithnjë janë në luftë kërkuesat biologjike me arsyen, me ndërgjegjen, trupi me shpirtin. Sa herë bëjmë një veprim të gabuar apo sillemi në mënyrë jo të drejtë kemi breje të ndërgjegjes, kuptojmë gabimin apo fajin dhe përpinqemi të ndryshojmë e të vihemë në rrugë të drejtë. Mjafton një gabim i vogël e pa rëndësi në dukje që t'ia ndryshojë rrjedhën e qetësinë e jetës një njeriu. Shkurt, jeta e njeriut kalon gjithnjë në një rrugë plot zigzage në mes të asaj që është e lejuar dhe asaj që është e ndaluar. E kush mësohet që në fëmijëri të llogarisë e të mbasë sjelljet e veta, arrin të përmirësohet e të ecë përpara në fushën e një edukatë gjithnjë e më të

shëndoshë ose, ruana Zot, mund edhe të ngjasë e kundërta, zhytet thellë e më thellë në plotësimin e epsheve e të nevojave të veta biologjike e në këtë rast ka pak ndryshim nga kafshët, madje edhe më keq, ai mund të bëhet një egërsirë e vërtetë, një kriminel.

Njeriu është i lirë aq sa edhe është zot i vetvetes. Njeriun e ka krijuar All-llahu xh.sh. si krijesën më të përsosur. Ai ka mendjen e çmuar, dhuntinë më të vyer që e dallon nga kafshët, aq më tepër ai është i lirë të zgjedhë në mes dy rrugëve: të lejuarës (hallallit) dhe të ndaluarës (haramit). Ai mund të veprojë drejt në rrugën e lejuar, por edhe keq në rrugën e ndaluar. E mira e njeriut vlerësohet më shumë, sepse ai zgjedh hallallin, kur ka mundësi të veprojë në rrugën e haramit.

Ky është një problem kyç në edukatë. Kur një fëmijë arrin të jetë zot i vetvetes në çdo kohë dhe në çdo rrethanë, të veprojë duke ndjekur pikëpamjet e veta të arsyeshme, kur të veprojë në mënyrë të pavarur ndaj të tjereve, të veprojë si i thotë ndërgjegjja morale islame e trajtuar dhe e edukuar mirë, atëherë edukimi i tij ka arritur në një shkallë të lartë. Në këtë rast fëmija ka arritur të jetë për njëmend një qenie e lirë, ai nuk lë që të luaj kush me të apo ta nxisë e ta frymëzojë në një rrugë jo të drejtë. Kush në fëmijëri luan me kohën dhe tallet me jetën, kush në fëmijëri nuk mësohet ta sundojë vetveten, kurre më vonë nuk ka për ta gjetur fijen e së drejtës dhe gjithmonë rob ka për të mbetur. Zotërimi i vetvetes është përdorimi i arsyses kundër prirjeve, epsheve, ndjesive e veseve. Kjo përbën harmoninë e jetës së brendshme, lirinë e veprimin e fuqive më të larta e bukurinë e vërtetë të shpirtit e të ndërgjegjes njerëzore.

*Së dyti*, njeriu nuk jeton vetëm. Ai hyn në marrëdhënie me rrethin shoqëror, me njerëzit e tjere. Kur është i mitur, ky rreth është i kufizuar brenda familjes,

nënë e babë, vëllezër e motra e më gjerë. Duke u rritur rrëthi zmadhohet me shokët e lagjes, të shkollës e dalëngadalë fëmija futet në mjedisin e gjerë shoqëror. Njeriu i rritur është në marrëdhënie të përditshme e të vazhduese me shoqerinë njerëzore dhe të gjitha institucionet e saj. Objekt i temës së sotme është njëri aspekt, marrëdhëniet familjare, madje edhe më i kufizuar, marrëdhëniet e prindërve, marrëdhëniet e të gjithë pjesëtarëve tjerë të familjes dhe ndikimi i këtyre marrëdhënieve në edukimin e fëmijëve.

*Së treti*, njeriu sa është përgjegjës para vetes, para familjes dhe shoqërisë po aq, madje edhe më shumë është përgjegjës para Krijuesit të gjithësisë, para All-lahut xh. sh. xh.sh. “*Zoti yt ka urdbëruar që të abduron i vetëm Atë dbe t'u bëni mirësi prindërve. Nëse njëri prej tyre, ose të dy, arrijnë plegërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uh!”, dbe mos i kundërshto ata ( me fjalë të këqija). Dbe drejtohu atyre me fjalë respekti.*” (Kur'an: Isra, 23) Marrëdhëniet familjare në mendimin pedagogjik janë vlerësuar gjatë të gjitha etapave të zhvillimit të shoqërisë. Një pedagog e ka vlerësuar kështu rolin e edukatës familjare: “Aq sa mundet dielli të ndriçohet prej dritës elektrike më të fuqishme, aq më pak frymëzimet e familjes në edukatë mund të kapërcehen prej çfarëdo mjeti e mënyre artistike apo prej ndonjë tjetër mësimi pedagogjik“.

Në mësimet e besimit islam familja trajtohet si vendmbrojtja e secilit njeri, veçanërishtjeta familjare e myslimanëve është si një lloj xhenneti i vogël. A ka kënaqësi më të madhe, a ka qetësi më të madhe shpirtërore sesa pas një dite të lodhshme pune kthehesh në gjirin e familjes dhe gjen qetësinë, paqen dhe gjithë kujdesin e duhur? Ky mjedis i ngrohtë respekti reciprok, mëshire të pakufi, kujdesi të pafund, lidhjet e përpjekjet e përditshme e të natyrshme mes fëmijëve e prindërve, lidhjet e

brendshme shpirtërore e të gjakut, shfaqen e realizohen vetëm në gjirin e familjes. Kjo shpjegon edhe rolin shumë të rëndësishëm të familjes në edukatë. Fëmija i shikon të tjerët me një sy tjetër në krahasim me prindërit të cilët shpejt dhe me një dashuri të pashoqe i gjinden në çdo nevojë. Vetëm ai fëmijë i cili di të dojë fort disa vetë (pjesëtarët e familjes), sa të jetë gati edhe të sakrifikojë për ta, ai mund të jetë i zoti të kalojë jetën pa ankesa në dobi të të tjerëve. Në këtë mënyrë familjar fryshtimi i nënës ka fuqinë më të madhe, sepse nëna dhe fëmija janë aq afër, sa mund të thuhet se janë një. Në mendimin pedagogjik botëror vihet re një tendencë gati e përgjithshme për t'i dhënë nënës vendin dhe rolin më të rëndësishëm në edukimin familjar. Në traditën Pejgamberike thuhet: **“Khenneti është nën këmbët e nënës”**. Kjo nënkupton idenë se nëna i jep fëmijës së vet shtysat dhe drejtimin e parë në jetë drejt së mirës, drejt së vërtetës, drejt hallallit, kundër së keqes, kundër së të padrejtës, kundër haramit. Nëna ia hap fëmijës portën e udhës së drejtë për nënët. Pestaloci njihet në mendimin pedagogjik botëror si dishepulli më i shkëlqyer i idesë së nënës si edukatorja e shquar dhe më e para. **Gëte** thotë: *Po të ishin nënët të edukuara, fëmijët e tyre do të lindnin të edukuar.* **Napoleon Bonaparti** pyeti se çka i duhej Francës për t'u dhënë një edukatë të mirë djemve të saj. Nëna – qe përgjigjja. Dhe ai shtoi: *“Qe, me një fjalë të vetme gjëtëm një sistem edukatë”*. Mësuesi i parë i fëmijëve, edukatori me ndikimin më të madh dhe më i përshtatshmi është nëna e tij. *“Nënët janë heroina të mëshirës”*, -shprehet një edukator i madh. Mëshira e tyre është një ndjenjë shumë e madhe që nuk pret fare shpërbirim. Një nënë për të shpëtuar fëmijën e vet pa shpresuar fare për shpërbirim, sakrifikon jetën. Kjo tregon se gratë janë heroina të mëdha. Po të lulëzojë kjo

cilësi, ajo është e shpëtuar në të dy jetët. Edukata që jep nëna është e lidhur ngushtë me ato cilësi karakteristike vetëm për gruan, si: dashuria e pakufishme, mëshira e thellë, sakrifica sublime, durimi, delikatesa, dhembshuria etj. cilësi të cilat e kanë burimin tek amësia, veti e dhënë nga Krijuesi i plotfuqishëm vetëm për nënët si burim i gjinisë njerëzore. Por në këtë rrugë të gjerë të mëshirës jo rrallë hasim edhe dukuri negative dhe teprime të cilat në vend që të ndikojnë në formimin e karakterit dhe të personalitetit të fëmijës e qullasin atë, e bëjnë shumë delikat dhe të prirë pas interesave të botës materiale, duke iu larguar lartësimit shpirtëror. Në edukimin e fëmijëve roli i nënës është vërtetë i pazëvendësueshëm, por lë shteg për dy gabime të mëdha në edukatë. Së pari, ngjall tek fëmija brishtësi dhe delikatesë të tepruar në raport me vështirësitë që paraqet realiteti. Së dyti, shumë nëna të prira për t'u siguruar fëmijëve të vet një jetë të mirë materiale harrojnë formimin e tyre shpirtëror fetar islam gjë që krijon një rrezik të madh. Këta fëmijë në një çast të caktuar do të kuptojnë zbrazëtinë e tyre shpirtërore dhe do të padisin nënët e veta për këtë. Kjo do të ishte një fatkeqësi e pandreqshme për nënën dhe për fëmijën.

Ne nuk po zgjatemi në këtë problem delikat për të cilin ka plot literaturë, por theksojmë se në edukimin e fëmijëve nuk mjafton vetëm puna e nënës. Kjo patjetër duhet kombinuar me vlerën dhe rolin e babait në edukatë. Babai është një shtyllë tjeter e edukatës familjare. Ai me seriozitetin e tij, me shembullin e tij e pse jo edhe me rolin parësor në sigurimin e burimeve financiare ekonomike të familjes edukon tek fëmija burrerinë dhe këmbënguljen për të kapërcyer vështirësitë e panumërtë që dalin në jetë. Ne nuk duam të flasim këtu për përparësitë e njërit apo të tjetrit në edukim, por duam të theksojmë

lidhjet e marrëdhëniet e të dy këtyre palëve, në ç'raport e në ç'lidhje janë prindërit dhe si e bashkërendojnë rolin e tyre në edukatë.

Respekti i ndërsjellë, mirëkuptimi, uniteti i kërkesave, bashkërendimi i punëve për zgjidhjen e detyrave familjare, ndarja e detyrave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre, koha që u kushtojnë edukimit të fëmijëve e shumë e shumë probleme tjera kanë rolin e vendin e vet. Në qoftë se këto marrëdhënie mes të dy prindërve janë të mbara e të drejta, ato ndikojnë për mirë tek fëmijët e patjetër do të duken shpejt frytet e tyre.

Por, a ka gjithnjë marrëdhënie të mira në familje mes bashkëshortëve? Këtë e ka shprehur bukur populli përmes fjalës së urtë “*Sa ka peshk pa halë, aq ka shtëpi pa fjalë*”. Natyrisht, në jetën e përditshme mes prindërve ka edhe mendime e pikëpamje të ndryshme, sjellje e qëndrimë të ndryshme, jo rrallë ka mospërputhje e shpërpjesëtime, madje edhe kontradikta. Në një familje ku ka marrëdhënie të drejta e harmoni bashkëshortore këto kriza kalohen pa vështirësi të shumta. Por në mjaft familje kjo harmoni mes të dy bashkëshortëve nuk ecën drejt. Ajo kalon plot zigzage e vështirësi të panumërtë. Një edukator i madh shkruan: *Është fatbardhë ai burrë që e ndjek gruan e tij të mirë e cila vepron sipas parimeve të fesë islame, duke u bërë në këtë mënyrë edhe vetë një mysliman i mirë. Po kështu është fatbardhë ajo grua, që ka pasur fatin të martohet me një burrë që përjeton fenë islame dbe përpigjet të mos e humbë kënaqësinë e jetës së amshuar. Ajo duke e ndjekur burrin e vet kthehet në një myslimanë të mirë, që brenda kënaqësive të kësaj jete fiton edhe parajsën e lumtur.*

*Sa fatzi është ai burrë që imiton gruan e vet në rrugën e më-kateve dbe nuk mundohet ta pengojë atë duke e nxirë jetën akoma më shumë. Po kështu, edhe ajo grua vetë është po aq fatlezë që është martuar me një burrë të tillë i cili stimulon ligësitë e rrugës së*

*mëkateve. Mjerë ato çifte që bashkëpunojnë me njëri-tjetrin duke u shtyrë drejt veprimere të shfrenuara nën petkun e modernizimit të jetës.*

Në këto raste, në këtë vorbull të jetës familjare përfshihen edhe fëmijët. Ata ndikohen fuqishëm gjë që krijon mungesa të theksuara në edukimin e sjelljen e tyre morale. Marrëdhëniet dhe gabimet e prindërve do të pasqyrohen qartë në sjelljen e fëmijës. Këta fëmijë janë jo vetëm dëshmitarë të marrëdhënieve të parregullta mes prindërve, por edhe shkaktojnë shqetësimë me veprimet e tyre të padenja. Po ndalemi vetëm në qëndrimin e prindërve në periudhën e adoleshencës. I riut ka hyrë në një periudhë të ndryshimeve të fuqishme fizike e shpirtërore. Është një periudhë kur fëmija është në udhëkryq. Erëra të fuqishme e pushtojnë trupin dhe shpirtin e tij. Si i ndihmojnë prindërit fëmijët e vet në këtë periudhë kritike? Sa u qëndrojnë afër dhe më çfarë takti ndërhyjnë? Shumica dërmuese e prindërve i trajtojnë të rinjtë e kësaj moshe si fëmijë, kur në të vërtetë ata tashmë nuk janë fëmijë. Shumë të tjerë i harrojnë as nuk interesohen fare për ta. Plot të tjerë çdo tendencë të të rinjve për të afirmuar personalitetin e tyre e shtypin dhe e ndrydhin përmes urdhrash dhe ndalesash pa takt e pa arsy. Dukuria më e njojur dhe njëkohësisht më e dëmshme është se shumica e prindërve as nuk i njojin fëmijët e vet. Po cili është reagimi i fëmijëve? Në shumicën e rasteve ata heshtin ose japin përgjigje evazive e të thata, i fshehin qëndrimet e tyre, madje bëhen edhe tinëzarë e hipokritë, ndryshtë shprehët e ndryshtë veprojnë. Kjo është rrjedhojë e qëndrimit të padrejtë të prindërve, e arrogancës së tyre, e interesimit të paktë dhe e shembullit negativ që ata japin në familjen e vet. A nuk e keni venë re ankesën e shumë ballarëve të cilët gjoja nga ngarkesa e madhe në punë ha-

trojnë se kanë familje, harrojnë se kanë fëmijë dhe e kalojnë gjithë kohën në punë, në kafene, në shoqërinë e tyre dhe natyrisht nuk kanë kohë të humbin për edukatën e fëmijëve të vet? Rezultatet natyrisht do të jenë të dyshimta. Çfarë pret ai prind që gjithë ditën e kalon duke luajtur domino, hedh edhe ndonjë domino e vjen pastaj në shtëpi duke dhënë urdhra gjithandej, urdhra që askush nuk i zbaton? Shembulli i tij, moskokëçarja e tij mjafton për të mbjellë farën e përtacisë dhe të mungesës së seriozitetit në jetë tek fëmijët.

Në shumë familje krahas prindërve jetojnë edhe vëllezërit e motrat, gjyshi dhe gjyshja. Në pamje të parë duhet sikur problemet koklaviten në familjen me shumë fëmijë, numri i tyre shton detyrat dhe preokupimet e prindërve. Kjo është e vërtetë, por në rastet e një fëmije, e sidomos kur ky është djalë vihet re një kujdes i tepruar i prindërve. Efekti më i zakonshëm i këtij kujdesi të tepruar është llastimi i fëmijës. Rriten fëmijë egoistë, kryeneçë që dinë vetëm të kërkojnë dhe, kur dalin në mjedisin shoqëror, nuk dinë të përshtaten, kështu që shpesh bëhen gazi i shokëve.

Vellezërit dhe motrat ndikojnë dukshëm përkrah prindërve. Në këtë rast edukohet aftësia për ndihmuar më të vegjlit, më të dobëtit, nevojtarët, aftësia për të sakifikuar për ta. Gëzimi që sjell bamirësia fitohet vetëm me veprime bamirëse e sidomos, kur këto bëhen për rrethin më të ngushtë familjar, siç është vëllai apo motra më e vogël. Kështu një i ri apo një e re, kur mësohet t'u shërbëjë nevojtarëve, edhe kur të rritet nuk do të përtojë të veprojë në këtë mënyrë.

Në rastet kur në familje jetojnë edhe gjyshi e gjyshja dalin shumë dukuri interesante. Gjyshi dhe gjyshja falin më shumë, janë më lëshues, i marrin punët më me ngadalë për vetë natyrën e moshës, nuk trazohen fort, jo

rrallë bien në kundërshtim me prindërit. Fëmija gjen strehë tek gjyshi apo gjyshja, shpesh i shpëton ndalesës apo dënimit të prindit, por ata në shumicën e rasteve janë një faktor me shumë vlera edukative. Në kushtet e jetës së përbashkët edukohet dashuria për të moshuarit, ndjenja e nderimit për pleqtë, e kujdesit për ta, e sakrificës për të dobëtit e të pamundurit e moshuar. E këto janë disa ndjenja të ngrohta që ua shtojnë gjëzimin prindërve, ua zvogëlojnë telashet që sjellin sëmundjet e mosha, tritin harmoninë familjare përmes sakrificës së më të rinjve, gjëzim që është i një cilësie të veçantë.

Sikurse shihet krijimi i marrëdhënieve të drejta në familje është një problem shumë faktorësh dhe mjaft i vështirë. Të metat që vihen re në karakterin e shumë fëmijëve, të mirat dhe të këqijat në edukatë varen në një farë shkalle nga këto marrëdhënie.

## **Autoriteti i prindit**

### **Çfarë kuptojmë me autoritet të prindit? Ku e ka burimin?**

Prindi është i ngarkuar nga shoqëria, është i detyruar e përgjegjës para All-llahut xh. sh. xh.sh. që të rrisë fëmi-jë të shëndetshëm dhe të edukuar mirë. Këtu buron pushteti prindëror dhe autoriteti i prindit në sy të familjes.

Pa autoritet është e pamundur të kuptohet edukatori. “Një njeri që nuk di të urdhërojë as të dëgjojë, pra të bindet, ai nuk i duhet gjë kujt” thotë një dijetar.

Mirëpo edukimi fillon herët, që në moshë të njomë kur asnjë argument logjik nuk mund të përdoret, asnjë pushtet shoqëror, apo formë e jashtme e autoritet nuk hynë në punë, megjithatë edhe në këtë moshë prindi duhet të ketë pushtet dhe autoritet mbi fëmijën. E në këtë rast është autoriteti që krijohet nga kujdesi, dashuria e dhembshuria për një krijesë të dobët e të pambrojtur, që edhe për t'u ushqyer ka nevojën e të rriturve, e jo më për t'u veshur e për t'u mbathur. Natyrisht në këtë rastjeta e fëmijës lidhet e varet nga kujdesi i prindit, prandaj edhe ai ka pushtet e autoritet te fëmija. Në këtë rast kuptimi i

autoritetit nuk kërkon kurrfarë argumentesh, ai pranohet si një meritë e padyshimtë e më të madhit, më të fuqishmit, e më të vjetrit mbi fëmijën. Forca e vlera e tij rraket me një shikim të thjeshtë të fëmijës, më shumë ndjehet se sa kuptohet. A nuk keni vënë re një fëmijë fare të vogël kur merr vaj, atë nuk mundet kush tjetër ta pushojë, veç nënës. Sa ajo i afrohet shtratit ku është fëmija, ai heshtë, madje edhe gëzohet edhe qesh. Besoj se të gjithëve ju shkon mendja të kuptoni se këtu nuk ka asgjë të mbinatyrrshme.

Fëmija që në ditët e para ka kuptuar se afrimi i nënës lidhet me ushqim. Ajo zbërthen gjoksin dhe i jep gjë fëmijës, qumështin jetëdhënës. A ka gjë më të këndshme se kur ke uri, të ushqehesh? Këtë veprim biologjik, këtë ndjenjë kënaqësie për t'u ushqyer nuk e kanë vetëm të rriturit, edhe fëmijët fare të vegjël. Provoni e lëjeni pa ngrënë një fëmijë, ai t'i merr mend duke qarë, e kur është i ngopur s'i ndihet zëni i gojës.

Po kështu mund të ngjasë kur fëmija është i papastër, ka një gjendje të pakëndshme, është i sëmurë etj. A di kush më mirë se nëna më ja heqë të keqen? E në këtë rast edhe fëmija krejt i vogël e kupton se kush e ndihmon, cili ka forcë t' ja largoje të keqen e cili jo. Kush pra ka autoritet më shumë tek fëmija? Natyrisht ai që e mbron dhe kujdeset më shumë për të. Pra autoriteti i prindit në moshë të njomë buron nga pushteti absolut që ka mbi fëmijën që është krejt i pafuqishëm por i varur kryekëput nga prindi.

Kjo nuk duhet të na çojë në mendimin e gabuar që autoriteti prindit është diçka e lindur, është një dhundi apo një talent i dhënë. Jo. Është tjetër gjë fakti se duke u rritur fëmija, ai fillon të ketë njëfarë pavarësie nga prindi dhe vlera e tij fillon të bie në disa fusha. Fëmija vishet vetë, ushqehet vetë, ecë e shkon e vjen vetë. Në këtë rast

krijohen lidhje më të gjëra të fëmijës me mjedisin, ai fillon e dallon qartë vlerat dhe dobësitë e prindit, e sapo gjënë ndonjë të çarë, përfiton prej tyre. Shkurt fëmijët përfitojnë nga të metat dhe dobësitë e prindit në sjelljen me fëmijët, përfiton nga gabimet e prindit, përfiton e mëson se në botë ka edhe njerëz të tjerë, me të cilët lidhet e krijon marrëdhënie e nga të cilët mund të përfitojë apo ta pësojë. Në këtë rast në pamje të parë autoriteti i prindit e vlera e tij fillon e bie. A nuk e keni dëgjuar ju shprehjen e disa prindërve të dëshpëruar: “Unë ja kam bë kokën, e ai kështu e ashtu.”

Në kohën e sotme kur lidhjet e brezit të ri me rrethin rriten shumë, autoriteti i prindit fillon e zbehet që herët, madje mjaft gjëra që në të kaluarën ishin si të shenjta, në sytë e të rinjve fillon e bien për nga vlera. Kjo ngjet jo vetëm me prindërit por edhe me mësuesit e me të rriturit e tjerë. Krahasoni këto faktorë edukimi në report me informacionin kulturor. Fëmija lexon, fëmija është në televizor, shumë prej tyre dalin e shohin jashtë, fëmija dëgjon muzikë, shkon në stadium, merret me sport. Në këto raste ai ka një informacion të përafërt me mësuesin apo me prindin, s'po themi më të madh. A nuk bije vlera e mësuesit apo e prindit para fëmijëve apo të rinjve, kur ai jo me argumente, por me urdhra do t'uam bush mendjen fëmijëve? E në këto raste nxënësit e shkollave kënaqen duke gjuajtur gafat e mësuesve.

## A mund të ketë autoritet çdo prind?

Po çdo prind mund dhe duhet të ketë autoritet te fëmijët. Është tjetër gjë që disa prej tyre, nga gabimet dhe

të metat, shpesh herë edhe në emër të dashurisë e të kujdesit për fëmijët fillojnë dhe e humbasin vlerën dhe autoritetin para fëmijëve. Fëmijët nuk u binden, i kundërshtojnë madje vjen një kohë që nuk i zbatojnë urdhrat dhe porositë e tyre.

Autoriteti mund të organizohet në çdo familje, madje kjo nuk është një punë e vështirë. Për fat të keq disa prind e organizojnë këtë autoritet mbi baza të gabuara. Ata synojnë që fëmijët e tyre t'i dëgjojnë, t'u binden. Ata në këtë mënyrë kujtojnë se kanë autoritet, duke mos e vlerësuar këtë me shkallën e ndërgjegjes së fëmijëve.

Autoriteti dhe dëgjueshmëria apo bindja nuk janë qëllim me vete. Qëllimi i të gjitha mjeteve të edukimit dhe i faktorëve të tij është edukimi i drejtë i fëmijëve. Bindja dhe dëgjueshëmria e fëmijëve mund të jetë vetëm një rrugë drejt këtij qëllimi. Pikërisht ata prindër që nuk mendojnë për qëllimet e vërteta të edukimit, synojnë të kenë fëmijë të bindur e të dëgjueshëm sa për formë. Kur fëmijët janë të bindur, prindërit janë të qetë. Pikërisht kjo qetësi është qëllimi i tyre i vërtetë. Por as qetësia as bindja nuk ruhen gjatë. Vjen një ditë dhe fëmijët nuk janë më të bindur. Po disa prind edhe mund ta ruajnë bindjen tek fëmijët për një kohë të gjatë, por për fat të keq këto fëmijë janë të shtypur, binden e heshtin, dëgjojnë e zbatojnë. Shkurt kapen për hunde, janë qullashë, pa personalitet, të larguar e të frikshëm ndaj shokëve. Shpejt bëhen tinëzarë e hileqarë. Tek ata kultivohen disa vese shumë të dobëta, që është shumë vështirë t'u hiqen, ata u janë bërë natyrë e dytë e tyre.

## **Po cilin duhet të dëgjojë fëmija?**

Fëmijët duhet të dëgjojnë në radhë të parë urdhrat e All-llahut xh. sh., prindin dhe edukatorët e vet, e këtu hyjnë edhe mësuesit dhe kushdo tjetër që ka marrë përsipër edukimin e tyre, duhet të dëgjojë ndërgjegjen dhe pikëpamjen e vet të arsyeshme, por assesi në kundërshtim me mësimet Hyjnore.

Dëgjueshmëria dhe bindja është e lehtë kur të gjithë urdhërojnë për një punë, një drejtim, por është e vështirë kur njëri urdhëron e tjetri ndalon. Në mjaft familje baba urdhëron e dënon, ndërsa nëna hatëron e lëshon (këtu më shumë përzihen gjyshat). Kjo ngjet edhe me shkollën, ata që e ndreq shkolla ditën, e prish familja natën, e aq më keq është kur shkolla apo familja vepron në kundërshtim me urdhrat e fesë. Po e theksoj këtë se për 50 vjet rresht shkolla, edhe shumë prindër vepruan kundër porosive fetare. Sot gjurmët e kësaj mbrapshtie nuk janë të vogla, janë shumë të fuqishme. Së paku në fushën e moralit. Besoj se të gjithë e kuptoni se sa të vështirë e ka fëmija që është i detyruar t'i vejë këmbën ndërgjegjes së vet, e të veprojë si e kanë urdhëruar prindërit. A është bindje dhe dëgjueshmëri kjo? Fëmija ka pas një punë në shtëpi e në shkollë thotë se ka qenë i sëmurë, kështu e ka urdhëruar i ati. Ky baba nesër nuk duhet çuditur nëse fëmija si pa të keq do ta gënjejë. Vetë e ka stërvitur. Nëse fëmija a me të mirë, ose me të keq, për hatër të prindit apo përfrikë të tij arrin ta mund veten, të ndrydh kundërshtitë që mund të ketë e t'i shtrohet urdhrit apo t'i bindet prindit kurrë nuk ka për të arrit të jetë i zoti të sundojë veten e t'i rregullojë punët e veta në bazë të arsyses dhe ndërgjegjes së vet, si gjithnjë do të kapet për hundësh nga të tjerët.

Në familje mund të vendoset një farë autoriteti, mund të sigurohet bindja e dëgjueshmëria e fëmijëve, por shpesh në rrugë të gabuar.

## Autoriteti i shtypjes, i ndrydhjes së ndërgjegjes së fëmijëve

Fëmijët vërtetë binden por nga frika, qëndrojnë larg prindit të tmerrshëm që s'e ka për gjë të japë dënimë të ashpra, rriten të trembur e të frikshëm ndaj çdo lloj autoriteti, janë të nënshtuar, hileqarë, të squllët, kokëfortë, madje edhe të trashë, por më e keqja tek këto fëmijë rritet ndjenja e egërsisë, prej tyre në momente të caktuara lindin figura të shëmtuara krimi. Babai apo nëna e egër në vend të një krijese të butë jo rrallë rrit një egërsirë që i qet kthetrat sa po të gjejë një krijesë më të dobët se veten.

E kundërsa e kësaj është ideja që duhet të përpinqemi sa të mundemi të trajtojmë dëgjueshëminë e fëmijës duke synuar nënshtimin e vullnetshëm. Fëmija ka përbrenda zekthin e lirisë vetjake, atij thellë në ndërgjegje i gufon kjo ndjenjë lirie krenare. E nëse fëmijës i jep urdhra pa arsy, por e detyron, tek ai do të ngrihet edhe ndërgjegjja e ndjenja e lirisë, si të themi edhe ai përgatitet për kundërshtim, për sulm. Prindit nuk duhet t'i dhimbet fjala e ëmbël, në vend që t'i thotë "Bane" mund t'i thotë se "Unë e di se ti nuk përton e ke me e bë".

Pedantizmi i prindit, shpesh merret si një mjet për të vendosë autoritet. Janë prindër të rregullt, shumë të rregullt e pikërisht kërkesat e tyre të tepruara bëjnë që të kërcejë kandari. Ata me rregullin e tepruar, me urdhrat e

kërkесат e tyre pa lëshime, duke mos e njoхur shprehjen “Tërhiq e mos këput” në edukatë, bëhen pedantë dhe ua nxijnë jetën fëmijëve, besa edhe vetes, sepse në çdo lëvizje, në çdo veprim shohin një shkelje, shohin një gabim e kështu marrin shkas të jatin leksione morali të pafundme e të qëndrojnë si mushka ne veten.

*Autoriteti i distancës*, fort i njoхur në vendin tonë, parimi bazë i të cilit është që prindi duhet të rrijë sa më larg fëmijëve. Në këto familje ka pasur rregulla e zakone lidhur me këtë autoritet.

*Autoriteti i dashurisë*, i përkëdheljeve, shprehja më e zakonshme është “Ti s’ë dashke nënën”.

*Autoriteti i sakrificës* që shprehet në plotësimin e çdo kërkese të fëmijëve. Ky është autoritet i blerë me peshqeshe e para. Është krejt pa vlerë, po është shumë i përhapur. Në emër të dashurisë plotësohen më tepër se duhet nevojat e fëmijës.

Disa këshilla për të kultivuar bindjen dhe dëgjueshmérinë te fëmija.

- 1 *Nxite e kultivoje atë dëshirë që ka më për zemër fëmija. Fëmija është i varur te prindi, ka nevojë për të si bima që duhet mbështetë diku, prindi duhet të marrë mundimin e të përkulet për ta ndibmuar, por të mos bahet më fëmijë se fëmija.*
- 2 *T’i mbushet mendja fëmijës se prindi nuk lyp tashti një punë e nesër një tjetër. Po e kuptoi ai se mësuesi e prindi apo dikush tjetër vepron drejtë e mbarë, edhe fëmija do të bindet e do të dëgjojë sepse e kupton se çdo gjë bëhet për të mirë të tij.*
- 3 *Dëftoje veten si shembull dëgjueshmërie para fëmijëve. (Mjaft t’u duket dëgjueshmëria e lehtë, se njerëzit dëgjojnë me èndje).*
- 4 *Mos e le fëmijën ta çojë në vend damarin e vet, (kapriçon). Ka fëmijë kryeneç, me teka e të llastuem. Urdhri e*

*ndëshkimi vlejnë.*

- 5 Për çdo punë të vogël apo shkelje, mos kujto se po të ulet autoriteti, se po humbet ai.
- 6 Me fëmijët të jesh i drejtë, i njerëzishëm, i ëmbël. Sillu me to pa u shtirë.

# **Përbajtja edukatës familjare**

## **1. Çfarë kuptojmë me përbajtje të edukatës familjare?**

Prindi e në përgjithësi familja duhet të dijë e ta ketë tē qartë se çfarë duhet tē edukojë tek fëmijët e vet. Prindi që ka një ose më shumë fëmijë dëshiron t'i edukojë, por cila është përbajtja e kësaj edukate që do tē transmetojë tek brezi i ri? Këtë po e sqarojmë me një shembull nga puna e shkollës. Sapo fëmija hyn në klasën e parë, detyra fillestare është tē mësojë këndim e shkrimit. Me abetare në dorë, pas shumë përpjekjesh tē mësuesit, tē prindit dhe tē vetat arrin tē mësojë tē lexojë e tē shkruaj, merr elementet e para tē njohurive nga aritmetika, nga natyra e kështu me radhë. Po në shtëpi, kur është pa u futur në shkollë, në ç'fusha duhet tē edukohet? Duhet ta kemi tē qartë se shtëpia nuk është shkollë në kuptimin konkret tē fjalës. Ndërsa shkolla punon në mënyrë sistematike me plane mësimore, me programe, me tekste tē posaçme për çdo lëndë e për çdo klasë, pra, nëse mund tē shprehemi kështu, bukën e madhe tē sofrës së diturisë ajo e ndan në copa tē mëdha për çdo klasë, pas-

taj nē rriska pēr çdo lēndē e mē nē fund nē kafshata herē tē vogla e herē mē tē mēdha aq sa nxēnësi mund t'i ka-pērdijē pēr çdo orë mēsimi, familja nuk ndjek kêtë tregullsi sistematike tē shkollës, ajo punon nē mēnyrë mē tē natyrshme, pa zyrtarizëm, nē mēnyrë tē drejtpërdrejtë me fëmijën, madje nē mēnyrë mē tē kujdeshme. Nëna e sheh fëmijën orë e çast dhe e kuhton fort mirë se ku i dhëmb dhe si mund t'ia largojë tē keqen. Megjithëkëtë çdo prind duhet ta ketë tē qartë se çfarë duhet tē eduko-jë, ku duhet tē arrijë, cila është përbajtja e punës edukative që duhet tē bëjë me fëmijët e vet, pra cila është përbajtja e edukatës nē familje, cilat janë ato pjesë tē asaj buke tē madhe që shtrohet nē sofrën e edukatës familjare.

Pjesë përbërëse tē edukatës familjare janë: edukata fizike, mendore, morale, estetike dhe edukata e punës. Të gjitha këto marrin vlera mē tē mēdha, kur kanë nē themel tē tyre idealet e larta tē fesë, kur synojnë përgatitjen e thellë shpirtërore pēr t'iu bindur urdhrale tē Allahut xh.sh. dhe mësimeve tē traditës pejgamberike dhe kur stërviten pēr tē vepruar nē bazë tē tyre. Kështu ditë pēr ditë njeriu që nē fëmijëri mësohet që veprimet e thjeshta e nē dukje tē vogla t'i kthejë nē adhurime dhe vlerësime pēr Krijuesin Plotfuqishëm.

## **2. Pjesët përbërëse tē edukatës janë tē lidhura me njëra – tjetrën**

Edukata nē familje nuk është diçka e copëtuar. Jo, njeriu është një dhe edukata është një e tërë, por ne i ndajmë pjesët e saj pēr lehtësi kuptimi dhe studimi. Po e

shpjegojmë këtë me një shembull të thjeshtë. Çdo fëmijë ushtrohet derisa t'i bëhet shprehi që, kur të zgjohet nga gjumi, duhet të lajë duart dhe fytyrën. Ky rregull, ky zakon i mirë, kjo shprehi ndikon në zhvillimin e mirë fizik dhe shëndetësor të fëmijës. Por ky zakon, sa ka vlera higjenike aq është edhe edukim estetik. Një fëmijë i pastër, i larë, i veshur, i krehur është edhe i bukur, ka një paraqitje të hijshme. "I shëndoshi, i bukuri", -thotë populli. Kështu është. Mendoni një fëmijë shëndetlig, ai është i dobët fizikisht, i verdhë, i ngathët, ai nuk është as i hijshëm.

Këtu kemi të bëjmë edhe me edukimin mendor. Fëmija duhet të dijë se, kur duart janë të ndotura, kanë shumë mikrobe e ata duke prekur bukën, futen në trupin tonë e bëhen shkak për shumë sëmundje. Shumë fëmijë infektohen nga papastërtitë. Në fund të fundit duke vënë një rregull, duke shtruar një kërkesë, fëmija stërvitet që ta plotësojë atë, bëhet i kujdeshëm dhe i vëmendshëm ndaj vetvetes, që të kryejë pa ndërprerje detyrën, lufton dembelinë që ngre krye orë e çast. Në këtë mënyrë ushtrohet rregulli, përpikëria dhe gatishmëria për të kryer një punë. Shumë fëmijë përtojnë të lahen, të ndërrohen, të vishen, të krihen e të tjera gjëra të vogla, por që i vënë ata në marrëdhënie me veten e me të tjerët. Kur ai mësohet të kryejë disa detyra me rregull në fëmijëri, do të vazhdojë kështu për tërë jetën. Ky është edukimi moral shumë i dobishëm për njeriun. Kështu mund të sjellim shumë shembuj për të arritur në përfundimin se pjesët e edukatës në familje nuk janë të ndara, por të lidhura ngushtë njëra me tjetrën. Nuk edukojmë sot trupin, nesër mendjen, një ditë tjeter sjelljen e pastaj shijet estetike. Jo, këto janë të ndërtuara, të lidhura e ndërvarura ngushtë njëra me tjetrën.

Të gjitha këto veprime të thjeshta e të vogla, me pak kujdes e përkushtim mund të marrin vlera shumë më të

mëdha edukative nëse bëhen në emër të All-llahut xh. sh. xh.sh. dhe duke ju mbështetur Atij. Fëmija duke parë në moshë të njomë nënën apo babanë që, sa po fillojnë një veprim i drejtohen All-llahut xh.sh. për ndihmë e mbështetje, fillojnë edhe ata të bëjnë bismil-lahi. Kështu, edhe një veprim i thjeshtë siç është fillimi i të ngrënimit, kthehet në një adhurim. Po kështu, sa po mbaron bukën, fëmija falënderon All-llahun xh.sh. që i fali të gjitha të mirat në sofrën e shtruar dhe që ja bëri të mundur të ngrënët. Në këtë mënyrë nga dita në ditë, nga gjërat e vogla e të thjeshta të jetës fëmija mësohet të madhërojë Krijuesin, Mëshiruesin, Të Plotfuqishmin, e përmend Atë shpesh e më shpesh, e falënderon dhe e madhëron. Ai duke u kënaqur nga gjërat e thjeshta shton dashurinë e nderimin për të Plotfuqishmin, e lidh veten gjithnjë e më ngushtë me Të, në zemrën e tij të vogël lulëzon dashuria dhe nderimi për All-llahun xh.sh. Kjo është një cilësi dalluese e besimtarit të devotshëm islam. Këto themelë të hedhura në fëmijëri do ta kthejnë më vonë jetën e fëmijës në një adhurim të pafund. Ai do të veprojë gjithnjë në bazë të mësimeve të All-llahut xh. sh. xh.sh dhe do të zbatojë urdhurat e Tij.

Pjesët përbërëse të edukatës në familje të lidhura ngushtë njëra me tjetrën e të mbështetura fort në mësimet e larta të fesë Islame do të kenë pa tjetër rezultatet e duhura në edukimin e drejtë të fëmijëve dhe të të rinjve.

Po paraqesim në formë të përbledhur të gjitha pjesët e edukatës, secilën prej tyre do të përpinqemi ta trajtojmë më poshtë.

## **Edukimi fizik**

Mirërritja e trupit është themeli mbi të cilin do të mbështetet i gjithë zhvillimi mendor, moral etj. Në një trup të shëndoshë është edhe një mendje e shëndoshë. Kur nuk ke shëndet, nuk të bie në mend për asgjë. Në edukimin fizik duhet të dallojmë dy anë të problemit: punën që bën prindi, kujdesin e tij për shëndetin e fëmijës, për higjenën personale, ushqimin, veshjen, lojën, pushimin etj., por edhe aftësinë që vetë fëmija të kryejë disa nga veprimet më fillestare duke nisur nga vetëshërbimi. Nëna apo më të rriturit do të kujdesen përfëmijën deri në një moshë të caktuar, por vetë fëmija dora-dorës duhet të aftësohet e të kujdeset përveten. Teprimet e prindërve në emër të kujdesit bëjnë që fëmijët të kërkojnë diçka gati prej më të mëdhenjeve, gjë që kultivon dembelizmin, pazotësinë përfëmijës së organizuar veten e punët e veta, paaftësinë përfëmijës së kryer me rrugë e me radhë disa veprime që lidhen me trupin e me shëndetin.

Është e rëndësishme që edhe në familje të zhvillohen disa cilësi fizike, si: shkathtësia, shpejtësia, elasticiteti, forca, rezistenca, etj., por edhe disa cilësi morale që lidhen me zhvillimin fizik, si: guximi, durimi, bashkëpunimi e ndihma reciproke, ndihma ndaj më të dobëtëve, nevojtarëve, të varférve etj.

## **Edukimi mendor**

Mendja është xhevahir. A ka gjëzim më të madh përfëmijës së familjeve, sesa të ketë fëmijë të zgjuar? Natyrisht, në fushën e edukimit mendor shkollës i takon puna më e

rëndë, sepse ajo është institucion i specializuar për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, por edhe familja luan rolin e vet, bile në disa fusha ka përparësi. Po parashtrojmë ndonjë shembull.

Aftësia për të folur. Kush e bën këtë punë më mirë se nëna? Shkolla e lëmon, e qëndis, e kulturon gjuhën, por themellet e saj (leksikun, frazeologjinë, shqiptimet fonetike, ndryshimin e fjalëve dhe lidhjet e tyre në fjali) fillojnë e fitohen në familje. Shpeshherë shkolla e ka të vështirë, madje të pamundur të ndryshojë disa trajta të shprehuri apo të shqiptuari që merren në fëmijëri në familje. Kujtoni p.sh. të folmen në dialekt. Rritet e plaket njeriu dhe nuk ndryshon dot disa shqiptime, sado të punojë shkolla dhe mjetet tjera në këtë fushë.

E kjo nuk ngjet vetëm me gjuhën, por edhe me disa aftësi, shprehi e njohuri tjera, si: ato të rregullimit të shtëpisë, të ekonomisë shtëpiake, të gatimit, të qëndisjes, të disa punëve të thjeshta bujqësore e blegtorale etj. Në këto fusha e në shumë të tjera edukata familjare ndikon dukshëm, shpesh ka përparësi ndaj shkollës.

Aftësia për të perceptuar. Zhvillimi i shqisave, vrojtimi, mprehja e dëgjimit, të prekurit, shijimi, të nuhaturit fillojnë të zhvillohen në familje, ndërsa shkolla vetëm sa i zgjeron dhe i përpunon në drejtimin shkencor. Vini re kujdesin e të gjithë pjesëtarëve të familjes për reagimin e fëmijës ndaj dritës, ndaj krismave, ndaj ujit të ngrohtë apo të ftohtë etj., veprime të vogla që kryhen orë e çast në familje në mënyrën më të natyrshme, gjë që shkolla nuk do të arrinte ta bënte kurrë. Mësuesi nuk mund ta zë-vendësojë kurrë kujdesin e nënës që fëmija të fillojë të belbëzojë e më vonë të flasë apo të ecë. Nuk po zgjatemi këtu për rolin e përrallave, tregimeve, lojërat e fjalëve (fjalëshpejtë), gjëegjëzat, shprehjet e bukura popullore që më mirë se në familje nuk mund të përdoren asgjékund.

Konceptet e para fëmija i merr në familje, si: nënë, babë, vëlla, motër, fruta, ushqime, emërtimet e rrobave, po kështu krahasimet e para, klasifikimet, abstragimet etj.

## **Edukimi moral**

Ky është një problem shumë i gjërë, por duam të theksojmë se s'ka shkollë dhe asnje mjet tjeter që të shlyej nga zemra dhe ndërgjegjja e fëmijës, madje edhe e të rriturit ato ndjenja të larta morale që merren në shtëpi, si: ndjenja e dashurisë, e respektit, e dhembshurisë, e sakrificës ndaj të dobëtëve, pleqve, të varfërve e nevojtarëve. Kush mëson të nderojë pleqtë në familje, do t'i nderojë edhe në rrugë dhe kudo në jetë. Kush është mësuar të bëjë veprime fisnike duke sakrifikuar për pjesëtarët e familjes, sakrifikon pa hezitim edhe për të tjerët. Kush e do shtëpinë e vet, familjen, lagjen apo katundin, shokët e miqtë e vet, do të dijë të dojë dhe të respektojë edhe të tjerët. Po kështu ndjenja e nderit, e dinjitetit, e turpit, aftësia për të përbajtur veten nga veprimet e ndaluara (harami), respekti ndaj vetes dhe të tjerëve, zakonet e mira të mikpritjes ku mund të mësohen më mirë se në shtëpi, në gjirin e familjes? Kështu mund të flasim për atdhetarizmin, qëndrimin ndaj punës, ndaj pronës etj. ndjenja të larta morale.

## **Edukimi estetik**

Në familje merren konceptet e para për të bukurën e kategoritë e tjera estetike, fitohet përvoja fillestare e perceptimit të së bukurës kudo: në të folur, në sjellje, në të veshur, në lëvizje, në rregullimin e shtëpisë, në natyrë, në

art etj. Krijohen edhe aftësitë e para për ta vlerësuar të bukurën dhe për ta krijuar atë. Sa gjëra të mira, të dobishme dhe të bukura mund të fillojnë të krijojnë fëmijët në familje nën drejtimin, shembullin dhe nxitjen e prindërve!

## Edukata e punës.

*Pëlburës shibi anën, vajzës (fëmijës) nënën, -thotë populli. Dembelët dhe punëtorët rriten në shtëpitë tona. Asnjë fëmijë nuk ka lindur punëtor apo dembel, ai është bërë i tillë. Ku? Në familje në radhë të parë. Lidhur me edukimin e fëmijëve në punë ka shumë koncepte të gabuara që gjallojnë në familje. Fëmijët duhet të kryejnë të gjitha punët që u takojnë duke filluar nga vetëshërbimi, por jemi kundër tendencës së disa prindërve që i shohin fëmijët e vet të mitur si burim i të ardhurave, duke i shfrytëzuar që kur janë ende të njomë.*

Feja jonë Islame i sheh të gjitha problemet e edukimit me shumë seriozitet dhe jep këshilla e porosi që janë me shumë vlerë për të gjitha kohët. Ne do të kemi rast të flasim për këtë, kur do të trajtojmë aspektet e veçanta të përbajtjes së edukimit në familje.

# Edukimi fizik

## 1. Rëndësia dhe detyrat e edukimit fizik

Njeriu është krijesa më e përkryer dhe më e përsosur e All-llahut xh.sh. Trupi i njeriut, mendja e tij, zemra dhe ndjenjat e tij janë një mrekulli e vërtetë që shpalosin në mënyrën më të plotë mundësitë e Krijuesit të plotfuqishëm. Ndërtimi anatomo-fiziologjik i trupit, veprimtaria e lartë mendore, lartësia shpirtërore në të cilat janë mëshiruar cilësitë më të larta, nuk mund të krahasohen me asnje krijesë tjetër. Ata janë dhënë në formën më të përsosur. Pikërisht, për këtë arsyе ne jemi të detyruar ta ruajmë trupin tonë, ta ruajmë mendjen dhe shpirtin tonë nga çdo e keqe që mund të na vijë nga jashtë. Kur njeriu është fëmijë këtë detyrë e kanë prindërit. Ata janë përgjegjës për mirërritjen e fëmijëve të vet. Kur njeriu fillon e rritet, dora- dorës nis t`i bëjë shërbime trupit të vet, ta ruajë dhe ta mbrojë atë. Që fëmijë njeriu duhet të kuptojë qartë se sa rëndësi ka pamja e jashtme, fuqia trupore, zhvillimi i rregullt dhe harmonik i trupit të tij, po kaq rëndësi, madje edhe më tepër është formimi shpirtëror dhe edukimi i mirë i tij. Lidhur me këtë në një hadith që e transmeton Ebu Hurejre, i Dërguari i All-llahut, Mu-

**hammedi** a.s. ka thënë: “*Vërtetë All-lahu nuk shikon në trupat tuaj as në fizionominë tuaj, por shikon në zemrat tuaja dbe punët tuaja*”.

Mirërritja e trupit është themeli mbi të cilin do të mbështetet trajtimi i fuqive shpirtërore. “*Në një trup të shëndoshë, një mendje e shëndoshë*”.

Populli, familja, shoqëria me institucionet e veta edukimin fizik e kanë trajtuar gjithnjë si një element të përhershëm të edukimit të njeriut, madje sa më pak e zhvilluar ka qenë shoqëria aq më i domosdoshëm ka qenë për çdo njeri zhvillimi i mirë fizik, shëndeti, forca e kalitja fizike. Sa më të vështira kushtet e jetës, sa më e rëndë puna, aq më e domosdoshme ka qenë e mbetet nevoja për të pasur një fizik të formuar mirë. Krahasoni një punëtor krah, një druvar, një punëtor pylli, një murator që punon në skelat e larta të pallateve më një punonjës në zyrat e ngrohta dhe komode. Ndryshimet janë të dukshme.

Në kushtet e sotme, kur njeriu është lehtësuar nga shumë punë fizike dhe ka futur në përdorim teknikën e teknologjinë moderne, lind nevoja e kompensimit të kësaj veprimtarie me ushtrime fizike e gjimnastikore. Komoditetet kanë tendencën ta shkëpusin njeriun nga natyra, nga ajri i pastër, nga puna e drejtpërdrejtë fizike. Mund të ndodhë që të rritet djali apo vajza e të mos zëré punë fizike me dorë, kështu që çdo lëvizje trupore e vështirësi që kërkon energji fizike, i duket e rëndë dhe e bezdisshme. Vëreni një grua që i lan rrobat me maçin, sesa shqetësohet kur i prishet ajo dhe detyrohet t'i lajë me dorë. Nuk po përmendim se sot rrobat lahen në mjesëtës të ngrohta vetëm duke shtypur një buton, ndërsa ka akoma gra që i lajnë në ajër të pastër, në erë dhe të ftohtë tek burimi duke vënë në punë forcën e krahëve. Këto dy gra kanë ndryshime të mëdha. Vërtetë e para i ka du-

art tē buta, ndërsa e dyta tē ashpra, por krahët dhe fuqia fizike e së dytës është për t'u pasur zili, pa përmendur karakterin, energjinë jetësore dhe zhdërvjelltësinë e saj. Shkurt sot, kur mendja e lehtëson krahun, nuk duhet harruar se kjo mendje ka nevojë tē rifreskohet nga një trup i shëndetshëm e i fuqishëm fizikisht. Këtë e bën edukimi fizik.

## 2. Cilat janë detyrat e edukimit fizik?

*Së pari*, edukimi fizik shërben për tē forcuar shëndetin, për tē kalitur organizmin, për ta zhvilluar atë në mënyrë harmonike, për tē zgjatur jetën, për tē luftuar me sukses sëmundjet, për tē kapërcyer vështirësitë që mund tē hasë njeriu në jetë.

*Së dyti*, përmes edukimit fizik fëmijët marrin elementet e domosdoshme dhe njohuritë e para për lëvizjet, për kulturën fizike, lojërat, sportin, zhvillohen shkathtësitë e shprehitë lëvizore, forca, rezistenca, qëndresa, shpejtësia, shkathtësia, etj.

*Së treti*, përmes edukimit fizik dhe mirërritjes së trupit zhvillohen edhe cilësitë morale dhe estetike, zhvillohet karakteri, vullneti, personaliteti dhe individualiteti i fëmijës apo i njeriut. Edukohet guximi, këmbëngulja, vendosmëria, nxitet e zhvillohet iniciativa, lidhja e bashkëpunimi me shokët e njerëzit e tjerë, formohet ndjenja e detyrës dhe e përgjegjësisë ndaj vetes dhe tē tjerëve, forcohet aftësia për tē duruar dhe kapërcyer vështirësitë. etj. Lidhur me durimin All-llahu i Madhërueshëm thotë: “*O besimtarë, kini durim dbe jini tē qëndrueshëm*” (Kur’ani: Ali Imran, 200). Ndërsa në një ajet tjetër thuhet: ”

*...ndërsa ata që janë të durrueshëm u jepet shpërblim të pa kufizuar*". (Kur'ani: Ez-Zumer, 10). Edukimi fizik ndikon fuqishëm edhe në kontrollin e ndjenjave, sidomos në vetëpërmbytje. Lidhur me këtë **Pejgamberi** ynë i nderuar a.s. ka thënë: "**Nuk është trimëri në dyluftim (mundje), por trimëri është ta përbash veten nga zemërimi**".

*Së katërti*, formimi i cilësive fizike dhe morale e përgatisin njeriun edhe për punë. Çdo punë fizike ka elemente lëvizore. Një trup i zhvilluar mirë me një sistem eshtëror e muskujve të zhvilluar harmonikisht me të gjitha organet tjera e përgatisin njeriun për punë.

Në bisedat e përditshme ndeshemi me koncepte të tillë, si: *arsim fizik, zhvillim fizik, përgatitje fizike, përsosmëri fizike*, etj. Këto janë koncepte pak a shumë teknike, por në edukatën familjare gjithsesi përfshihen dhe prindërit duhet të kenë të paktën njojuri fillestare.

**Arsimi fizik** përfshin përgatitjen me njojuri, shkathtësi e shprehi të caktuara lëvizore për të kryer ushtrime të ndryshme fizike, me qëllim që ta drejtojë organizmin për një kohë sa më të gjatë. Duam të jetojmë me shëndet të plotë në çdo mjedis, në gjithfarë kushtesh favorizuese apo edhe të vështira, penguese dhe dëmtuese. Kjo është baza e lumturisë njerëzore. Njeriu i përgatitur fizikisht shfrytëzon në maksimum kushtet e mira dhe ka përcen pa shumë vështirësi pengesat që mund t'i dalin në jetë. A nuk keni vënë re që shumë njerëz dëshpërohen para një pengese që dikujt tjetër i duket jo shumë e vështirë? Kjo ndodh, sepse e ka parapërgatitur veten dhe e ka sprovuar sa e sa herë.

**Zhvillimi fizik** është procesi i shndërrimit të vazhdueshëm (progresiv) të organizmit, i cilësive fizike, i të dhënave antropometrike dhe i gjendjes shëndetësore që pëson njeriu nën ndikimin e kushteve biologjike dhe të

trashëgimisë, të kushteve shoqërore, edukative dhe arsimore. Theksuam se zhvillimi fizik varet nga shumë faktorë, por në mes tyre dallohen predispozitat biologjike dhe të trashëgimisë. Kjo nganjëherë ka vlera përcaktuese. Shtatlartësia p.sh. varet në radhë të parë nga trashëgimia. Një fëmijë i shkurtër me të dhëna biologjike të trashëguara, vështirë se mund të zgjatet me çfarëdo mase edukative që mund të ushtrojë prindi apo një specialist. Ai zhvillohet normalisht, kur i krijoen kushte të favorshme ose nuk zhvillohet si duhet në kushte të vështira e penguese. Pavarësisht nga shtatlartësia fëmija mund të bëhet i shkathtë, i zhdërvjelltë, i fortë, rezistent, i kalitur etj. Një shtatlartë mund të ketë favore, por në jetë nuk ia kalon një djali apo vajze më të shkurtër, por të zhdërvjelltë. Kjo ndodh jo vetëm në rrethanat e zakonshme të jetës, por edhe në ato speciale, siç është rasti i sportit. Një futbollist është mirë të jetë shtatlartë, por kjo nuk është themelore në krahasim me disa cilësi të tjera që mund t'i ketë fituar një më i shkurtër.

Prindi duhet të interesohet për disa të dhëna antropometrike, si: pesha e fëmijës, shtatlartësia, perimetri i kraharorit, gjatësia e kërcirit, e kofshës, e krahut, e parakrahut, e trungut, vëllimi i mushkërive etj., etj., përmasa që shkolla i ndjek, por janë të rrallë ata prind që interesohen për to, përjashto periudhën e parë të jetës, kur nëna është e interesuar për shtimin e peshës së fëmijës, që është një tregues i shëndetit të tij. Lidhur me këtë duhet të theksojmë edhe problemin e sëmundjeve të trashëguara në familje, sëmundje që mund të barten tek breznitë e reja. Trashëgojen p.sh. disa dobësi të sistemit eshtëror. Rasti më i dukshëm janë fëmijët çalamanë, defekt ky që mund të konstatohet që në lindje. Vetëm nga pakujdesia e prindit apo edhe e mjekut, ka fëmijë që çalojnë përjetë. Disa sëmundje të sistemit nervor trashëgo-

hen. Në fillim ato shprehen me grindje e qarje, por që vijnë duke u rënduar e kërkojnë një ndihmë të specializuar mjekësore. Disa sëmundje të tjera si ato të stomakut, të veshkave, të sistemit të qarkullimit të gjakut, të tensionit, të metabolizmit, të anemive etj. trashëgohen, prandaj duhen njojur e trajtuar me kujdes që në fëmijëri. Një gjë ka rëndësi, ata nuk janë fatalitet, mund të përballohen duke u ndërgjegjësuar prindërit dhe fëmijët që e kanë këtë të keqe. Sëmundja ndoshta nuk mund të shërohet, por lehtësohet, përballohet. Ajo është një sprovë shpeshherë e vështirë që mund të lehtësohet me durim, kështu që njeriu jeton si gjithë të tjerët, natyrisht me disa rezerva. Ka shumë të sëmurë që bëjnë një jetë normale duke e ruajtur shëndetin me shumë vullnet e duke kapërcyer shumë vështirësi, por ka të shëndoshë që vuajnë më shumë se të sëmurët nga pakujdesia dhe teprimet në jetë. Natyrisht, këto nuk janë thjeshtë probleme të higjenës dhe të edukatës shëndetësore, ato lidhen edhe me besimin në kaderin e All-llahut xh. sh. xh.sh.. Duke kuptuar se sëmundja është një sprovë e All-llahut, i sëmuri bën durim dhe i mbështetet mëshirës së të Plotfuqishmit duke bërë të gjitha përpjekjet për të marrë ndihmën e duhur mjekësore apo duke kapërcyer ngasjet e të ndaluarave.

**Përgatitja fizike** synon në zgjidhjen e detyrave praktike të jetës në sporte të ndryshme apo në punë civile dhe ushtarake, si: në veprimtarinë e atletit, gjimnastit, polumbarit, zhytësit në thellësi të ujërave, alpinistit, pilotit, etj., etj. Në disa raste përgatitja fizike e specializuar duhet të fillojë herët, që në moshën e njomë parashkollore. A keni vënë re që disa fëmijë në gjimnastikë artistike bëhen rekordmenë që në moshë fare të re? Po kështu ngjet me sportet e tjera. Kjo përgatitje fillon me interesimin direkt të familjes pa ndihmën dhe kujdesin e së cilës suksesi është i dyshimtë. Kështu ngjet me instrumentistët etj.

**Përsosmëria fizike** është shkalla më e lartë e zhvillimit dhe e përgatitjes së gjithanshme fizike. Ajo shprehet në zbatimin me përpikëri e mjeshtri të lëvizjeve dhe ushtrimeve fizike. Këtu nuk vlejnë vetëm ushtrimet, por duhet vullnet, këmbëngulje, aftësi për të sakrifikuar e guxim në kapërcimin e vështirësive. Një fjalë e urtë thotë: "Një talent e nëntë punë".

**Kultura fizike** është tërësia e arritjeve në fushën e teorisë dhe të praktikës së edukimit fizik.

Cilët janë mjetet e zhvillimit të trupit dhe të edukimit fizik?

Ushqimi është mjeti i domosdoshëm i tipërtëritjes së fuqive fizike dhe i zhvillimit trupor. Me ushqimin e fëmijëve dhe të të rinjve duhet të tregohet shumë kujdes, që të gjendet masa e duhur për të qëndruar gjithnjë në mes të mundësisë, nevojës dhe teprisë. Sot vihet re tendenca e teprimeve në ushqimin e fëmijëve, pa marrë parasysh nevojën për sasinë e kalorive apo të përbërësve të tjerë, si: vitamina, yndyra, proteina etj. Shpesh prindërit, sidomos nënët i mërzisin dhe i velin fëmijët me ushqime të tepërtë. Fëmijët kryesisht priren nga frutat dhe gjërat e ëmbla. Kjo ka arsyet e veta, ushqimet me shumë yndyrë i velin fëmijët, ato bluhën më me vështirësi. Kërkohen ushqime të kombinuara, ushqime që kanë vlera dhe ndikojnë në organizmin e fëmijës. Të ushqyerit duhet bërë me rregull e me orar dhe jo kurdo e pakujdes. Ushqimi të jetë i koncentruar, të tretet dhe të thithet lehtë nga stomaku. Duhet të ketë variacion në ushqimin e fëmijëve sipas vakteve të ndryshme, sepse era dhe shija e tyre velet. Pijet alkoolike janë rreptësishtë të ndaluara, ato sjellin dëme jo vetëm për shëndetin, por edhe përmoralin. Kjo vlen edhe për duhanin dhe gjërat e tjera të ndaluara (haram).

Veshmbathja, rrrobat dhe këpucët kanë vlerën e vet

për mbrojtjen e trupit. Në verë duhet të jenë të lehta, të freskëta, të lejojnë ajrosjen e trupit, ndërsa në dimër të ngrohta, por të mos i pengojnë fëmijët të lëvizin. Tendenca e sotme e shumë nënave është t'i veshin fëmijët bukur. Disa të rinj, të prirë nga eleganca preferojnë të mërdhasin me një palë xhinsa akull të ftohtë e me një bluzë, mjafton që të duken bukur. Nënët e reja i stolisin fëmijët duke u nisur nga kërkesat e së bukurës por jo të higjienës, duke bërë që fëmijët të mos jenë të zotët as të lëvizin, as të luajnë. Kur shokët zhgërryhen në barë të njomë apo në pluhur gjatë lojës, ata i shikojnë e kanë frikë se ndyhen e shkyhen. Kjo sjell efekte shumë të dëmshme në cilësitë e tyre fizike dhe morale, sepse, kur marrin guximin të futen në lojë, bëhen qullë në djersë nga rrobat e papërshtatshme.

Në historinë e edukatës ka shembuj shumë interesantë për ushqimin dhe veshjen e fëmijëve dhe të rinjve. Ushqimi i thjeshtë, rrobat e lehta dhe stërvitja fizike ishin mjetet e edukimit të burrave të fuqishëm.

Kushtet natyrore, ajri, uji, dielli janë mjete të rëndësishme për forcimin e shëndetit dhe për kalitjen e organizmit. Këto kombinohen me veprimtarinë fizike, me faktorët higjienikë (ushqim e veshje) dhe me regjimin ditor të fëmijëve. Tendenca e shumë nënave për t'i mbajtur fëmijët brenda shtëpisë, në dhoma me pak ajër e me pak diell është shumë e dëmshme, kështu fëmijët rriten të dobët dhe anemikë, nuk kanë oreks, preken lehtë nga shumë sëmundje.

Në mendimin pedagogjik botëror është i njojur Russo i cili kërkonte që fëmijët të rriten në gjun e natyrës, të bredhin lirisht në livadhe e pyje, të lozin e të dëfrejnë në qiellin e hapur, në ajrin e pastër, në diellin e ngrohtë e duke bredhur të mësojnë. Ndërsa sot shumica e fëmijëve të ulur mbi libra, pranë televizorit, me kasetofonë tek

veshi, të ngujuar në klasat e shkollës për shumë orë, rrëzik se nuk kanë kohë as të marrin frymë. Kërkesat për zhvillim mendor i kanë zbehur kërkesat për zhvillim fizik. Kjo nuk është e drejtë.

Loja shërben dhe u përgjigjet të gjitha nevojave që ka fëmija për të zhvilluar gjymtyrët e njoma dhe për të shprehur e formuar cilësitë e karakterit. Loja ka rëndësi për zhvillimin e fuqive shpirtërore, ajo është një faktor i madh në edukatë si për djemtë ashtu edhe për vajzat. Loja e zakonshme vë në lëvizje disa pjesë të muskujve. Ajo duhet të jetë interesante. **Spencer**, një pedagog i shquar, thotë: “*Ka shumë rëndësi interesante cilin bën fëmija në lojë, gëzimi i madh që provon e shpërthen, dredhitë e mënyrat që trillon, sikurse edhe kujdesi e mundi që bën për t’ia dalë në krye lojës duke arritur rezultate fitimi*”.

Lojërat janë të ndryshme e me qëllime të ndryshme. Përmes lojës zhvillohen cilësitë fizike e lëvizore, përsoset vrojtimi e gjykimi, formohet vullneti e karakteri, fitohet përvoja shoqërore. Loja është një mjet me rëndësi për t’i aftësuar fëmijët për jetën. Më mirë se në lojë askund tjetër nuk shfaqet personaliteti i fëmijës në formim e sipër.

Lojërat mund të janë të ndryshme e të larmishme, si: lojëra lëvizore, imituese, sportive, parasportive, krijuese, popullore etj.

## Regjimi ditor

Regjimi ditor, rregulli në oraret e gjumit, pushimit dhe të veprimtarive kanë vlera të mëdha edukative, në shumë raste regjimi ditor është përcaktues në krijimin e shprehive dhe të zakoneve të mira tek fëmijët. Në

shumë raste regjimi ditor i imponuar nga të rriturit bën që fëmijët të jenë këmbëngulës, të rregullt, të vullnetshëm, sistematikë në çdo veprimitari. Ata shquhen mes tjerëve në rregullimin e marrëdhënieve me vetveten dhe me shoqërinë në bazë të disa detyrimeve që i kanë të paravendosura, të parapërcaktuara të cilat varen në shumë raste nga këmbëngulja e tyre sistematike për të zbatuar regjimin ditor. Njerëzit dhe fëmijët nuk mund të kenë as kulturën, as disiplinën e punës pa pasur të qartë veprimtarinë e tyre sistematike në bazë të orareve të veprimit që zbatojnë çdo ditë dhe në çdo kohë. Nuk mund të shquhen si njerëz sistematikë, të rregullt dhe këmbëngulës pa zbatuar që në fëmijëri rregullat e ngulitura të paravendosura sipas regjimit ditor. Mendoni një fëmijë që zgjohet, ushqehet, shkon në shkollë, mëson dhe kryen detyrat, lot dhe argëtohet pa rregull, pa regjim. Mendoni se në çfarë vështirësish do të haset në shtëpi, në rrugë me shokët apo edhe në shkollë. Jo vetëm në sjelljen dhe qëndrimin e tyre moral, jo vetëm në disa tipare të personalitetit të tyre, jo vetëm në kulturën e punës së tyre, regjimi ditor ndikon fuqishëm edhe në shëndetin e tyre. Duke kombinuar drejtë gjumin, pushimin dhe veprimitarën, fëmija, i riu dhe i rrituri do të arrijnë të kenë një rezistencë më të madhe ndaj dëmtimeve fizike të përgjithshme, por sidomos ato që lidhen me sistemin nervor, madje edhe me shëndetin mendor.

Natyrisht ne këtu do të japim vetëm në vija të përgjithshme disa probleme të regjimit ditor, pa synuar aspak që të japim rekomandime konkrete në këtë fushë.

Përcaktimi i regjimit ditor ndërvaret nga shumë faktorë:

Nuk mund të vihet një rregull tek fëmijët për regjimin e tyre pa pasur parasysh regjimin e të rriturve që janë pjesëtarë të familjes. Ata përgjithësisht janë në marrëdhënie pune dhe kanë orare shumë të ndryshme vep-

rimesh nga fëmijët.

Nga disa rregulla fikse dhe orare që duhen respektuar, si p.sh. nga oraret e vakteve të faljes (salati), nga oraret e mësimeve në shkollë apo në veprimtaritë tjera, si: kurse, veprimitari kulturore, sportive ku fëmijët janë angazhuar, me disa orare që lidhen me disa veprimitari të përcaktuara në familje, ose me disa programe që fëmijët i ndjekin rregullisht nga televizori, radioja etj.

- Nga mosha e fëmijëve.
- Nga gjendja dhe mundësitë e personit që merret direkt me fëmijën që në shumicën dërmuese të rasteve është nëna, gjyshja, apo dadoja (mëndësha) etj.

Nga oraret gjeografike apo biologjike në bazë të cilave është i kushtëzuar edhe orari apo raporti gjumë, pushim, veprimitari.

## Disa dukuri që vihen re

- Në shumicën dërmuese të rasteve oraret e pushimeve janë të lidhura me natën dhe me drekën, kur edhe shumica e njëzet e nënët këto kohë edhe pushojnë apo e ndërpresin veprimitarinë e tyre.

Sipas moshave nata në shumë raste nuk përputhet me orët gjeografike, ajo ndryshon sipas stinëve dhe kohës apo kushteve atmosferike. Në dimër, kur është ftohtë, furtunë apo bije shi fëmijët madje edhe të rriturit kanë përgjumje, kanë nevojë të pushojnë apo të struken në shtratin e ngrohtë apo në prehrin e nënës.

Koha e pushimit apo më mirë e gjumit në moshën 1-3 vjeç është e ndryshueshme sepse fëmija në këtë

moshë ka shumë nevojë për gjumë, sikurse e thotë qartë edhe shprehja në gjuhën popullore “Gjumi e rrit fëmijën”. Madje që në fëmijëri mësohen me urimin “Gjumë të ëmbël” kur nisen të flenë. Në këtë moshë, 0-3 vjeç studimet shkencore kanë përcaktuar standarde rekomanduese rigoroze për t'u zbatuar nga prindërit. Për këtë është mirë të bazohemi në përvojën familjare, por edhe të konsultohemi me mjekun pediatër që kujdeset për fëmijët. Literatura shkencore rekomandon oraret më të përshtatshme për regjimin ditor të fëmijëve në këtë moshë. Por këtu theksojmë se mosha 0-1 koha për gjumë është shumë më e gjatë se në moshat e mëvonshme. Pjesën më të madhe të kohës fëmija e kalon në gjumë.

Por edhe këtu vihen re disa dukuri negative, ndonëse ka vetëm dy palë: nëna dhe fëmija.

- Ndërhyrjet e nënave tash e parë për t'i ushqyer fëmijët, gjoja duke shprehur dhembshuri dhe dashamirësi ndaj tyre, bëhen shkak për ndryshime apo ndërprerje të regjimeve që duhet të zbatojë fëmija. Natyrisht gjatë kohës së gjumit fëmija shpreh në forma të ndryshme shqetësime apo pakënaqësi. Nëna të gjitha këto i merr si sinqale kërkese dhe ndihme, shqetësohet pa arsy e dhe ndihma kryesore është miklimi ose edhe ushqimi i fëmijës. Jo rrallë nga dëshira për ta ndjerë pranë vetes fëmijën aq shumë të dëshiruar, sa herë ai lëviz apo edhe reagon në një farë mënyre, nëna fillon të bisedojë e ta ledhatojë, e merr në gji, i jep të pijë nga qumështi i saj. Natyrisht fëmija zgjohet, mësohet me ledhatimet e nënës, e kështu vazhdon ditë për ditë ta shqetësojë nënën dhe veten. Nënët në këtë rast prishin oraret e gjumit të fëmijëve të vet, e jo vetëm kaq por prishin edhe oraret e gjumit që atyre iu duhen domosdo për të rimarrë forcat e për të qenë të gatshme gjatë ditës për të gjitha punët dhe nevojat që ka fëmija i vogël. Gjatë një periudhe prej

18 orësh në 24 orë që ka dita, fëmija i vogël zakonisht është në gjumë. Në kohën e darkës 8-10 orë fëmija duhet patjetër të jetë në gjumë dhe të mos ndërhyhet nga prindi për t'ua prishur atë. Por gjatë kësaj kohe ai edhe lëvizë, bezdiset nga shumë faktorë, si: nevojat për ushqim, temperatura e ulët apo e lartë, papastërtia, zhurmat në ambientet për rrith, dritat etj. Në këto raste nuk ka asnje arsy që nëna të rrijë me sy hapur dhe të ndërhyjë, t'ia prish rregullin qoftë edhe duke i dhënë të pijë.

- Në moshat nën dhe mbi një vit fëmijët fillojnë e marrin vese e zakone të këqija. Ato gjejnë gjithfarë mënyrash për të urdhëruar më të rriturit dhe posaçërisht nënët që t'u rrinë gati për të plotësuar nevojat e tyre. Këto gatishmëri në emër të dashamirësisë që tregojnë nënët, krijojnë kushtet e favorshme që regjimi i fëmijëve të prishet dhe të lindin ato vese dhe mënyra të urdhëruari apo kërkesa që në shumicën dërmuese të rasteve shogërohen me qarje dhe ankesa. Nënët për t'ua mbyllur gojën, fillojnë dhe jua plotësojnë këto kërkesat gjë që bëhet shkak për thyerje të rregullave dhe prishje të orareve të gjumit dhe të ushqyerit. Fëmija kërkon të hajë orar pa orar. Në gjuhën e përditshme nënët thonë se ai lot dhe jo rrallë kënaqen me këto lodra të tyre, por shumë shpejt e kuptojnë se fëmijët tashmë nuk u binden, nuk flenë kur duhet dhe ushqehen kohë e pa kohë, qajnë dhe anohen pa arsy, i shqetësojnë dhe i lënë pa gjumë dhe pa punë nënët dhe të afërmit tjerë. Natyrisht ndërhyrjet e pjesëtarëve tjerë të familjes, e sidomos e gjyshërvë vetëm sa e përkeqësojnë gjendjen. E këtu lindin ankesat e prindërve se fëmija nuk ka gjumë, nuk ushqehet mirë dhe në kohën e duhur. Harrojnë se vetë ato janë shkaktarë të kësaj gjendjeje, ata vetë e kanë prishë regjimin ditor të fëmijës.

- Kur fëmija fillon e shkon në shkollë, lindin proble-

me e vështirësi edhe më të mëdha. Kjo koincidon me moshën 3 vjeç kur fëmija duhet të futet në sistemin e arsimit parashkollar, zakonisht në kopshte që përputhet me moshën 3-6 vjeç e më vonë në etapat tjera të shkolimit. Shqetësimet shtohen se tani oraret e zgjimit, të ushqyerit, të pastërtisë, të përgatitjes për shkollë, të kohës që qëndrojnë në shkollë ndryshojnë dhe patjetër ndikojnë shumë në gjendjen psikologjike dhe fizike të fëmijës. Detyrimet dhe urdhrat janë më të prera, më të shpeshta. Kundërshtimet e fëmijëve bëhen më të shumta dhe këmbëngulëse. Lëshimet e prindërve bëhen më të rrezikshme për shëndetin e fëmijëve, por sidomos për disa tipare të karakterit dhe të formimit të shkathtësive, shprehive dhe zakoneve të mira. Po marrim një shembull. Fëmija pas mësimit ka ngrënë, ka fjet ose edhe ka pushuar, fillon detyrat. Sa më të vegjël janë aq më shumë ndihmë duan. Por kjo ndihmë duke u tepruar, bën që fëmija të bëjë naze, i kërkon përgjigjet dhe detyrat gati nga prindi, i zgjatë më kot muhabetet dhe shton shkallën e vështirësive. Natyrisht koha kalon, prindërit rezistojnë, duan që fëmija të veprojë vetë, por më në fund bëjnë lëshime dhe në shumë raste detyrat janë fryt i punës së nënave dhe aspak i mendjes dhe i përpjekjeve të vetë fëmijëve. Shkurt prindi për hir të kursimit të kohës apo edhe për dhembshuri ndaj djalit apo vajzës, bën lëshime, futet vetë në punë dhe e ka më lehtë të punojë vetë se sa fëmija. Në këto raste ka edhe shumë faktorë tjerë që ndikojnë negativisht. Po përmendim shkurt: programet televizive që i ftojnë fëmijët, bisedat e më të rriturve kur fëmija për shumë arsyе punon në dhomën e ndejës, shokët e shoqet që kërcasin tash e parë në derë dhe i ftojnë për lojë, zhurmat e fëmijëve që lozin në oborr, dembelia dhe shumë vështirësi tjera që shprehët në forma të ndryshme nga fëmijët. Më e shpeshta është shprehja e lodhjes,

përgjumja, uria etj. Ata bëjnë gjithfarë "lodrash" vetëm që të shtyjnë kohën e kryerjes së detyrave mësimore.

Duhet kuptuar mirë nga çdo prind se puna mendore është një nga llojet më të vështira të punës për fëmijët, madje edhe për të rriturit. Kryerja e kësaj pune shpejt, me rregull, në kohën e duhur krijon shumë përparësi në mbarëvajtjen e fëmijëve në mësimë. Zvarritjet e zakonshme, lëshimet që vijnë nga dobësia e prindërve dhe nga këmbëngulje e fëmijëve të mësuar keq dhe të pabindur, prishin regjimin ditor, koha zë kohën dhe zvarritjet bëhen shkak që tek fëmijët të krijohen shumë vese e cilësi negative që shprehen në nivelin e tyre mendor, në prapambetjen në mësimë, në mungesën e rregullit dhe të përgjegjësisë për detyrat etj.

- Në mjaft raste në shtëpi në emër të kujdesit prindërit bëhen shkak që fëmijëve të mos u krijohen raporte të drejta mes qëndrimit në shtëpi, në ajër të ndotur të mjedisit ku banojnë dhe mundësisë që fëmijët një pjesë të kohës ta kalojnë jashtë në ajër të pastër në lodra zbatitëse lëvizore, ose edhe në punë në kopshtin apo në arën e shtëpisë. Kjo dukuri vihet re dhe është e lidhur me disa shfaqje të kujdesit të tepruar të familjes:

- Në shumë raste nënët kujdesen shumë që vajzat sidomos që ato të përparojnë mirë në shkollë. Prandaj edhe u kushtojnë shumë vëmendje kohës së mësimit dhe të kryerjes së detyrave. Madje kur vjen koha për disa punë të detyruara të familjes ku fëmijët duhet futur që herët dhe të jenë pjesëtarë aktivë, nënët bëhen shkak që vajzat t'u shmangen këtyre punëve dhe ata vetëm të përqendrohen tek mësimi. A nuk keni vënë re që shumë vajza në vend që të shtrojnë tavolinën, të servirin gjellët, të kryejnë punët mbas ngrënies, nxiten nga nënët që këto punë t'i lënë dhe të merren vetëm me mësimin. A nuk ngjet kështu edhe për shumë punë tjera në familje?

Pse djali apo vajza në shtëpi të kalojë një kohë më të gjatë në punët mësimore dhe të mos ketë një ndarje të drejtë në kohë mes punëve në familje. Mendoni sa shumë punë ka shtëpia. Pse të gjitha këto të mos kryhen bashkërisht prindër dhe fëmijë me rregull e dora dorës? Pse nëna të robtohet në punë dhe fëmijët vetëm të mësojnë, vetëm të shohin në televizor apo edhe të luajnë brenda dhomave me pak ajër dhe jo jashtë në natyrë.

- Në familjet tona po bëhet traditë tashmë që shumicën e kohës fëmijët ta kalojnë brenda mureve të shtëpisë. Ata merren me studim, me detyrat shtëpiake që u jepen nga mësuesit, me lexim librash, me shikime të programeve televizive, me internet etj. Shumë prindër në emër të zhvillimit mendor të fëmijëve ua rrisin kohën e qëndrimit brenda duke i regjistruar në gjithfarë kursesh private. Ka fëmijë që e gjithë dita u kalon në punë mendore, të ndryrë në ambiente të mbyllura. Nuk vlerësohet sa duhet koha që do t'u lihet fëmijëve në dispozicion për lojë ose edhe për punë jashtë ambientit të shtëpisë.

Por krahas këtyre vihen re raste flagrante që duhen qortuar menjëherë:

Mjaft fëmijë e në radhë të parë djem e kalojnë kohën në lodra të ndryshme me shokët pa u kujtar se kanë shumë detyra për të kryer. Ata lodhen jashtë mase, djersiten, ndoten dhe kur vijnë në shtëpi nuk janë të zotë as të hanë, e jo më të kryejnë shumë detyra mësimore për të nesërmen. Në këto raste kujdesi i të rriturve është i domosdoshëm. Loja në ajër të pastër është e mirë, me shumë vlera, por me kohë dhe me orar. Liria e tepruar në këto raste ndikon negativisht në oraret e veprimeve të fëmijëve. Madje kjo bëhet shkak edhe për prapambetje të fëmijëve në mësime.

Një kategori fëmijësh, përgjithësisht në fshat por edhe në qytete ngarkohen nga familja me punë. Ka mjaft

prindër që nga nevojat ekonomike i nxisin dhe ç'është më keq i detyrojnë fëmijët të punojnë. Puna e fëmijëve është e dobishme atëherë kur ajo shërben për zhvillimin e shprehive apo edhe për nevoja të domosdoshme të familjes, por kur ajo merr karakter shfrytëzimi dhe bëhet në kurriz të detyrave tjera, krijon premisa për krijimin e dukurive negative dhe të veseve të këqija, le që ajo është shumë e dëmshme edhe për shëndetin e fëmijës. Një fëmijë që punon, që me punën e tij ndihmon ekonominë familjare, një fëmijë që këtë e bën me nxitjen dhe detyrimin e prindërve i është ekspozuar shumë rreziqeve. Natyrisht ai piqet para kohe, por përfundimet janë të rrezikshme, të dyshimta dhe ndikojnë në shumë fusha negativisht. Kjo duket në shumë raste edhe në shëndetin e fëmijëve gjë që vjen nga lodhja, nga stërmundimi, nga prishja e regjimit dhe nga mungesa e rregullit. Përfitimet e shpejta ekonomike, krijojnë shanse për pasoja negative të mëdha në të ardhmen.



# **Edukata e punës i ka rrënjet në familje**

## **1. Rëndësia dhe detyrat e edukatës së punës**

Jeta jonë mund të arrijë moshën 70 apo më shumë vjet. Sado mirë që të na shkojë jeta, ajo nuk është gjë tjetër veç mund dhe punë. Çdo ditë njeriu është në kërkim të një jete më të mirë. Këtë të mirë, këtë përparim gjithnjë e arrin me punë, me djersë dhe me përpjekje. Një dijetar thotë se lutjet ndaj All-llahut xh.sh. janë dy llojesh: lutjet me fjalë, të cilat mund të plotësohen nga Zoti xh.sh në këtë botë apo në botën e amshuar, ka edhe lutje tjera që bëhen përmes punës. Nëse bujku çohet herët në mëngjes, lëron, mbjell, prashit dhe ujit, korr dhe mbledh, kjo punë, ky mund i tij pa tjetër që do të shpërblehet nga Krijuesi i Gjithësisë. Puna e ndershme, mundi dhe djersa e derdhur, patjetër që do të shpërblehen. Kjo lutje merrret parasysh menjëherë nga Zoti i madhërishëm. Feja islamë e cilëson punën si ibadet. Ajo është adhurim ndaj Krijuesit, i cili vërtetë krijoj gjithçka në dobi të njeriut, por kjo përfitohet vetëm me punë.

Detyrat e edukatës së punës janë të shumta. Fëmija duhet të njihet e të mësojë konceptet e para për punën, për lëndët e para, për proceset e punës, për veglat e mje-

tet tjera ndihmëse, të dijë të organizojë punën e shumë probleme që lidhen me kulturën dhe disiplinën e saj. Ai duhet të përvetësojë shkathësitë e shprehitë e domosdoshme për punë. Të gjitha këto formohen gradualisht, rast mbas rasti në familje, shpeshherë nën shembullin e më të rriturve. Puna është edhe urdhër Hyjnor. All-llahu xh.sh në **Kur'anin Famëlartë** thotë: "*Ai është që juve tokën ua bëri të përshtatshme, andaj ecni nëpër pjesë të saj dbe shfrytëzoni begatitë e Tij, vetëm te Ai është e ardbmja*" (Kur'ani: El-Mulk:15)

## Puna është nevojë

Vetëm puna e pandërprerë mund ta bëjë njeriun të kënaqur. Sikur peshku që ka nevojë për ujë, ashtu edhe njeriu ka nevojë për punë. Arsyja e secilit, provat e jetës, vrojtimet e shumta gjatë gjithë kohërave dëshmojnë se lumturia më e madhe nuk gjendet aty ku pasuria e zhduk nevojën e punës. Fjala e popullit "Dembelia nuk i ka qitë gjë kujt" e tregon qartë këtë të vërtetë, se pa punë nuk mund të jemi të lumtur. Dembelia është nëna e të këqijave. Jeta e shkuar pa punë është një vdekje e sigurt, vdekje fizike, vdekje ekonomike, vdekje morale. Një njeri që nuk vë në punë të dobishme mendjen dhe trupin, ai sëmuret më lehtë, ai jepet më lehtë pas epsheve e gëzimeve të tepërtë të kësaj bote, ai vdes para kohe. Nuk është fjala thjeshtë për vdekje fizike, por për vdekje shpirtërore e morale. Pra puna është një nevojë dalluese e njeriut, është nevojë jo vetëm për trupin, por edhe për shpirtin. Njeriu e ka në natyrën e vet nxitjen, zekthin e punës, vetë instinkti e shtyn t'i vërë në punë fuqitë e veta trupore e shpirtërore. Puna është nevojë për njeriun sa ç'është drita, ajri, uji, ushqimi etj. Kur njeriu me punë fi-

ton sa për të plotësuar nevojat e përditshme të jetës, ka kohë e mendon për më mirë. Sapo t'i çlodhen gjymtyrët e t'i ripërtërihen forcat, pikërisht atëherë kërkon të gjejë fusha të tjera veprimi, mendon si të fillojë një punë tjetër më të madhe, më me vlerë e me rezultate më të larta.

## Puna të jep vlerë

Një njeri që është i zoti të bëjë një punë të vlefshme me fuqitë e veta fizike, mendore apo shpirtërore, ai ka siguruar mjetin për t'ia rritur vlerën vetes, ai ia ka shtuar rëndësinë dhe dinjitetin vetes para të tjerëve. Jeta e njerëzve të shquar është një shembull bindës se me punë mund të rritet vlera dhe dinjiteti njerëzor. Hazreti Muhammedi a.s. duke qenë një jetim i varfër, një çoban dhensh, nuk ka ditë shkrim-leximin, me punë të ndershme arriti të bëhej një bashkëpunëtor i denjë në tregti duke administruar me ndershshmëri pasurinë e zonjës së nderuar Hatixhe, me punë këmbëngulëse u bë një udhëheqës i denjë në fushën fetare, administrative, ekonomike, ushtarake dhe familjare, edukative arsimore e kulturore. Ai u bë i zgjedhuri i All-llahut xh.sh. dhe Pejgamberi i fundit i tij. Puna e pandërprerë, vullneti e këmbëngulja ia rrisin vlerën njeriut, ia ngrenë dinjitetin para shoqërisë, mund ta bëjnë njeri të shquar.

## Puna është provë, puna është shkollë

Njeriu në jetë mëson shumë. Mëson nga libri e nga shkolla, nga mjetet e kulturës dhe të propagandës, mëson nga prindi e njerëzit e tjerë që ka përreth, por kjo nuk është e mjaftueshme. Njeriu, sado të dijë, sado që të

ketë fituar njojuri në fusha të ndryshme, ai përsëri duhet të provojë fuqitë e trupit të vet, të gjymtyrëve të veta, të vullnetit e të karakterit të vet, të burrërisë së vet. Ai duhet të kalojë shumë prova, të bëjë shumë ushtrime, të bëjë shumë stërvitje, shumë punë dhe në punë e sipër të fitojë burrerinë, që punën e nisur ta çojë deri në fund. *S'bëhet vreshti me urata, por me shata e lopata*, -thotë populli.

Në punë njeriu mëson, mëson të gjejë rrugët më të lehta e më të dobishme, më me rendiment, më me fitim, mëson të përballojë e të kapércejë vështirësitë, mëson se mendja zhvillohet e ndërgjegjja forcohet vetëm duke u vënë në punë, duke u vënë në provë, duke parë rezultatet e punës. Pa punë dijet mbasin vetëm stoli, dijet kanë vlerë vetëm kur vihen në jetë, kur vihen në punë. Dijet e vëna në punë janë si pemët e mbushura me fruta.

### **Në punë njeriu hyn në marrëdhënie me veten dhe me shoqërinë**

Në punë e sipër njeriu kupton sa i vlen lëkura, dallon ç'është e mirë dhe e dobishme dhe ç'është e keqe apo e dëmshme për shëndetin dhe ndërgjegjen e vet. Njeriu gjatë punës hyn në marrëdhënie me mjedisin ku jeton, me prindërit, me të afërmit e me të tjerët më gjerë. Në këtë rast, në këtë mjesi ku jeton e punon njeriu mëson të krahasojë forcat e veta mendore e fizike, karakterin e burrerinë e vet me të tjerët, krijon atë ekuilibër forcash që, duke qenë në marrëdhënie me të tjerët të jetë i drejtë, i ndershëm, i saktë. Të punojë për dobi të vet e të familjes së vet, por me hallall, pa i hyrë në hak të tjerëve, të jetë i dobishëm edhe për të tjerët, për vendin dhe për mbarë botën.

Në shoqërinë tonë, kur edukata fetare u luftua dhe u

ndalua me ligj, kur ndërgjegjja dhe bindjet fetare islame u dobësuan, u prekën thellë edhe dy problemet më themelore që rregullojnë marrëdhëniet mes njerëzve, edukata e punës dhe qëndrimi ndaj pronës. U krijuan koncepte të gabuara dhe shumë të dëmshme. Me të gjitha mjetet e propagandës shtetërore komuniste u përpoq të krijohej mendimi se puna në shtëpinë e vet, në punishmen e vet, në fabrikën e vet, në arën e vet ishte e turpshme, madje u ndalua me ligj. U gjetën forma të tilla, sa të gjithë u shpronësuan dhe mbetën fukarenj. U dobësua ndërgjegjja në punë, secili përpiquej të punonte sa më pak ose punonte vetëm prej frikës, u kultivua dembelizmi, gjenjeshtra, madje edhe vese të tjera më të turpshme. Të gjitha këto çuan në një amulli të përgjithshme. Ndryshimi i sistemeve krijoi mundësi që secili të çlrojë e të vërë në lëvizje energjitet e veta, të punojë për vete me përfitim, të gëzojë djersën e mundin e vet. Por natyrisht, në këtë fushë dalin mjaft probleme të mprehta edukative morale që duhet të jenë në qendër të vëmendjes së edukatorëve, prindërve dhe mjeteve tjera, si: shkolla, mjetet e kulturës dhe të propagandës etj. Sot, kur një pjesë e prindërve ka boshllëqe në formimin moral fetar islam, në veprimtarinë edukative me fëmijët e vet priren shpeshherë nga interesat materiale të çastit, priren nga fitimi i shpejtë dhe i menjëhershëm, harrojnë se në këtë mes malli i tyre, fitimi i tyre, puna e tyre i kalon caqet dhe normat morale islame të fitimit, të ndershmërisë, të drejtësisë, të masës dhe të kontrollit. Madje ka mjaft tregtarë apo mjeshtër, drejtues firmash apo punishtesh që harrojnë se në rrugën e pasurimit përzihet e drejta dhe hallalli me atë që është e shtrembër dhe haram. Ka mjaft prej atyre që nuk e gëzojnë mirësinë dhe kënaqësinë që jep ndihma ekonomike ndaj të tjerëve, ndaj skamnorëve, të papunëve, nevojtarëve dhe të varfërve. Kur

vjen koha pér zekat, pér sadaka apo forma tjera të mirësive nëpërmes pasurisë, fillojnë e rrudhen, harrojnë të pastrojnë pasurinë e vet, harrojnë se, ndërsa vetë jetojnë në luks, ka mjaft të tjerë nevojtarë dhe hallexhinj që s'kanë bukën e gojës.

## 2. Në familje vihen themelet e edukatës së punës

Më parë kemi theksuar se fëmija që i vogël duhet të mësohet të ndjekë disa rregulla që duhen zbatuar me rigorositet: të lajë duart, këmbët, fytyrën, të marrë abdes, të fal namazin, të kryejë rregullisht disa punë të vogla personale. Të gjitha këto janë punë, secila prej tyre kërkon përpikëri në veprime, kërkon rregull, disiplinë. Nëse fëmija që i vogël mëson të kryejë një punë me rregull e pa përtesë, kur të rritet mësohet të kryejë edhe punë më të mëdha. Pejgamberi a.s. ka thënë: “*Urdhëroni fëmijën të falë namazin kur ai është shtatë vjeç, e kur të bëbet dhjetëvjeç, rrëbne!*” Nëse pas buke duhet ndrequar tavolina, duhet pastruar dhoma e bukës, duhen larë enët, duhen fshirë e vendosur në raftin e vet, në të gjitha këto punë është mirë të angazhohen të gjithë, po, patjetër edhe fëmijët e vegjël duhet të kryejnë një punë. Të gjitha këto duken punë të vogla e pa rëndësi, por janë mjaft të mërzitshme dhe madje edhe të lodhshme. Fëmijët lozin nëpër shtëpi, ata i përhapin lojërat e veta gjithandej. Është shumë e dobishme pér ta që të qortohen, kur lojërat i harrojnë andej e këtej, kur nuk i mbledhin e nuk i vendosin në këndin e vet. Kjo është një punë, kjo formon rregullin, kërkeshën që duhet zbatuar, disiplinën që duhet ta ndjejë çdo fëmijë. Shumë fëmijë bëhen të bezdissħem pér

nënati, u nxjerrin atyre shumë kokëçarje vetëm se orë e çast bëjnë rrëmuje dhe shtëpia nuk është kurrë e ndrekur. Këta janë punë të fëmijëve dhe nuk duhet t'i bëjë kush tjetër. Çdo ndihmë e prindërve, çdo lëshim e debulesë e tyre lë shteg për çrregullime e deformime edukative. Në të gjitha punët e shtëpisë, të rregullimit dhe të pastrimit të saj, të ekonomisë shtëpiake, të gatimit, të meremetimit të objekteve të dëmtuara, të oborrit apo të kopshtit, në të gjitha këto punë fëmijët dora-dorës sipas moshës e fuqisë duhet të ndihmojnë, të shërbijnë e të punojnë vetë. Sa më shumë punë e besim në ta, aq më shpejt e më lehtë do t'i kryejnë dhe, kur të rriten nuk do t'u duken të mërzitshme.

Në familjet tona kohët e fundit vihen re tendenca për t'i kushtuar më shumë rëndësi veprimtarisë mendore të fëmijëve, mësimeve, ngritjes kulturore të tyre. Fëmija shkon në shkollë e, kur vjen në shtëpi e gjen tryezën gati, sheh në televizor, ndryhet në dhomë e mëson, del e rri me shokë e me shoqe. Nënati sidomos sakrifikojnë. Fëmijët rriten parazitë. Po kush do t'ua bëjë atyre punët kur të rriten, kur të dalin të pavarur në jetë? Rritet vajza e mbaron edhe shkollën e lartë pa prekur punë me dorë, mjaft që të dalë mirë me mësimë, mjaft që të mësojë një a më shumë gjuhë të huaja. Nuk po flasim për shumë djem që sillen trotuareve dhe e humbasin kohën me biseda pafund për muzikën, sportin apo filmat që kanë parë.. Nuk jemi kundër kujdesit të familjes për të edukuar tek fëmijët vullnetin për mësimin dhe punën mendore, por jemi kundër teprimeve në këtë fushë, jemi kundër sakrificës së prindërve që gjoja në emër të kujdesit marrin përsipër të gjitha punët e shtëpisë, mjaft që fëmijët të përparojnë mirë në shkollë. Këta prindër pa dashur kultivojnë dembelizmin tek fëmijët e tyre. Ku nuk ka rregull për të angazhuar të gjithë pjesëtarët e familjes në

punët e shtëpisë, duke përfshirë edhe fëmijët, krijohen njerëz që gjithë jetën do të presin gjëra të gatshme nga të tjerët, çdo punë do t'u duket e vështirë, e lodhshme dhe e kotë. Futini fëmijët në punë, jepuni shansin të vënë në lëvizje energjitet e tyre, mundësitë e tyre, vullnetin e tyre! Të jeni kërkues dhe të rreptë ndaj tyre, mos u bëni lëshime, nxitini për punë të mira dhe të dobishme, se për vete e kanë. Kur të vaditen me punë që herët, çdo punë, sado e rëndë që të jetë, ai që është mësuar do ta kryejë shpejt e lehtë, pa bezdi, madje ndjen edhe krenari.

### **3. Disa këshilla për prindërit lidhur me edukatën e punës**

- Nxiti të rinjtë pér punë duke u bërë shembull i mirë pér ta!
- Udhëzoji sipas rregullave themelore të kryerjes së punës! Fëmija në bazë të udhëzimeve të qarta e shembullit të prindit nxitet të vërë në provë aftësitë e mundësitë e veta.
- Lyp e kërko prej fëmijës atë që ka forcë ai pér të bërë, punët u duben përshtatur fuqive trupore e fizike të fëmijës, madje edhe seksit e moshës së tyre. Duben shmangur disa dallime e kufizime të paarsyeshme mes punëve të djemve dbe të vajzave. Vajzat janë më të shtruara dbe u gjinden më pranë nënave. Djemtë fitojnë vese parazitizmi, pér çdo shërbim të vogël urdbërojnë motrën, edhe kur kjo është më e madhe, e si pa të keq edhe nënën, e pse jo mësohen të kërkojnë edhe prej babait. Jo rrallë ua hedhin sajin të tjerëve pér parregullsitë e krijuara nga vetë ata, p.sh. nuk dinë se ku i kanë librat apo mjetet tjera të mësimit, nuk dinë se ku i kanë lojërat etj. Kur fëmijëve u mbushet mendja dbe e kuptojnë se mund të kryejnë një punë, marrin zemër dbe jepen me kënaqësi pas saj. Po u mungoi besimi, ligështohen dbe u qan puna në dorë. Për këtë

kemi shumë shembuj konfliktesh e pakënaqësish në familjet tona. Zakonisht nënët ndërhyjnë vend e pavend në punën e fëmijëve, sidomos të vajzave. Edhe pa qenë të pranishme, ata i urdhërojnë që ta kryejnë mirë punën, p.sh. kujdes pluhurin nën divane, ndërsa vajza është pikërisht duke bërë po atë që e urdhëron e ëma. Duhet ditur se kryerja e një pune është tharmi që i shtyn fëmijët t'i hyjnë një pune tjeter, u shtobet besimi e dëshira për punë.

- Paraqite qartë e prerë kur do të fillohet një punë. Fëmija duhet të mësohet t'u shmanget veprimeve e lëvizjeve të kota, që s'i hyjnë në punë askujt e që s'i pranon arsyja, që nuk vlejnë për asgjë, por vetëm i ngatërrojnë, i lodbin e i mërzisin fëmijët, saqë e humbasin besimin.

- Mos pranoni as plogështinë më të vogël tek fëmijët! Puna që bëhet me përtesë e mërzi, krijon më vonë në shumë veprime të tjera çrrëgullime të rënda. Në familjet tona mund të vihen re raste të qarta e shembuj të shumtë të cilët provojnë se ai fëmijë që i ri punës në të, që punon me shpirt e nuk i shmanget çdo lloj pune të dobishme, e tregon këtë cilësi të lartë të karakterit në të gjitha rrëthanat tjera të jetës.

- Në familje më mirë se kudo mund të zbatohet këshilla: *Shiko si e bëj unë; eja ta bëjmë bashkë; bëje vetë!*

- Fëmijët duhet të shohin qartë sesi mundohen e përpilen një-rrëzit për të jetuar e për të nxjerrë prodhime me djersën e krahëve të vet. Kjo nuk mund të shihet vetëm në mjedisin familjar ku jetojnë, por edhe në miqtë e dashamirët, në punishte, në ara e në stalla. Kur shohin që edhe buka që hanë prodhohet me djersë, frytet që shijojnë duan punën e lodhshme të kopshtarit, zarzavatet kërkijnë shumë kujdes e punë në çdo stinë, rrrobat që veshim prodhohen me shumë vështirësi, atëherë ata kuptojnë se puna është në themelin e çdo gjëje që ata përdorin. Kështu koncepti për punën zojerohet e thellohet.

- Bëjini fëmijët që të çmojnë çdo punë. Çdo punë është e dobishme. Familja e më vonë shkolla duhet të luftojnë pikëpamjet e gabuara për disa lloje punësh, sidomos për punën fizike. Është e

*njohur ideja e shprehur nga filozofët grekë se puna fizike të largon nga idetë e kulluara. Shprehje të këtij qëndrimi gjëjmë edhe sot në shumë familje.*

*- Prindi duhet t'u japë të rinxve argëtimin e nevojsbëm krahës të gjitha punëve që kryejnë në shtëpi. Ka prind që i lobjin jashtë mase fëmijët në punë. Kujtoni periudhat e ngarkuara të vitit në familjet fshatare, kur punët në bujqësi kërkojnë shumë krahë punë e ata i ngarkojnë së tepërmë fëmijët. Puna nuk mbyt kënd, por me masë, në përshtatje me moshën e kushtet bigjenike e morale. Nëse i shtrëngojmë së tepërmë fëmijët në punë, ky është thjeshtë shfrytëzim i mundësive të tyre. Fëmijët duhet të mësojnë, të punojnë, por edhe të dëfrejnë e të çlodben. Gjetja e një mesatareje: punë, pushim, çlodhje e dëfrim nuk është e lehtë, por kjo duhet bërë nga prindi. Çdo teprim sjell dëm në edukatë.*

Paraqitëm në vija të trasha problemet më kryesore që të çojnë në idenë se themellet e edukatës së punës vihen në familje. Fëmija nuk lind dembel, por bëhet i tillë nga edukata e keqe, fëmija nuk lind punëtor, por bëhet i tillë nga edukata e mirë që merr në familje. Kjo edukatë është një thesar, një pasuri që fëmija e merr nga prindërit.

## **Edukimi mendor**

Problemet e edukatës mendore në familje janë të shumta. Ne do të trajtojmë disa prej tyre: vlerat e diturisë sipas mësimeve të Islamit, detyrat e edukatës mendore, si dhe përbajtjen dhe rrugët e realizimit të saj. Po ndalemi në çështjen e parë me dëshirën e mirë që prindërit të kuptojnë drejt rolin e tyre në këtë fushë të vështrimë të edukimit.

### **1. Vlera e diturisë në Kur'an dhe në traditën Pejgamberike**

Pajisja e breznive të reja me përvojën e kaluar, me një sistem njojurish, shkathësish dhe shprehish ka qenë një problem shqetësues për të gjitha periudhat e shoqërisë njerëzore, për të gjithë popujt, për të gjitha fetë. Ky edhe sot e kësaj dite mbetet një problem i mprehtë i shoqërisë. Pajisja me dituri, me kulturë, me edukatë është e detyrueshme për çdo mysliman, femër apo mashkull. Feja islame është e bazuar në dituri. Aftësia për të menduar dhe për të gjykuar është një nga cilësitë qenësore të njeriut, kjo është një dhundi themelore, pjesë e mëshirës pa kufi të Krijuesit fuqipotë. Kjo e dallon në mënyrë të quartë dhe të plotë njeriun nga krijet e tjera. Në Kur'anin famëlartë dhe në traditën Pejgamberike

gjinden urdhëresa, këshilla e porosi rrëth vlerës së diturisë. **Verseti i parë** kuronor që i zbriti Pejgamberit tonë të nderuar, Hazreti Muhammedit a.s., është: ‘*Lexo, me emrin e All-llahut xb. sh. tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai e mësoi (njeriun) të shkruajë me penë. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte*’ (Kur’ani: Alek, 1-5). Tek sureja Fatir theksohet prerazi: ‘*Nuk janë të barabartë i verbëri dbe ai që sheb dbe, as errësira dbe drita e, as bija me vapën. E nuk janë të njëjtë as të gjallët e të vdekurit, All-llahu bën të dëgjojë atë që do...*’ (Kur’ani: Fatir, 19- 22). Islami i ka dhënë rëndësinë më të madhe mësimit e përhapjes së diturisë duke i inkurajuar besimtarët që ta kërkojnë diturinë dhe të humtojnë në të gjitha fushat e saj në çdo kohë të jetës së tyre. **Pejgamberi** ynë a.s. na nxit që ta kërkojmë atë “nga djepi deri në varr”, sepse “**kërkimi i diturisë është detyrë e çdo myslimanit dhe myslimanëve**“. Duke e vlerësuar diturinë tradita Pejgamberike thekson se: “**Në qoftë se njeriu mundohet të fitojë dituri, Zoti do t’ia bëjë më të lehtë rrugën për nën Xhennet**”.

Feja Islame thekson se pa dituri asnjë punë nuk mund të bëhet e saktë dhe e vlefshme. Dituria, mençuria, arsyjeja janë një armë e fuqishme në dorën e besimtarit për të bërrë punë të mira, për të jetuar e për të përbaluar hallet e saj në rrugë të drejtë e të ndershme. Nga ana tjetër **Kur’ani** porosit: “...Po All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët, All-llahu është mbi gjithçka është mëkatfalës.” (Kur’ani: Fatir, 28).

Besimtarët islamë e kanë për detyrë jo vetëm të gjurmognë dijen e të pajisen me të për të kuptuar madhështinë e Krijuesit, por kjo dituri duhet përdorur për të bërrë vepra të mira në dobi të njeriut. E jo vetëm kaq, por ai që di e ka për detyrë ta përhapë dijen në fëmijët e vet, në miqtë dhe të afërmët e vet, në nxënësit e në mbarë sho-

qërinë. Pra, njeriu nuk duhet të fitojë dituri për të ndriçuar mendjen, por për ta vënë në punë të dobishme e për ta shpërndarë në të gjithë pjesëtarët e komunitetit.

Kjo bëri që në periudhën e përhapjes së islamit dhe të shtrirjes masive të tij nga Kina në Gjibraltar të përpalojnë studimet në fusha të ndryshme dhe popujt islamë të jenë në ballë të zhvillimit shkencor. Qendra të tilla, si: Bagdadi, Samarkandi, Damasku, Kordova etj. u bënë qytetet më të lulëzuara në të gjitha fushat e shkencave të kohës, ku veçojmë astronominë, matematikën, algebrën, gjeografinë, studimet filozofike, letërsinë etj., duke vënë në ballë të tyre mjekësinë.

Islami është në kundërshti me prapambetjen, injorancën, plogështinë kulturore, besimet e kota e çdo besëtytni që jo rrallë merr ngjyra fetare për t'u maskuar e përhapur.

## **2. Dituria është e lidhur ngushtë me edukatën, mendja e ndritur me zemrën e mirë**

Verseti i parë kuronor jep urdhërin kategorik: “*Lexo, me emrin e All-labut xb. sh. tënd!*”. Ideja e parë që të lind në këtë rast është kjo: kush e mësoi dhe e edukoi Hazreti Muhammedin a.s. që të përbollonte të gjitha ato detyra të vështira për transformimin rrënjosor të një shoqërie të kalbur në vese, ku zoteronin grindjet, besimet e kota, prostitucioni, orgjitet e shumë vese të tjera ndjellëse të dekadencës e të mjerimit shoqëror? Pejgamberi ynë a.s. ishte i përzgjedhuri i All-lahut xh.sh.dhe u mësua e u edukua nga All-lahu mëshirëmadh. Prandaj edhe porosia e parë është: Lexo, mëso nga i gjithë libri i madh i jetës dhe i natyrës. Porosia e parë është përhapja e diturisë përmes mësimit. Pejgamberi ynë a.s. u bë eduka-

tori dhe mësuesi i parë i mësimeve të Kur'anit, përhapësi i parë i fesë islame. E kjo ngjau siç e thamë në një vend të molepsur. Të shkojnë sot me qindra psikologë, sociologë e ushtri të tëra mësuesish me mjetet më të sofistikuara për të shëruar plagët e rënda të shoqërisë, por nuk do të kenë sukses as në një të qindtën e kërkesave. Prandaj përdorimi i diturisë nga Hazreti Muhammedi a.s. në emër të All-llahut xh. sh. xh.sh., përdorimi i fjalës së mirë shpresëdhënëse që mjeti i parë në arsimim dhe edukim.

Edhe sot përvetësimi i diturisë duhet të shkojë në një linjë me edukimin. Njerëz të ditur gjinden kudo, në të gjithë popujt. Njohja, dituria nuk është e mjaftueshme për një shoqëri apo për një individ. Njeriu i ditur njohuritë e tij mund t'i përdorë në dobi të njerëzimit, por edhe në dëm të tij. A nuk shihni se sa dijetarë punojnë në laboratorët më të sofistikuar për prodhimin e armëve të shfarosjes në masë? Edhe kriminelët sot janë ndër njerëzit më të specializuar. Ata duke qenë shpesh shumë të ditur, edhe pasojat e veprave të tyre janë më të dëmshme.

Prandaj All-lahu xh.sh. e urdhëroi Pejgamberin a.s.: "Lexo, me emrin e All-lahut xh. sh. tënd". Lexo, mëso, vëzhgo, ndrysho në punë të dobishme, për hir të All-lahut xh. sh., në vepra të mira, në rrugë të drejta. Nuk është fjala për të lexuar vetëm në libra, por në librin e madh të jetës, të natyrës, të universit të pafund. Ja, vëreni një bimë si lind, si rritet, si gjelbëron e lulëzon, si ushqehet e jep fruta. A nuk është ky një libër i hapur, a nuk është ky një argument për diturinë e pafund të All-lahut xh. sh.? Njihe këtë e do të kuptosh këtë dituri, do t'i afrohesh më shumë krijuesit. Prandaj dituria të afron tek Zoti, të bën të njohësh Krijuesin, të njohësh madhështinë e veprës së tij, ta duash, ta nderosh dhe të kesh frikë nga dënim i tij, gjë që të nxit për kërkimin e diturisë, për përhapjen e saj dhe përdorimin gjithmonë në dobi të

vetes dhe të njerëzimit. Kjo shtron domosdoshmérinë që njeriu me mendje të ndritur duhet njëkohësisht të jetë edhe me zemër të pastër.

### **3. Në familje, në shkollë, në çdo institucion që merret me edukimin mendor duhet të kihen parasysh disa veçori të metodologjisë islamie, prej të cilave veçojmë:**

a. *Parimi i parë i islamit dhe i çdo gjëje islamë thekson se All-lahu është një: "Thuaj: Ai, All-lahu është Një! All-lahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë." (Kur'ani, Ihlas, 1-4).*

b. *Krijimi është një tërësi e plotë, pikërisht sepse është vepër e një krijuesi. Pjesëmarrja e njeriut në ndryshimin e transformimin e gjërave është një domosdoshmëri, pa këtë gjithësia do të ishte një botë e pandryshueshme dhe e palëvizshme, një botë për të paditurit, për të marrët. All-lahu xh.sh. nuk e obligon asnjë njeri jashtë mundësive të tij: "All-lahu nuk e obligon asnjë njeri përtëj mundësisë së tij, atij (njeriut) i takon ajo që e fitoi dbe atij i bie ajo (e keqe) që e meritoi..." Kur'ani: Bekare, 286).*

c. *E vërteta e shpalluar nga All-lahu është në unitet të plotë me diturinë. Ajo çfarë na njofton All-lahu xh.sh. me shpalljen nuk mund të jetë e ndryshme nga realiteti, pasi Ai është krijuesi i mbarë realitetit dhe i mbarë së vërtetës. Ky barazim logjik i arsyes mes së vërtetës dhe realitetit me faktet e shpalljes është parimi më kritik që duhet të ketë parasysh këto:*

- Çështjet që na i mëson shpallja janë të vërteta, ato janë në pajtim me realitetin dhe përputherford me të. Shpallja e All-lahut për të na udhëzuar nuk mund të kundërshtojë realitetin. Është tjetër se njeriu me arsyen e vet

mund tē bëjë interpretime tē ngutshme, alegorike apo edhe duke u mbështetur mbi autoritetin shkencor tē një tjetri.

- *Kurrfarë kontradikte apo dallimi mes arsyes dbe shpalljes nuk është përfundimtare. Në hulumtimin e natyrës mund tē bëhen gabime, bishet në iluzione dbe mendohet se është kuptuar e vërteta, ndërsa mund edhe tē arrihen përfundime tē gabuara. Zbulimet shkencore kanë kaluar në shumë zigzage dbe hipoteza.*

- *Çdo lloj hulumtimi nuk mund tē jetë i myllur dbe përfundimtar. Sado njoburi tē thella që tē arrijmë, përsëri gjithnjë e më shumë do tē ketë tē tjera për t'u zbuluar.*

#### **4. Jeta është në unitet tē plotë.**

Këtë mund ta shohim në dy drejtime:

a. *Vullneti byjnor është dy llojesh: I pari drejtohet mbi bazën e rregullave byjnore, i shprehur në ligjet e natyrës. Ato mund tē njihen përmes arsyes. All-lahu xh.sh. e ka urdhëruar njeriun që t'i hulumtojë, t'i kuptojë, t'i përpunojë përmes diturisë dhe t'i shfrytëzojë në dobi tē vet. Çdo gjë është krijuar në shërbim tē njeriut. I dyti shprehet përmes ligjeve morale që realizohen vetëm në liri dbe kërkojnë ushtrimin e lirë të vullnetit personal. Qiejt, toka dhe malet, tē privuar nga një vullnet i tillë nuk qenë në gjendje ta bartin amanetin hyjnor. Vetëm njeriu e mori përsipër atë, sepse vetëm ai është në gjendje për një liri tē tillë morale. Kjo cilësi e vendos atë mbi melekët, ngase ata nuk gëzojnë lirinë e bindjes dhe tē mosbindjes, prandaj edhe janë inferiorë ndaj njeriut dhe u urdhëruan që t'i binden atij. Bindja e njeriut është më e vlefshme se bindja e engjëjve, sepse ajo bëhet nga një krijesë që është në gjendje tē veprojë edhe ndryshe. Njeriu është i lirë tē zgjedhë tē drejtën (hallallin) ose tē padrejtën - haramin, tē mirën ose edhe*

të keqen.

b. Njeriu i krijuar për të jetuar në Tokë është i udhëzuar të përbushë ligjet morale. Ato janë një me ligjet fetare. Islami nuk e ndan të shenjtën apo fetaren (religiozen) nga shekullarja. Sipas islamit ekziston vetëm një realitet. Prandaj, të qenit fetar nuk do të thotë tërheqje nga proceset e zakonshme të jetës as nga kryerja e nevojave. Është tjetër gjë pastaj, nëse veprimet njerëzore mund të jenë të drejta, të vërteta, të hijshme apo jo.

## **5. Të gjithë njerëzit janë një, të barabartë, kjo është bazë dhe mbështetje e universalitetit të islamit.**

Urdhëresat, porositë, këshillat islame janë një për të gjithë, si për meshkujt ashtu edhe për femrat, si për të rinjtë ashtu edhe për të moshuarit, si për të pasurit ashtu edhe për të varfërit.

Mendojmë se kryesore në aspektin e edukimit dhe të formimit është nevoja që i riu islam në familje, në shkollë e kudo duhet të njohë në themel veprën e Krijuesit, ta hulumtojë, ta kuptojë, ta përpunojë dhe ta përdorë në dobi të vet e për shoqërinë. Familja që në hapat e para të jetës së fëmijës duhet ta nxisë fëmijën të ecë me siguri në këtë fushë kaq të vështirë të formimit, që do t'i hapë atij rrugët e përparimit dhe të afrit me Krijuesin.

## Detyrat e edukimit mendor

Detyrat e edukimit mendor janë të shumta e të ndërlikuara. Ne do të përpinqemi të trajtojmë disa prej tyre, thjeshtë e në përshtatje me detyrat e familjes, natyrisht duke marrë parasysh se u drejtohem i prindërve.

*Së pari*, edukimi mendor synon të formojë njeriun e në veçanti fëmijët me dije, me dituri. Menjëherë lind pyetja: Ç'kuptojmë me dije? Dijet janë njohuritë, shkathësitë dhe shprehitë që fiton njeriu gjatë jetës. Mendoni pak se njerëzimi në trugën e vet të gjatë, që nga krijimi ka grumbulluar një përvojë të pasur, që ka ardhur gjithnjë duke u zgjeruar dhe pasuruar. Po marrim elementin e parë të dijeve, njohuritë. Ç'janë njohuritë? Me njohuri kuptojmë konceptet, gjykimet dhe arsyetimet, tregullat e përkufizimet. Ta shpjegojmë këtë me një shembull të thjeshtë. Fëmija sheh një kokërr mollë. Ajo është e kuqe apo e verdhë, e ëmbël apo e thartë, e madhe apo e vogël, ka erë të veçantë dhe karakteristike. Në të gjitha këto raste përmes të parit, të shijuarit, të prekurit apo të nuanxit, fëmija merr ndijimet e para, perceptimet e para mbi mollën si fryt. Dhe nga të gjitha këto arrin të formojë konceptin për mollën. E kur përmendet molla si koncept, fëmija nuk ka parasysh një kokërr mollë të veçantë, as të kuqe, as të verdhë, as të madhe, as të vogël etj., por në këtë koncept në mënyrë të përbledhtë përfshihen të gjitha karakteristikat e këtij fryti. Kështu formohen konceptet për të gjitha frutat apo bimët, kafshët e sendet

që na tretrojnë. Nga konceptet kalohet në sisteme konceptesh. Nga koncepti mollë, dardhë, qershi, kajsi, fik, ftua etj. etj. kalohet në një koncept më të gjerë, fryt, zarzavate, bimë, kafshë, send, frymor, njeri etj. Kështu krijojen sisteme konceptesh të lidhura e të varura njëri me tjetrin, që kanë gjëra të përbashkëta, të njëjta, por edhe dallime mes njeri- tjetrit. Në këtë mënyrë, sipas moshës dhe zhvillimit fëmija merr në mënyrë sistematike e të pandërprerë njoħuri, formon atë që ne e quajmë baza e shkencave. Një degë e diturisë studion bimët, një tjetër kafshët, njeriun, një tjetër dukuritë fizike, dukuritë kimike, historinë, gjeografinë, gjuhësinë, letërsinë etj.

Pa mendoni pak sesa njoħuri ka grumbulluar njerëzimi gjatë shekujsh. A mund t'u transmetohen të gjitha fëmijëve të një moshe? Këtu futet në veprim një degë e pedagogjisë, didaktika. Didaktët, si të themi në sofrën e madhe të diturisë, në bukën e saj ndajnë rriskat prej tyre kafshatat që mund të përtypin fëmijët sipas moshave. Atë që mund të mësojë një i rritur, nuk mund ta përtypë një fëmijë. Ajo që është me vlerë dhe interesante për një fëmijë tre vjeç, s'ka asnjë rëndësi për një 15 vjeçar. Këtu del edhe një problem tjetër shumë i vështirë. Njerëzimi ka grumbulluar shumë përvojë gjatë gjithë historisë së zhvillimit të tij. Çfarë duhet t'u japim fëmijëve nga ky grumbull kaq i madh njoħurish? Mendoni sa rafte me libra kanë bibliotekat tona e të gjitha janë njoħuri, janë thesar i njerëzimit. Fëmijëve duhet t'u japim ato njoħuri që janë të vlefshme për të sotmen, të cilat shpesh i quajmë dije bashkëkohore. Fëmijët e sotëm do të jenë mjejkët, inxhinierët, punëtorët, fshatarët dhe prindërit e së ardhmes. Poeti i shquar kombëtar, **Naim Frashëri**, ka thënë: “*Mësojini fëmijët tuaj më mirë se ju, se atyre u përket e ardhmja, ata përgatiten për një jetë më të zhvilluar se e juaja*“.

Pra, mendoni sesa e dëmshme është për shoqërinë apo

për familjen, nëse djali apo vajza lodhet duke mësuar gjëra apo dituri të vjetruara, që nuk u vlejnë për asgjë. Sapo dalin në jetë, ata e kuptojnë boshllékun e përgatitjes së tyre. Sot del i mprehtë problemi i formimit të brezit të ri me një nivel të caktuar dijesh, ku është kombinuar drejt përvoja e breznive të vjetra me zbulimet dhe arritjet e sotme të shkencës. Por mos harroni se vëllimi i dijeve rritet kaq shpejt, saqë ato për një 7 apo 10 vjeçar dyfishohen.

*Edhe një problem i dytë.* Disa prindër, madje edhe mësuesit mburren se fëmijët e tyre dinë shumë, ata janë në gjendje të riprodhojnë shpejt e mirë njojuritë e fituara. Mos harroni fjalën e urtë: “*Jo sa di, por sa bën vlen njeriu*”. Pra, njojuritë që ka fituar një fëmijë apo një nxënës, nuk janë mjet zburimi i mendjes së tyre. E jo vetëm kaq, fëmija mund të dijë shumë gjëra për një kohë, por ata shpejt veniten e shuhën nga kujtesa, ata nuk janë të qëndrueshme e të vetëdijshme. Madje, edhe pse di fëmija, kjo nuk mjafton. Ai krahas njourive duhet të fitojë edhe shkathtësitë e shprehitë për t’i vënë në jetë njojuritë. Formimi i njourive dhe përvetësimi i tyre nga nxënësit është njëra anë, formimi i shkathtësive dhe i shprehive është një gjë tjeter, por shumë e rëndësishme për përgatitjen e njeriut për jetën. Po e shpjegojmë këtë me një shembull krejt të thjeshtë. Sado që të lexojë një fëmijë e të marrë udhëzime për notin, për lëvizjet e gjymtyrëve në ujë, për kombinimin e këtyre lëvizjeve, për frymë-marrjen, për shikimin në thellësi të ujit, ai kurrë nuk do ta mësojë notin, siç thotë populli, në shilte, por duke u stërvitur, duke u zhytur në det apo në lumë. Nuk po përmendim këtu stilet e notimit, shkathtësinë e shpejtësinë, elegancën, rezistencën etj. Shumë fëmijë apo të rritur mund t’i zotërojnë rregullat e gramatikës, të drejtshkrimit apo të drejtshqiptimit, por kjo nuk mjafton. Fëmija

duhet që përmes shumë ushtrimesh në të folur apo në të shkruar, përmes diktimesh e hartimesh të shumta, duke folur shpesh para të tjerëve mund të zbatojë ato çfarë ka mësuar. A e vini re që edhe një i rritur, kur merr të shkruajë një letër të thjeshtë prish sa e sa faqe e nuk është i kënaqur me atë çfarë ka shkruar. Pra, zotërimi i dijeve është një kombinim i ndërvarur mes përgatitjes teorike dhe aftësive e shprehive për t'i zbatuar ato në veprimtarinë e përditshme. Natyrisht, për degë të veçanta të dijes kjo është edhe më e rëndësishme. Mendoni me ra në dorën e një mjeku që di shumë, por që nuk ka mjetet e përvojën e duhur që dijet e fituara t'i zbatojë në një të sëmurë të caktuar. Gabimet e tij ia mbulon dhei. Mendo sa inxhinierë bëjnë projekte të këqija ose, edhe kur janë projektet e mira, i zbatojnë keq.

Detyra e parë e edukimit mendor është formimi i fëmijëve, i nxënësve i njeriut me dije, me dije bashkëkohore, me bazat e shkencave, me shkathtësitë dhe shprehitë praktike për zbatimin e tyre.

*Së dyti*, një detyrë tjeter e edukimit mendor është *zhvillimi i proceseve psikike njohëse*, si: ndijimet, perceptimet, parafytyrimet, imagjinata si dhe i veprimitarisë së lartë mendore, i aftësive intelektuale.

Njeriu ka pesë shqisa. Me anë të syrit që në moshë të re njeriu fillon të njohë prindërit dhe të afërmit, ditën e natën, lojërat, veshjet, ushqimet, format, madhësitë, ngjyrat, tingujt etj. Mirëpo syri ka aftësi të kufizuara, nuk shikon në errësirë, shpesh edhe gabon. Është e njohur dukuria optike e përthyerjes së dritës në ujë. Si rrjedhojë e kësaj dukurie një shkop i zhytur në ujë na duket i thyer, i shtrembër, gjë që nuk është e vërtetë. Shkopi në fakt është i drejtë, syri na ka gabuar.

Me anë të veshit fëmija dëgjon zërin e nënës dhe të pjesëtarëve të tjerë të familjes, dëgjon fjalë përkëdhelëse,

urdhra, këshilla, ndalesa, qortime. Mirëpo veshi, si edhe vetë njeriu është i kufizuar. Ai nuk e dëgjon zërin që vjen prej shumë larg. Ne shpesh gabohemi duke kujtar se dëgjuam zërin e një njeriu të njohur, por në të vërtetë nuk është ai. Kështu mund të flasim edhe për shqisat tjerë, të nuhaturit, të shijuarit, të prekurit. Si përfundim mund të themi se njeriu mund ta njohë botën përmes shqisave, por shpejt e kupton se dituria e marrë prej tyre nuk është e plotë, ajo është fillestare, madje është primitive. Në këtë mes ka rëndësi aftësia e fëmijëve për të vrojtar. Ju keni hyrë shpeshherë në shtëpinë e një miku, por po të pyeteni për objektet që ka në oborr, për lulet apo për numrin e shkallëve, për sendet që ka në dhomën e pritjes etj., ju me siguri, ndonëse keni hyrë e dalë sa herë, nuk jeni i sigurt për të dhënë përgjigje të sakta. Ju mund të bëni një provë me fëmijën tuaj. Djali apo vajza gjatë rrugës për në shkollë kalon para një objekti të caktuar, kalon para tij dy herë në ditë, ndoshta edhe më shumë. Kërkonit prej tij ta përshkruajë atë objekt, apo edhe ta vizatojë. Krahasoni saktësinë e përshkrimit apo të vizatimit me objektin e vërtetë. Do të shihni se fëmija, ndonëse e ka parë me mijëra herë, përsëri nuk e ka vëzhuuar me imtësi, gabon gjatë përshkrimit apo vizatimit për shumë detaje, që asnjëherë s'i ka shkuar mendja t'i vërejë me kujdes. Besoj se është e qartë se njohja përmes shqisave ka rëndësinë e vet, ajo është në themel të njohjes, por është fillestare, madje duhet ushtruar, duhet mprehur.

Gjatë edukimit mendor proceset psikike që përbëjnë bazën e njohjes duhet të përpunohen e të mprehën duke u lidhur me të menduarit. Populli këtë e thekson me shprehjen: "Mendja sheh, syni nuk sheh". Njeriu me anë të të menduarit analizon dhe përgjithëson të dhënat e shqisave, ndijimet e perceptimet e drejtpërdrejta përpun-

nohen e përgjithësohen nga mendja e njeriut. Kështu fëmija merr informacion nga shqisat, e përpunon këtë e në këtë rast në rrjedhën e jetës stërvitet të kryejë veprime mendore, si: analiza, sinteza, krahasime, përgjithësime, klasifikime, abstragime, konkretizime, zhvillon format e të menduarit, si: konceptet, gjykimet dhe arsyetimet, po kështu përpunon e forcon gjerësinë, thellësinë, pavarësinë, elasticitetin, konsekuencën dhe shpejtësinë e të menduarit. Jo vetëm kaq, por njeriu kalon nga format e thjeshta të të menduarit në format më të ndërlikuara.

*Së treti*, përgatitja e fëmijëve dhe në përgjithësi e njeriut për punë të pavarur njohëse e praktike, pajisja e tyre me kulturën e punës mendore. Njeriu mëson nga prindërit, nga shkolla, nga veprimitaria e tij praktike, nga mjetet tjera. Ai duhet të aftësohet që vetë, me përpjekjet e veta të zhvillohet e të përparojë në fushën e dijes, të vetëmësohet, të fitojë shprehitë e punës së pavarur njohëse. Jo gjithçka njeriu e mëson nga të tjerët, por ai duhet të dijë të mësojë nga libri gjithmonë i hapur i natyrës, nga sjellja e përvoja e vet dhe e të tjerëve, nga sukseset dhe dështimet, nga rastet e shumta që i paraqiten në jetë, nga provat dhe eksperimentet. Por, nëse nuk fiton kulturën e punës studimore, në se nuk ka disiplinë pune për mësimin në fëmijëri, mendoni si do t'i vejë halli këtij njeriu, kur të rritet. Mendoni si e ndjen veten para shokëve të kulturuar e më të ditur. Mos mendoni se për studim kanë nevojë vetëm shkencëtarët, jo, për mësim e fitim dijesh të reja ka nevojë çdo njeri i çdo moshe qoftë. “Njeriu plaket duke nxënë”, - thotë populli ynë. Në një hadith të Pejgamerit tonë a.s. theksohet me forcë nevoja e kërkimit të diturisë “nga vdekja deri në varr”. Por natyrisht, sa më e njomë të jetë bima, aq më lehtë drejtohet, sa më herët të fitohet kultura e punës për mësimin e zhvillimin mendor, aq më

të lehtë do ta ketë njeriu të pasurojë, të zgjerojë e të zhvillojë dijet e veta. A nuk keni dëgjuar mjaft njerëz që me të qeshur thonë se sa po marrin një libër në dorë, na zë gjumi? E konsiderojnë librin si bar gjumi. Kjo është vërtetë për të qeshur, por shpreh një realitet, ndërsa ka me mijëra njerëz që e gdhijnë gjithë natën mbi libra, në laboratore, në eksperimente e prova. Prandaj prindi duhet t'i kushtojë kujdes formimit të kulturës së punës mësimore tek fëmijët. Këto ishin tri detyrat themelore të edukimit mendor.

## **Disa probleme specifike të edukimit mendor në familje.**

Përgjithësisht ka një koncept të gabuar lidhur me edukimin mendor në familje, duke e kujtar këtë si një detyrë vetëm e shkollës dhe e mësuesve. Harrohet se fëmija para se të shkojë në klasën e parë apo në kopsht, ka kaluar tre apo gjashtë vjet pranë familjes dhe në gjirin e saj është edukuar. Studimet e psikologjisë eksperimentale kanë vërtetuar se fëmija deri në moshën 17 muajsh ka marrë të gjithë potencialin e duhur mendor, ai tashmë është një personalitet i plotë me të gjitha mundësitë e zhvillimit. Veprimitaria e mëtejshme në këtë fushë është shumë e domosdoshme, por ecën shumë më ngadalë dhe bën vetëm përpunime, thellime e zgjerime në vartësi me moshën dhe mundësitë. A nuk dëgjojmë çdo ditë se fëmijët sot lindin me shkollë? Kjo është një shprehje e realitetit sepse fëmijët kanë mundësi të shumta zhvillimi. Nuk është vetëm prindi burimi kryesor i informacionit. Kur themi prindi kemi parasysh të gjithë pjesëtarët e

familjes e krahas tyre sot familja jonë ka edhe shumë mundësi të tjera. Mjafton të kemi parasysh punën që bën radioja dhe televizioni me programet e tyre, libri etj.

Edukimi mendor nuk është një detyrë spontane apo e rastit. Vërtetë familja nuk punon me programe si shkolla, por secili duhet të ketë parasysh se në fushën e edukimit mendor ka shumë punë për të bërë, e këto duhet t'i bëjë me qëllim, të planifikuara dhe të parashikuara. Po marrim ndonjë shembull të thjeshtë. Ju keni një fëmijë pak ditësh apo pak javësh. Gjithnjë e ledhatoni, e merrni në dorë, i afroheni tek shtrati, e tundni, i qeshni, ndizni dritën e dhomës, trokisni me diçka, përgatisni banjën dhe e fusni fëmijën në ujë për ta larë, e ushqeni, e vishni etj. etj. Të gjitha këto janë ngacmime të jashtme që ushtrojnë ndikime me shumë vlerë në formimin e aftësive perceptuese të fëmijëve, që ndikojnë për reagimin e tyre ndaj mjedisit të jashtëm. Vini re, kur uji i banjës është i ftohtë apo i ngrohtë, kur ushqimi është i shijshëm apo jo për fëmijën, kur ai ka të ftohtë apo të nxeh të, fëmija reagon menjëherë, miraton apo kundërshton. Sa më afër t'i rrimë fëmijës aq më mirë do të komunikojmë me të, do të kuptohemi më mirë me te, do të ndikojmë më mirë tek ai. Gjithë këto ngacmime të jashtme lënë gjurmë në vetëdijen e fëmijës, krijojnë përvojën fillestare të tij dhe njëkohësisht edhe të prindit në punën me fëmijën. Kjo përvojë është edukim, madje një pjesë shumë e rëndësishme e edukimit mendor. Ta shpjegojmë këtë me një shembull më të kuptueshëm. Në familje fëmija mëson të flasë. A vini re sesa shumë ushtrime bëhen duke qenë fëmija krejt i vogël për shqiptimin e disa tingujve apo fjalëve. Vini re, sesa qindra e mijëra herë e ushtroni fëmijën të shqiptojë fjalët mam, mam, mama, bab, bab, baba etj. A nuk është ky hapi i parë, por shumë me rëndësi në fushën e edukimit mendor? Ose vini re sesa ush-

trime bëhen për t'i mësuar fëmijët të ecin. Në fillim ngrenë kryet, e sjellin djathtas e majtas, para e mbrapa, rrotullohen, ngrihen ndenjur, zvarriten, kacavaren apo lëvizin duke u mbajtur, rrinë drejt në këmbë (taaa), fillojnë të lëvizin me hapa të shkëputur. E dikur, çohu e rrëzohu hedhin hapat e parë e në mes brohoritjeve inkurajuese të prindërve fëmija lëshohet, fillon të ecë. Ky është një sukses i madh për fëmijën dhe për të gjithë familjen. Sa përpjekje, sa mund, sa sakrifica, madje edhe sa dhimbje! E gjitha kjo është përvojë, përvojë vërtetë fillestare, por tani fëmija duke folur me rrokje apo me fjalë të shkëputura komunikon, shpreh mendimet, realizon materialisht atë që e kishte në mendje. Ecën, objektet i afrohen, ata nuk janë aq të largëta, ai ngrihet dhe shkon tek ato. Ky është një hap me rëndësi drejt botës së madhe. I merr objektet, i shikon, i nuhat, i shijon, i prek, e kupton në se janë të nxeh të apo të ftohtë, të lëmuar apo të ashpër, të ëmbël apo të thartë. Dhe kjo është përvojë, është mësim, është dituri. Një fëmijë që është djegur njëherë tek shporeti, nuk e shtrin kurrë më dorën për ta prekur. Fëmija nuk e hap kurrë gojën për të marrë ushqimin pa e provuar një herë me buzë. I pëlqen, e hap gojën, s'i pëlqen, nuk e hap, qan, bërtet. Dhe prindi e kupton se fëmija tashmë di diçka, vërtetë di pak, por nuk duhet të çuditemi se pikërisht nga këto përvoja fillestare hidhen hapat e parë drejt diturive më të thella. Edhe shkencëtarët më të shquar nëpër këto rrugë kanë ecur. Do të ishte fatkeqësi e madhe që njeriu të mësonte të ekte 20 vjeç apo të fillonte të mësonte të fiste në këtë moshë. Familja i jep përparësi të mësuarit konkret, intuitiv, praktik, ushtrimeve të shumta, provave, të mësuarit rast mbas rasti, të cilat edhe shkolla i përdor me shumë sukses.

Mendohet se shkolla ka përparësi në fushën e eduki-

mit mendor. Po, kjo është e vërtetë. Shkolla është një institucion i specializuar për edukimin e fëmijëve. Ajo punon me rregull e me disiplinë shkencore. Por jo gjithmonë dhe jo për gjithçka mund të ketë suksese apo ka përparesi ndaj familjes. Po marrim përsëri si shembull gjuhën. Nëse në familje një fëmijë mësohet të shqiptojë gabim disa tinguj, shkolla me të gjitha metodat dhe mënyrat më moderne të punës nuk arrin dot të ndryshojë atë që fëmija ka fituar gabim në shtëpi. Vëreni shqiptimet dialektore. Rritet e bëhet burrë djali, kryen edhe shkollat e kualifikimet më të larta, por ato që i janë bërë shprehi gabim në familje, nuk arrin dot t'i korrigjojë si duhet.

Një fëmijë që nuk ka fituar në shtëpi rregullat fillestare të punës për të vrojtar me kujdes dhe për të plotësuar detyrat me përpikëri sipas një radhe dhe rendi të saktë, kur futet në shkollë, do ta ketë shumë të vështirë të ecë me hapin e shokëve. Vëreni një fëmijë që nuk i ka shprehitë e rregullit e të disiplinës së punës. Humbet kohën, pengohet, habitet, nuk i vë veshin mësueses apo shokëve, as nuk di të pyesë, as të dëgjojë me vëmendje. Shkurt, mbetet pas shokëve, fillon dhe i mërzitet mësimi dhe shkolla, preferon të luajë, të ngacmojë të tjerët. E pra, nuk është i paaftë nga ana mendore, përkundrazi, ai mund të ketë potenciale të larta, por nuk ka disiplinën e punës, nuk e ka fituar këtë që në vogëli dhe duhet një punë tepër e madhe riedukuese, e cila është shpeshherë më e vështirë, aq më tepër kur edhe mësuesit nuk kanë mundësitë as durimin, as kohën e duhur për këtë. Rezultati është i qartë. Sa prindër vuajnë pasojat e një pakujdësie ndaj fëmijëve kur ata të ishin të vegjël. Shpesh për këtë bëhet burim dashuria e tepruar ndaj fëmijëve. Nëna merr përsipër të gjitha gjérat, babai gjithashtu dhe fëmija bëhet i plotpushtetshëm në familje. Kjo gjendje vazhdon edhe në vitet e shkollës. Sa prindër, gjoja në emër të

ndihmës ndaj fëmijëve ua zgjidhin detyrat atyre vetë, sepse nuk kanë kohë t'u rrinë përmbi kokë dhe t'i mësojnë. Fëmija mësohet shpejt të hajë me lugën e të tjereve dhe kjo i duket e mirë, e lehtë, e zakonshme. Fëmija mbetet mbrapa të tjereve, jo se është i pazhvilluar, por, sepse nuk ushtrohet sa duhet të vëré në lëvizje fuqitë e veta mendore.

Në familje fëmija merr elementet e para të njohurive, të shkathësive dhe shprehive. Njohuritë për prindërit e rrethin familjar, për mjedisin shtëpiak, për orenditë dhe rolin e tyre, për sendet që ka përreth apo në përdomim, si: orendi, fruta, perime, bimë, kafshë etj. etj i merr në familje. Po kështu, njohuritë elementare të sjelljeve dhe normave morale më mirë se kudo i merr në familje. Si duhet të flitet me nderim ndaj më të rriturve, ndaj pleqve, ndaj miqve, si duhet të sillet ndaj tyre, konceptet e para për punën, pronën, mirësjelljen, dashurinë për vendlindjen e atdheun etj. etj koncepte morale i merr që në familje. Natyrisht, në shtëpi nuk do të bëjë ndonjë kurs mësimor, por hap pas hapi, rast mbas rasti ai vjen e formohet e përgatitet për të përballuar detyrat e vështira mendore të shkollës e të shoqërisë.

Një fushë tjeter me rëndësi është edhe formimi i fëmijëve me konceptet e para të njohurive fetare dhe praktikat fillestare të saj. Në një familje ku adhurohet Zoti xh.sh. dhe kryhen rregullisht praktikat fetare, në një shtëpi ku babai dhe nëna, gjyshi dhe gjyshja sillen sipas mësimeve të larta të fesë sonë islame, edhe fëmija nën shembullin e mirë të prindërve dhe me kujdesin e përditshëm të tyre futet në rrugën e drejtë, përvetëson konceptet fillestare të fesë dhe nis në fillim me sugjestion e nën shembullin e të rriturve të praktikojë ritet fetare. Vini re sesa shumë fëmijë që nuk e kanë borxh agjërimin, kur vjen ramazani apo edhe në ditët e festave fetare agjeroj-

në. Vini re sesa të interesuar janë për disa rite fetare. Është detyrë e madhe të ushqejmë tek fëmijët ndjenjën e detyrës për fenë dhe praktikimin e saj. Sa me gjëzim afrohet fëmija pranë të rriturit dhe fillon e imiton atë në abdes, në falje, në lutje. Kjo është një mirësi e madhe. Po kështu, duhen ndjekur kurset për fëmijët që organizojnë Myftinia, Medreseja, qendrat kulturore islame apo xhamitë e lagjeve.

Raportet mes punës së shkollës dhe të familjes, ndërlidhja e këtyre dy institucioneve themelore është një problem me shumë rëndësi. Shpesh fëmija trajtohet si një top volejbolli, të cilin shkolla e hedh në fushën e familjes dhe anasjelltas. Ka shumë prindër që duan të zëvendësojnë mësuesin. Jo rrallë e ndihmojnë fëmijën deri në tepri për të kryer mësimet dhe detyrat shtëpiake. Ndonjëherë i marrin edhe mësues për ndihmë. Madje në shumë raste mësuesi në familje është bërë një dukuri gjithnjë e më e shpeshtë, sidomos për lëndët matematikë, gjuhë të huaja apo lëndë speciale. Kjo shpreh interesimin maksimal të familjes për edukimin e fëmijës së vet, por e gjithë kjo duhet parë me kujdes. Nuk janë të rrallë rastet kur prindërit flasin me nënvleftësim për punën e mësuesit në shkollë, e në përgjithësi të të gjithë shkollës, duke i mëshuar vlerës së punës ndihmëse në shtëpi. Kjo nuk është e drejtë. Sado të mundohet familja, nuk mund të zëvendësojë punën sistematike të shkollës. Nëse shkolla ka dobësi apo ndonjë mësues nuk e kryen detyrën si duhet, kjo nuk do të thotë që familja mund të marrë të gjithë barrën e rëndë që i takon shkollës.

Prindi duhet të kuptojë se edukata, qoftë ajo e shkollës, e familjes apo e mjeteve tjera, edhe në kushtet kur ajo është e organizuar mirë dhe e ndërlidhur, nuk mund të arrijë gjithmonë suksesin e pritshëm. Kjo varet edhe nga faktori trashëgimi. Shpesh trashëgimia është ven-

dimitare. Njeriu lind me mundësi të mëdha. Këto mundësi janë dhuratë e Të Plotfuqishmit, Mëshiruesit, Krijuesit të gjithësisë. Njeriu që në embrion merr me vete si në një kasafortë predispozitat e gjinisë njerëzore, gjithë mundësitë potenciale të zhvillimit. Njeriu lind me mundësi të mëdha. Format e larta të psikikës dhe funksioni i trurit janë të lindura si mundësi për t'u zhvilluar. Në kushte të caktuara ato zhvillohen mbarë e mirë ose edhe dobësohen apo zhvillohen keq. Është e qartë se atë që nuk e ka falë Zoti xh.sh., nuk mundet kurrë ta plotësojë as prindi, as mësuesi. Natyrisht, puna e edukatës ka vlerën e vet, sepse arrin të çojë përpara, ta zhvillojë, ta përpunojë mundësinë e dhënë. Nëse fëmija nuk ka predispozitat e duhura anatomo-fiziologjike në fushën e të dëgjuarit apo të ndjenjave estetike, ai e ka vështirë të bëhet talent në fushën e muzikës. Pa mendoni se sa fëmijë stërmundohen një jetë të tërë në një fushë të caktuar të artit, të sportit, apo të dijes, pa pasur sukseset e duhura. Prandaj familja në radhë të parë duhet të vërejë me shumë vëmendje fëmijën e vet, nëse në rrugën e zhvillimit shfaq mangësi anatomo-fiziologjike, e për këtë duhet të këshillohet me specialistin, mjekun, mësuesin, psikologun etj. Na vjen keq ta themi, por në këtë fushë dalin disa dukuri negative: ka prindër që i neglizhojnë disa të meta që vënë re tek fëmijët e vet, madje, edhe kur i konstatojnë, përpiken t'i nënveftësojnë apo edhe t'i fshehin. Keni parasysh psh. kur fëmija nuk sheh mirë. Kjo në mjaft raste konstatohet me shumë vonesë. Edhe kur mjeku e përcakton sëmundjen dhe jep porositë e duhura, ka ende mjaft prind që e nënveftësojnë këshillën e mjekut ose edhe nuk e zbatojnë për shumë arsy. Shpesh ka një farë ndrojtjeje apo ndjenjë turpi tek prindërit, që ndikon në kurrit të shëndetit të fëmijës. E jo vetëm kaq, por edhe pengon përparimin e fëmijëve në

mësime. Një fëmijë që nuk sheh mirë, nuk dëgjon apo ka një sëmundje tjetër, natyrisht që nuk ka mundësi të ndjekë rregullisht procesin mësimor dhe ai patjetër ka rënje, prandaj i duhet një ndihmë më e kualifikuar.

## Sot vihen re disa dukuri që duhen pasur parasysh.

*Shumë fëmijë rriten në familje me prindër të ndarë, larg njeritjetrit, babai punon në emigracion dhe nënës i del detyrë që të merret e vetme me fëmijët, gjë që ndikon jo pak tek fëmijët.*

*Një pjesë e mirë e fëmijëve të emigrantëve shkijnë të jetojnë së bashku me prindërit në një vend të huaj. Atje mësojnë gjuhën e vendit. Gjuha amtare jo vetëm që lihet mbas dore, por edhe krijon mjaft pengesa në aftësitë ligjëruese të fëmijës në gjuhën e huaj. Dygjuhësia është një vështirësi serioze për këta fëmijë për integrimin në shoqërinë e re.*

*Ka një kategori fëmijësh që nuk interesohen sa duhet për mësimin, familja nuk jep ndihmën e dubur, prapambetja theksobet, përparimi në mësimë bie, fillojnë ndërhyrjet tek mësuesit dhe lëshimet prej tyre. Nxënësit marrin dëftesa kaluese pa meritë. Këto dukuri trashëgohen në të gjitha kategori-të e shkollave, madje deri në shkollën e lartë. Ka edhe më keq. Një numër i madh nxënësish e braktisin shkollën dhe në rastin më të mirë merren me disa punë të thjeshta në ndihmë të ekonomisë shtëpiake ose rrinë e kalojnë kohën me lojëra e veprime të padenja, jashtë ndikimit të edukatës shoqërore apo të familjes. Këta janë fëmijë disi të braktisur, të cilët jo rrallë bëhen kontingjent i krimeve, në fillim të thjeshta, por që me kalimin e kohës paraqesin rrezikshmëri shoqërore.*

Problemet e edukimit mendor si dhe dukuritë negative që vihen re në këtë fushë, nuk mund t'i zgjidhë vetëm familja, pa një bashkëveprim të të gjitha mjeteve që ka në dispozicion shoqëria. Familja duhet dhe mund të japë të gjithë ndihmën e duhur, duhet të tregojë interesin maksimal të saj. Edukimi mendor fillon në familje, aty hidhen bazat e tij.

## Edukimi estetik

Edukimi estetik përgjithësisht është trajtuar gjithnjë si një problem estetik dhe si veprimtari e një sfere të ngushtë specialistësh. Madje edhe problemet e përbajtjes shpesh janë anashkaluar. Disa çështje të veçanta të edukimit estetik janë trajtuar përmes edukatës morale, mendore ose asaj të punës.

Edukimi estetik është pjesë me rëndësi e edukimit dhe ky fillon që në fëmijërinë e hershme, në familje, në shkollë dhe vazhdon gjatë tërë jetës.

## Detyrat e edukimit estetik

- *Formimi i koncepteve të para estetike për të bukurën, të shëmtuarën, të lartën, të ultën, të madhërishtmen etj.*
- *Formimi i aftësive për të perceptuar të bukurën kudo që të ndodhet ajo, në natyrë, në art, në sjellje, në të folur, në veshje etj.*
- *Formimi i shkathëtësive, i shprehive dbe i zakoneve të mira e të qëndrueshme estetike tek fëmijët*
- *Formimi i aftësive që njohuritë për kategoritë estetike të mund t'i zbatojnë në kushte të reja e në rrëthana të veçanta jashtë normave të mësuara. Fëmijët e të rinjtë duhet të*

*orientohen drejtë dbe mirë në problemet që sot servirë jeta dbe rrethanat ku jetojnë duke mbajtur një qëndrim të drejtë kundër ndikimeve të papajtuara me normat edukatës islame dbe qytetare që infiltrojnë në jetën tonë.*

- *Formimi i aftësive për ta krijuar të bukurën jo vetëm në veprimtarinë artistike, por edhe në jetë, në punë e në çdo veprimtari, që zhvillon njeriu.*

Kjo është një paraqitje përgjithësuese e detyrave të edukimit estetik. Ato nuk mund të zbatohen të veçuara njëra nga tjetra, por të lidhura ngushtë mes tyre, herë merr përparësi njëra, herë tjetra, kjo sidomos në kushtet e familjes.

Familja me jetën e veprimtarinë e saj të përditshme është një vatër me shumë rëndësi për formimin e koncepteve estetike dhe në përgjithësi për edukimin estetik. Kjo realizohet në mënyrën më të natyrshme, hap pas hapi, duke parë e duke bërë. Shpesh në themel të edukimit është shembulli i më të rriturve dhe fëmija në etapat e para të jetës ndjen dhe imiton. Të gjithë kemi vënë re se si nëna krahas kujdesit higjenik shëndetësor duke e mbajtur fëmijën pastër, e mban njëkohësisht edhe bukur. A nuk keni vënë re se pastërtia në shumicën e rasteve tek njerëzit dhe posaçërisht tek fëmijët është një shfaqje e së bukurës. Një fëmijë i pastër është njëkohësisht edhe i bukur. Në fëmijërinë e hershme pelenat e bardha, të lara e të hekurosura e paraqesin fëmijën edhe të bukur. Kur rritet, një fustan, një kordele, një palë çorape të zgjedhur sipas ngjyrave edhe moshës e paraqesin vajzën e vogël të hijshme. Disa shprehi e zakone të ngulitura që herët lozin rol të madh në edukimin estetik të fëmijës. Rregulli në mirëmbajtjen e banesës, të dhomës së ndenjës, të sistemimit të enëve të kuzhinës, të ngjyrave të bojërave të mureve, të mobilieve apo orendive tjera

krijojnë shije të veçanta tek fëmijët. Një ballkon me lule apo një oborr i sistemuar dhe i fshirë me kujdes është jo thjeshtë i pastër por edhe i bukur. Në të gjitha këto fusha që i përmendëm fëmija ndjen e vepron. Ai është jo thjeshtë soditës, nuk percepton vetëm të bukurën apo të pastrën në mjedisin familjar, por njëkohësisht ka edhe dorën e vet, veprimtarinë e vet. Një fëmijë që stërvitet të vishet vetë, nuk do të pranonte të kishte një këmishë të pahekurosur, apo një palë këpucë të ndotura me baltë. Ai duhet të ushتروhet çdo ditë nën syrin vëzhgues të prindërve të kontrollojë veten para se të dalë, që të ketë një paraqitje të hijshme. Nëse fëmijës i bëhen lëshime, nëse nëna apo babai nuk janë të kujdeshëm në paraqitjen e jashtme, edhe fëmijës nuk do t'i bëjë përshtypje shtëpia e pafshirë, tavolina e papastër, pjata e ndotur apo e pikuar nga gjella, këpucët e palustruara, këmisha e pahekurosur etj. etj. Kështu nga dita në ditë, nga rasti në rast fëmija rritet dhe edukohet që të ketë një paraqitje sa më të hijshme. Në këtë drejtim prindi duhet të ketë parasysh porosinë e Pejgamberit a.s."Vërtetë All-llahu është i bukur dhe e do të bukurën".

Që në fëmijëri prindi duhet të ketë kujdes të edukojë tek fëmija aftësinë për ta perceptuar, për ta kuptuar dhe për ta shijuar të bukurën në natyrë. Natyra e gjallë dhe jo e gjallë na mahnitë me bukurinë e saj që shprehet në format, në ngjyrat, në tingujt, në aromat nga më të ndryshmet dhe njëkohësisht nga më të bukurat. Prindi duhet të ketë të qartë se natyra që na rrethon me të gjitha pjesët e saja përbërëse është vepër e Krijuesit të Plotfuqishëm, All-llahut Famëlartë. Çdo gjë që na rrethon është krijuar në dobi të njeriut dhe ai e ka për detyrë ta njohë dhe ta vërë në shërbim të vet. Vjen pranvera dhe mugallon bari i njomë, bulojnë e çelin lulet dhe drunjtë vishen me gjethe. Dielli shkëlqen në mes të qiellit

me një ngjyrë të kaltër manushaqe. Burimet e ujërave të kristaltë vërshojnë dhe duke gurgulluar mbushin e fryjnë lumenjtë. Kafshët gjallërohen me pafundësinë e llojeve e tyre. Në këtë vezullim mahnitës të natyrës edhe fëmijët gëzohen e lozin të lirë. Ata duhet të mësohen të shijojnë këtë bukuri në çdo pamje që të shfaqet. Në këtë vepër mahnitëse të Krijuesit asgjë nuk është e tepërt, as e shëmtuar. Një mrekulli në pamje dhe një mrekulli edhe më e madhe në veprim, në funksion. Vëreni një kafshë çfarë do bretkosën p.sh. Zëri i saj i çjerrë nuk mund të krahasohet me këngën e bilbilit, por në një mjedis të qetë, mes fushash pa anë, në natën e errët, pranë pellgjeve me ujë, kuakja e korit të bretkosave, apo pallja e një gomari, a një hamshori është në harmoni të plotë dhe nuk krijon aspak homore negative, përkundrazi na njall gëzim dhe kënaqësi, duke thithur ajrin e pastër, na e mbush zemrën plot. Si të themi e plotëson kuadrin e asaj natyre të qetë. Po kështu ngjet p.sh. me një dukuri atmosferike. Në një natë të erret kur fryn e gjëmon, një shkrepitimë e fuqishme rrufeje çan qiellin dhe pas saj gjëmon e bubullon me buçimë. Gjithçka dridhet. Kjo në pamjen e parë është e frikshme. Por a nuk është njëkohësisht edhe madhështore? A keni vënë re ylberin pas shiut, atë brez shumëngjyrësh që i bije anë e përtej qiellit! Një përthemje e thjeshtë drite nga piklat e vogla të ujit, krijon një dukuri aq madhështore. Po dukuritë e natrës në vjeshtë? Tani si një vagon plot fruta mëma natyrë i vë para njeriut të gjitha prodhimet e begata. Rrushi plot lëng, shega majhoshe, fiku mjaltë, molla, arra, lajthia apo bajamja janë shtruar në sofrën e madhe. Cili fryshtë është më i mirë? Secila nga këto fryte është një dhuratë e shtrenjtë për njeriun dhe e vlershme për ushqimin e shëndetin e tij. Këtu janë kombinuar mirë e dobishmja dhe e bukura. Syri, goja, veshi, dora, hunda e fëmijës në

këtë mjedis duhen mprehur për të perceptuar të bukurën, për ta kuptuar dhe për të formuar ndjenja të holla dhe të drejta estetike.

Këto probleme të edukimit estetik janë të lidhura me formimin mendor, me dijet që ka njeriu. Në një mal të zhveshur, në një ditë vere kur çdo gur djeg njeriu e ka të vështirë të udhëtojë, shpejton hapat për të gjet freskinë e pyllit. Ndërsa një gjeolog sillet me orë të tëra me çekiç në dorë duke u endur mes gurëve për të gjetur kampionët e mineraleteve. Ai ka kënaqësinë e kërkuesit, sepse në ato shkëmbinj të zhveshur mund të zbulojë pasuri të mëdha minrale që ndryhen në zemër të malit. A nuk duket qartë se sa vlerë ka mbrehja e shqisave me thellësinë e diturive përfmijët? Nuk po trajtojmë këtu bukurinë e natyrës njerëzore si krijesa më e përkryer, më e plotë, më e përsosur si përfaqësues i All-llahut xh. sh. xh.sh. në tokë. Fëmija duhet edukuar në radhë të parë që të çmojë veten, të mbrojë vetveten, të njojë vetveten. Duke e njojur veprën e Krijuesit, bukurinë e mahnitshme të saj, do të kuptojmë edhe madhështinë e kësaj vepre, por edhe njëkohësisht edhe dorën e pagabuar të Mjeshtrit Krijues.

Në natyrën aq të bukur, në këtë mjedis kaq të këndshëm shqisat e fëmijëve mprehën e kënaqën.

Cili duhet të jetë qëndrimi i fëmijëve ndaj saj? A mund të ndërhyjë dora e njeriut për të dhënë edhe ai ndihmesën e vet në zbulurimin e mjedisit ku jeton? Sa ndikon familja në këtë fushë? Secili nga këto probleme ka vlerën e vet, por ne do të ndalemi vetëm në qëndrimin e fëmijëve ndaj së bukurës në natyrë. Vëreni një lullishte, lulet shumëngjyrëshe të kënaqin me bukurinë dhe erën e tyre të këndshme. A mjafton që fëmija t'i sodisë ngjyrat dhe të kënaqet me erën e tyre. Sa punë duhet të aftësohen të dallojnë ngjyrat dhe nuancat e tyre? Sa

variacione ka nga njëra ngjyrë tek tjetra dhe brenda së njëjtës ngjyrë? Shihni të verdhën deri në portokalli dhe kafe në sa dhjetëra e qindra variaçione ndryshojnë. Një mjeshtër teknolog që merret me ngjyrosjen e pëlhurave mund të vërejë nuanca ngjyrash të pafund në të zezën për shembull, ndërsa njerëzit e zakonshëm kalojnë pa i vënë re nga e zeza në gri e prej këtu në të bardhën. Fëmija nuk duhet të sodisë e të kënaqet, por edhe të mësojë sepse kështu mbresat do të jenë më të fuqishme e më të qëndrueshme. Jo vetëm kaq, por edhe do të mbajë qëndrimin e duhur ndaj bukurisë së natyrës. Ai po t'i njohë lulet p.sh dhe mundin që derdh kopshtari për rritjen e tyre, nuk do të shtrijë dorën që ta këpusë si pa të keq vetëm sa për t'i marrë erë e për ta hedhur pas pak. Qëndrimi i fëmijëve ndaj së bukurës në natyrë është i lidhur me kujdesin për ruajtjen e natyrës dhe ruajtjen e saj, me punën që bën vetë fëmija në këtë fushë. Bari i gjelbër i oborrit është i bukur, por ai duhet ujitur, duhet kositur, duhet pastruar nga barishtet e egra, pra duhet kujdes i përditshëm dhe i vazhdueshëm për të, përndryshe thahet. Në se fëmija punon vetë në këtë oborr, kurrë nuk do të vejë këmbën për ta shkelur barin apo për të këputur së koti lulet e rritura me aq kujdes e punë.

Më sipër trajtuam kujdesin që duhet të ketë i rrituri apo fëmija ndaj vetvetes. Tek njeriu duhet të jetë e bukur edhe veshja, edhe sjellja edhe mendja. Një djalë i veshur mirë nuk është kurrë aq i bukur në se nuk sillet me hije ashtu sikurse e kërkojnë normat e edukatës. Vëreni një djalë të rritur, të veshur mirë, ai në pamjen e parë duhet i hijshëm, por sa fillon të flasë e të marrë pjesë në bisedë, fjalët e tija të pavend, jashtë arsyes, ia zbehin pamjen e bukur, ai me të vërtetë mund të bëhet i shëmtuar, i pahijshëm. Nuk thotë kot populli: "Mos i shiko gunën, shikoji punën", ose "Shtat e hije, mend asnjë fije". Mendja, sjellja

e mirë, ia shtojnë hijeshinë njeriut.

Sot në mjedisin ku jetojmë lidhur me veshjen dhe paraqitjen e jashtme dalin shumë probleme. Për këtë na duhet të japim disa shpjegime. Njeriu vishet për të mbrojtur trupin nga agjentët e ndryshëm atmosferikë, në dimër me rroba të trasha e të leshta për t'u mbrojtur nga të ftohtit, në verë me rroba të lehta, të holla, pambuku, liri apo mëndafshi. Kështu krijon atë mikroklimë të domosdoshme për trupin. Natyrisht veshja e njeriut varet edhe nga shumë faktorë tjera. Këto lidhen me rregullat e normat e caktuara shoqërore, me zakonet e traditat, me moshën, me seksin, me mjedisin ku jetojmë, me punën që bëjmë, e me shumë faktorë tjera shoqërorë, natyrorë, ekonomikë, psikologjikë etj. Një punëtor mekanik duket bukur me një palë kominoshe që e mbrojnë gjatë punës nga vajrat e ndotjet tjera, ndërsa do të dukej i shëmtuar në një ceremoni zyrtare apo në një festë familjare. Madje e ka të ndaluar të vejë në xhami me rroba pune të papastra. Po kështu ka dallime të mëdha në shijet për veshjen mes femrave të moshave të ndryshme, një plakë duket bukur me rroba ngjyrash të mbylltë, të zeza, gri, blu etj, ndërsa një nuseje këto nuk i shkojnë, ajo sipas moshës që ka vesh rroba më të çelura, më të hapura, me lule. Në një mjedis malor, me rrugë të thepisura e plot pengesa, një palë opinga gome janë shumë të dobishme për rrugëtarin, ato nuk duken aspak keq në këmbën edhe të një djali të ri, por në trotuaret e qyteteve ato duken të shëmtuara. Po kështu në mal nuk duken aspak të bukura këpucët me taka, apo çorapet e hollë najloni, këto janë të përshtatshme në një mjedis qytetar.

Shumë të rinj, sidomos vajzat, gjoja për arsyen vapse apo edhe mode dalin para publikut gjysmë të zhveshura. Ju i vini re çdo ditë nëpër rrugët e qytetit, në mjediset familjare, shtetërore apo shoqërore madje edhe në prezen-

cën e prindërve apo edhe të të huajve. Të gjithë i shikojnë me habi, disa edhe me ëndje apo edhe me syrin hileqar. Minifundet, shpatullat, madje krejt shpina, gjoksi jashtë janë shprehje të së bukurës apo të një tendencë drejt së keqes dhe të pamoralshmes? Një vajzë apo grua e zbuluar me të gjitha hiret përjashta rrobave para syrit lakkimes të tē huajve nuk duket bukur. Hiret personale sidomos pér femrat janë dhundi pér të cilat duhet pasur turp tē shikohen nga tē huajt, madje edhe nga familjarët. Kjo shfaqje e femrës nē mjediset shoqërore apo edhe shtetërore nuk përputhet me asnje normë morale tē traditës sonë popullore dhe as fetare dhe aq më pak me normat e fesë islame.

Sikurse shihet nē këto fusha edukimi estetik është sot një problem mjaft i mprehtë.

## Krijimin e së bukurës nga vetë fëmijët

Pér edukimin estetik, nē këtë fushë kaq delikate tē edukatës ka shumë rëndësi aftësimi i fëmijëve pér tē krijuar tē bukurën, tē madhërishmen, tē lartën ose edhe pér tē luftuar dhe shmangur tē shëmtuarën, tē ultën, tē neveritshmen. Shpeshherë nuk ka shumë rëndësi që fëmija apo i ri i di mirë gjërat, rëndësi ka nëse ai di t'i zbatojë nē jetë ato që di, t'i zbatojë nē rrethana e nē kushte tē reja apo edhe ta krijojë vetë tē bukurën nē tē gjitha shfaqjet e saj e nē tē gjitha fushat e veprimitarisë. Aftësimi i fëmijëve pér ta krijuar tē bukurën kalon nē disa shkallë.

Fëmijët duhet tē marrin njojuritë dhe konceptet e para pér kategoritë estetike. Vërtetë ata janë tē vegjël dhe nē familje nuk mund tē bëhet fjalë pér koncepte e siste-

me konceptesh në fushën e kategorive estetike, nuk mund të bëhet fjalë për njohuri të sistemuara shkencore, por konceptet e para të drejta duhen krijuar patjetër. Ndoshta kjo nuk bëhet në mënyrë rigorozë shkencore si në shkollë, por fëmija që në familje, që në moshë të njomë duhet të kuptojë dhe të formojë shkakhtësitë e shprehitë e para për këto koncepte qofshin këto edhe empirike, në format e thjeshta praktike si veprime, dukuri a sjellje që kanë lidhje me të bukurën apo kategoritë tjera që përmendëm më sipër. Në veprimitari e sipër, duke parë e duke bërë, fëmija mësohet me konceptin e së bukurës në pamjen e paraqitjen e jashtme, të trupit, të rrobave, të orendive shtëpiake, të tryezës së bukës, të tavolinës së mësimeve, të librave të shkollës, të paraqitjes së detyrave të shtëpisë, të mbarësisë së tyre, të shkrimit etj.

Po kështu mësohet të shqiptojë e të flasë bukur, të përshëndesë me hije e nderim më të mëdhenjtë duke filluar nga prindërit e pjesëtarët e tjerë të familjes, të ecë hijshëm, të qëndrojë në tavolinën e bukës, të hajë, të mbushë lugën, të përtypë kafshatën etj. Veprime të vogla në pamjen e parë, ku shprehet bukuria e sjelljes së një fëmije të edukuar me shije të holla në bazë të koncepteve që ka fituar në gjirin e familjes. Kjo pastaj bartet në rrugë, në shkollë, në klasë e kudo që fëmija apo i riu ndodhet. Në të gjitha këto mjedise paraqitja e fëmijës mund të shprehë bukurinë e sjelljes dhe të edukatës apo edhe shëmti, mund të krijojë emocione pozitive kënaqësie apo edhe negative, neveritjeje, mospranimi që mund të arrijnë deri në pakënaqësi dhe urrejtje.

Punët që bëjnë fëmijët në ndihmë të familjes janë të shumta. Në secilën prej tyre shprehin gjendjen e tyre emocionale, aftësitë dhe shprehitë estetike që kanë fituar. Mënyra sesi vishet fëmija, si ndihmon në rregullimin e shtëpisë, në shtrimin e tavolinës, në sistemimin e lu-

leve të oborrit apo të saksive, në rregullimin e vendit të studimit apo të punës, shprehin fare qartë nivelin e perceptimit dhe të krijimit të së bukurës. Mënyra si e vesh këmishën një djalë, si i kreh flokët, si i mbath këpucët tregon shpejt e qartë nëse ka shije estetike apo i nëpërkëmb ato. A nuk shihni nganjëherë djem të veshur keq, të krehur edhe më keq, me fletore të shkruara pa asnje rregull e hijeshi? A nuk janë këta pasqyrë e qartë e kërkesave të ulta ndaj tyre nga prindërit dhe nga mësuesit? Sot kushtet kanë ndryshuar, por paraqitja e hijshme e tyre që shpreh kërkesat e larta të formimit estetik nuk është në lartësinë e duhur. Ata priren mbas imitimeve të modës, gjoja të përparuar. A nuk shihni vajza të veshura jashtë çdo norme qytetarie, të lyera e të zbulkuar jashtë caqeve të njerezisë, të zhveshura deri në lakuriqësi e të gjitha këto bëhen në emër të modës.

Ka rëndësi që të rinjtë të mbajnë një qëndrim dinjitor. A nuk shihni vajza edhe djem që në ambientet publike demonstrojnë sjellje, fjalë e gaz jashtë çdo rregulli e norme? Të gjithëve na bëjnë përshtypje sjelljet, fjalët, qëndrimet, muzika apo çdo gjë që i kalon caqet e së bukurës, por që përfat të keq bëhen në emër të së përparruarës, të qytetëruarës, perëndimore.

Një fushë e rëndësishme e edukimit estetik është edhe shprehja bukur e qartë e mendimeve përmes fjalëve, përmes gjuhës së folur dhe të shkruar. Kjo nuk është aspak dhundi e veçantë. Shpesh dëgjohet tek fëmijët shprehja: nuk më vjen hartimi etj. Shprehja e qartë e mendimeve nuk është aspak dhundi e veçantë. Fëmijët duhet të ushtrohen që në familje, madje që në fjalët e para që të shqiptojnë saktë e drejt tingujt, fjalët, fjalitë. Nuk janë të rralla rastet kur të rriturit kënaqen me shqiptimet gjysmake dhe të gabuara të fëmijëve. Fjalët e thëna përgjysmë, tingujt e shqiptuar gabim janë dukuri të na-

tyrshme të përpjekjeve të fëmijëve që sapo kanë filluar të flasin. Qëndrimi i të rriturve dhe në disa raste edhe i mësuesve, mospajtimi i tyre dhe përpjekja për t'i korriguar është e domosdoshme. Prindi nuk duhet ta përqeshë fëmijën as të kënaqet me gabimin duke ia ledhatuar dobësinë, përkundrazi duhet të jetë shumë i matur dhe i kujdesshëm që fëmija të qortojë të metat që vihen re. Vëtëm kështu ai do të dijë të korrigjojë veten dhe të ecë përpara në mësimin e drejtë të fonetikës, të leksikut, të lidhjes së fjalëve dhe të ndërtimit të drejtë të fjalive. Shqiptimi i saktë, shprehja e bukur dhe e drejtë sipas rregullave të gjuhës është një punë e vështirë që kryhet me shumë ushtrime dhe kujdes të dyanshëm, mes prindit dhe fëmijës. Nuk janë aspak të rralla rastet kur prindi bëhet shembull i keq për fëmijën. Ai duke dashur të jetë i afërm dhe i dashur me të, gjoja se po merret vesh më mirë, fillon e flet edhe vetë me tinguj të shtrembëruar, me fjalë gjysmake dhe me fjali të cunguara. Më shumë vështirësi paraqesin ata fëmijë që kanë defekte të lindura në organet e frymëmarrjes dhe të daljes së ajrit e të zërit nëpër gojë. Ka fëmijë që kanë mish në hundë, që i kanë bajamet e sëmura, që kanë defekte të gjuhës, të dhëmbëve, të qiellzës apo të grykës. Këta fëmijë kanë prirje për më shumë gabime, prandaj duhet më shumë durim e kujdes, duhen më shumë ushtrime. Të vegjlit duke e kuptuar defektin e tyre, stepen, heshtin, kanë frikë e turp të flasin, kështu që e ruajnë për një kohë më të gjatë defektin dhe paaftësinë e tyre.

Krijimi i së bukurës shprehet edhe më qartë në veprimtarinë krijuese artistike të fëmijëve. Ata që në moshë fare të njomë në mënyra të ndryshme kërkojnë të hedhin në letër idetë e tyre përmes figurave dhe ngjyrave. Me baltë, rërë e plastelinë formojnë gjithfarë modelesh që vetëm ata i kuptojnë. Kjo botë e re për ta duhet inkura-

juar nga prindërit, të cilët jo rrallë i marrin me të qeshur e tallen me punimet e fëmijëve duke i quajtur shkarravina. Fëmija kërkon të afirmohet dhe madje krenohet me atë që ka arritur të sajnjë, kur papritmas nga prindi nuk gjen përkrahje, madje jo rrallë edhe tallje e kërcënime.

Një fushë po kaq me rëndësi është edhe ajo e këngës, e muzikës, e poezisë e përrallës. Fëmija përmes tingujve dhe fjalëve shpreh ndjenjat dhe emocionet e veta. Sa mundësi u krijojmë ne fëmijëve në këtë fushë? Disa shfajësohen se nuk dinë, disa të tjerë se nuk kanë kohë. Nuk është e drejtë që fëmijët të priren pas muzikës së pakontrolluar, filmave dhe letërsisë së ndaluar për moshën. Shumë prindër tregohen liberalë ndaj fëmijëve të cilët deri në orët e vona, madje duke sakrifikuar edhe mësimet, edhe gjumin shohin filma me subjekte jashtë shijeve dhe logjikës fëmijërore. Pakujdesia dhe mosinteresimi i prindit janë më të dëmshëm se vetë programet e pakontrolluara.

Loja është një fushë e gjerë për edukimin estetik të fëmijëve. Vajzat e vogla zënë lojë dhe sajnjë me mendjen e tyre gjithfarë subjektesh ku shprehin fort bukur gjendjen e tyre shpirtërore, herë bëhen nëna, herë mësuese dhe edukatore, herë nuse, herë gjyshe. Qeshin, qajnë, urdhërojnë, heshtin duke krijuar gjithfarë situatash interesante dhe emocionale. Ndërsa djemtë kënaqen në ajrin e pastër duke bredhur e luajtur me njëri-tjetrin.

Tendenca e shumë prindërve është t'i mbajnë fëmijët brenda shtëpisë, sepse gjoja janë më shumë nën kujdesin e tyre. Këta fëmijë nuk guxojnë të luajnë me top se djersiten e ftohen, se ndyhen e zhgërryhen me baltë e me pluhur, etj. arsyë të rriturish. Nuk duhet të harrojmë se sjelljen e bukur, marrëdhëniet e drejta e të mira me shokët fëmijët më mirë se askund i shfaqin në lojë. Kush janë më të bukur, fëmijët e skuqur në fytyrë nga loja, fë-

mijët e djersitur nga vrapimet apo verdhacukët që mezi lëvizin e frikësohen edhe nga flladi i lehtë?

Familja ka mundësi të shumta për edukimin estetik të fëmijëve, në mes të të rriturve ata marrin konceptet e para, formojnë aftësitë dhe shprehitë e para estetike, mbajnë qëndrim të drejtë ndaj së bukurës dhe aftësohen ta krijojnë atë në veprimtarinë e përditshme në familje, në shkollë, në veprimtarinë praktike dhe në natyrë.

## Edukimi moral

Në familje problemet e edukimit moral zënë vendin kryesor. Çdo prind, por sidomos nëna kujdeset për fëmijën e vet, që ai të jetë i shëndetshëm, i bukur, i ditur e në radhë të parë i sjellshëm. Në familje ditë për ditë në mënyrë të vazhdueshme dhe shumë të natyrshme fëmija edukohet me normat morale. Natyrisht që në këtë fushë familja nuk është e vetme. Tek brezi i ri ndikojnë një seri faktorësh dhe mjetesh shoqërore të ndërthurura njëra me tjetrën. Por tharmin, shtytjen, të gjitha virtytet e mira, sjelljet dhe qëndrimet e njeriut i marrin në familje.

Edukimi moral në bazë të normave të fesë islame sot merr një rëndësi të veçantë, sepse populli ynë, sikurse shkruan **Haxhi Vehbi Gavoçi** ... *ka kaluar shumë kohë larg fesë, bile edhe kundër saj në zemër, në fjalë, në lexime, në punë, në familje e në shoqëri, derisa erdhi dita e lirisë së besimit, shkëlqen dielli i fesë në vendin tonë, i zgjoi njerëzit nga gjumi, krijoi mundësinë që ata të përvetësojnë e të zbatojnë rregullat e mirësjelljes që pëlqeben nga Zoti xh.sh.* Sot të rinjtë tanë ndeshen me shumë ndikime negative, të cilat i tërheqin në botën e së keqes, të së ndaluarës, drejt të mirave të shfrenuara të kësaj bote farfuritëse. Shoqëria jonë është molepsur me lloj- lloj krimesh e veprash të ndaluara që nga pijet alkoolike e droga, prostitucioni, vrasjet, grabitjet, e deri në sjelljet e padenja në familje, në shoqëri e në institucionet shtetërore. Këto rrethana na nxisin që në të gjitha fushat e me te gjitha mjetet, por sidomos në familje.

je të punohet më shumë, më me kujdes për t'i edukuar fëmijët me moral të shëndoshë. Në **Kur'an** vlerësimi për besimtarët është ky: ‘*Besimtarët dhe besimtaret janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë dhe ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dbe jepin zeqatin, e respektojnë All-llahun dbe të Dërguarin e Tij. Të tillët do t'i mëshirojë All-llahut. All-llahu është ngadhbënjes, i urtë...*’ (Kur'ani: Tevbe, 71-72).

Ndërsa nga tradita Pejgamberike janë trashëguar një numër i madh mësimesh e udhëzimesh me vlera morale të cilat do të kemi rast t'i citojmë.

Cilat janë synimet dhe detyrat e edukimit moral?

**Së pari**, fëmija në gjirin e familjes duhet të formojë konceptet e njohuritë më themelore morale islame. Disa nga këto koncepte janë: koncepti i besimit (iman), i mirësisë, i devotshmërisë, i jetës, i mëkatit, i lirisë, i barazisë, i vëllazërisë, i paqes, i bashkësisë, i mirësjelljes, i frikës, i shpresës, i sinqeritetit, i vendosmërisë, i falënderimit, i dashurisë etj. Fëmijët duhet të formojnë parafytyrime të plota e të sakta mbi sjelljet dhe veprimet morale, të dallojnë të mirën nga e keqja, hallallin nga harami, të drejtën nga e shtrembëta, të kontrollojnë veten dhe të jenë rigorozë dhe kërkues jo vetëm ndaj vetes, por edhe shokëve e miqve tjerë në jetë, të respektojnë normat e rregullat morale në familje, në xhami, në shkollë, në rrugë e kudo që të ndodhen në përpjekje me të tjerët. Fëmijët nën kujdesin e nënës apo më të rriturve në familje, më vonë në shkollë, në rrugë apo në shoqëri fillojnë të kuptojnë ç'është e mirë apo e keqe, formojnë konceptet dhe parafytyrimet e para morale.

**Së dyti**, formimi i bindjeve morale. Koncepti islam për edukimin moral si proces veprues i mëson prindërit që të punojnë me fëmijët në mënyrë të vazhdueshme, që të mos kufizohen vetëm në formimin e fëmijëve të vet

me parimet, me kategoritë dhe rregullat e moralit, por të gjitha çfarë ka mësuar fëmija apo i riu në fushën e moralit të shndërrohen në bindje të brendshme të tyre. Vihet re se shumë fëmijë në familje, por edhe në shkollë e më gjerë i kanë të qarta konceptet apo normat e sjelljes, por nuk i zbatojnë apo edhe i shkelin ata kur janë larg prindit, mësuesit apo edhe më të rriturit. Njohuritë dhe normat e përvetësuara duhet t'i udhëheqin fëmijët në veprimtarinë dhe në sjelljen e tyre të përditshme. Jo sa di, por sa bën vlen njeriu. Feja jonë është fe e veprimit. Çdo prind dhe edukator duhet ta ketë të qartë se feja islame ia lë njeriut lirinë e zgjedhjes ashtu siç dëshiron ai.

**Kur'ani thotë :** “*E ti thuaj: “E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë.”*”(Kur'ani: Kehf, 29). Koncepti islam i lirisë është një njësi e besimit, një urdhër i lartë i Krijuesit Suprem. Ai bazohet në parimet themelore që vijojnë: vetëdija e njeriut është subjekt vetëm i All-llahut xh. sh., të Cilit çdo njeri i përgjigjet drejtpërdrejt; çdo qenie njerëzore është përgjegjëse për veprat e veta dhe vetëm asaj i është lejuar t'i mbledhë frutat e punës së vet; Zoti xh.sh ia ka urdhëruar njeriut përgjegjësinë për të vendosur për vetveten dhe se njeriu është i përgatitur nga ana mendore dhe shpirtërore dhe ka gjithashtu aftësitë praktike që e mundësojnë të bëjë zgjedhje përgjegjëse dhe të shëndosha. Nga të gjitha këto kuptojmë së fëmija apo i riu duhet të jetë përgjegjës për veprimet e veta dhe të ndërgjegjësohen, të jetë i vetëdijshëm për atë që bën. Ka plot raste që fëmijët dhe në përgjithësi njerëzit janë në gjendje të shohim gabimet apo të metat në sjelljen e të tjera, por kur është fjala për veten, ata nuk pranojnë asgjë. Këtë populli e ka përgjithësuar me një fjale të urtë: *Sheb qimen e tjetrit dbe nuk sheb traum e vet.*

Në fushën e formimit të bindjeve morale tek fëmijët

familja luan rolin kryesor në rapport me të gjitha mjetet dhe faktorët tjerë të edukimit jo vetëm për shkak të vazhdimësisë maksimale të punës edukative në familje, por, edhe sepse prindi është në kontakt të vazhdueshëm me fëmijën e vet dhe ky është i natyrshëm, pa as më të voglin zyrtarizëm. Nëna apo çdo i rritur në familje me shembullin e vet, me veprimet e veta të thjeshta e të përditshme është një faktor me rëndësi dhe shembull shumë i fuqishëm që fëmija që në moshë të njomë sheh dhe imiton, në fillim në mënyrë të pavetëdijshme e pastaj me bindje të plotë. Çdo veprim a sjellje sado e thjeshtë e një të rrituri në shtëpi është nën vëzhgimin e fëmijës dhe lë gjurmë tek ai. Prindi duhet t'i qëndrojë fëmijës pranë me këshilla, me porosi, me udhëzime, me qortime, me urdhra e ndalesa të cilat do t'i vlejnë për gjithnjë. Natyrisht, shembulli dhe sjellja e prindit është me shumë rëndësi. Ai duhet të kujdeset edhe për shokët apo shoqet e fëmijës së vet, sepse një shoqëri e mirë është një mjet me rëndësi në sjelljet dhe veprimet praktike të fëmijës. Ai në mjedisin shoqërор dhe pikërisht me shokët e vet afirmon bindjet e veta morale dhe sjelljen e vet.

*Së treti*, formimi i shprehive dhe i zakoneve të sjelljes morale. Pajisja e fëmijëve me një sistem sa më të plotë shprehish e zakonesh të sjelljes në përputhje me normat morale islame ka për qëllim që ata të veprojnë kudo që të gjinden dhe në çdo rrethanë me bindje të plotë e në mënyrë të pavarur. Ata duhet të mësohen të kontrollojnë veten dhe veprimet që bëjnë, të jenë të përgjegjshëm dhe të veprojnë me bindje të plota e për hir të Allahut të gjithëdijshëm. Kërkesat e shtruara nga prindi për një normë a sjellje fëmija jo vetëm që duhet t'i kuptojë e të jetë i vetëdijshëm për to, por edhe duhet t'i zbatojë në jetë në të gjithë veprimitarinë që zhvillon e në çdo rrethanë që të ndodhet. Zbatimi dhe ushtrimi i

vazhdueshëm në veprime praktike krijon mundësitë që të formohen shprehi dhe zakone të mira të sjelljes së drejtë morale tek fëmijët. Opinion i drejtë në familje, kërkesat unike në familje, shkollë dhe shoqëri bëjnë që i riu kudo të veprojë mirë dhe në bazë të normave morale. Për fat të keq në mjediset tona familjare dhe aq më pak shkollore dhe shoqërore normat morale islame nuk kanë zënë vendin e duhur. Janë vetë fëmijët apo edhe të rinjtë në shumë raste shembull dhe mësim për prindërit e paformuar. Këtë e kemi vënë re me fëmijët dhe të rinjtë e medresesë, të cilët janë një faktor me rëndësi edukimi moral dhe këmbëngulës për zbatimin e normave dhe kërkesave islame në familjet e veta apo edhe tek shokët e shoqet. A nuk vini re se si në xhamitë tona ka më shumë të rinj e fëmijë, ndërsa baballarët e tyre mungojnë për shumë arsyë? Në familjet tona duhet të krijohet një mjedis i shëndoshë kërkesash dhe veprimesh praktike islame, ku fëmijët të ushtrohen sistematikisht për zbatimin e normave morale dhe të formojnë zakone të qëndrueshme dhe shprehi të sjelljes së lartë morale islame.

**Së katërti**, e gjithë puna për edukimin moral duhet të na çojë në një përfundim themelor, formimin e ndërgjegjes morale islame. Fëmija, i riu apo i rrituri të gjykonë e të veprojnë në bazë të parimeve të moralit islam. Sjelljet e veta apo sjelljet e të tjera të t'i analizojnë në bazë të mësimeve të Kur'anit, traditës Pejgamberike dhe shembullit të më të mirëve. Në familjet tona duhet që fëmijët të jenë që herët në kontakt me këto norma dhe të stërviten që t'i zbatojnë ato me kujdes dhe përpikëri. Kështu nuk do të kenë vetëm koncepte të thata e të mësuara përmendsh, bindjet e tyre të ushtruara dhe të zbatuara në veprimet e përditshme në mënyrë të ndërgjegjshme do të formojnë zakone e shprehi të drejta morale

dhe në këtë mënyrë, hap pas hapi që herët formohet ndërgjegjja morale islame që i udhëheq ata në jetë. Veprimet e thjeshta e të përditshme, në dukje pa rëndësi, marrin vlera dhe kuptim të lartë, marrin vlerën e një adhurimi kur bëhen për hir të All-llahut xh. sh. xh.sh. . Në këtë mënyrë familja bëhet një vatër me rëndësi e edukimi të fëmijëve të vet. Ata nën kujdesin e prindërve dhe nën shembullin e tyre plotësojnë një nga kushtet e rëndësishme të besimtarit islam, formimin dhe edukimin moral. Pejgamberi ynë i nderuar na ka lënë këtë këshillë me vlerë: “**Njeriu është i sigruar kur ta ketë të dlirtë zemrën e tij për besim, ta ketë mendjen e shëndoshë, gjuhën e tij të vërtetë, shpirtin e tij paqedashës, karakterin e tij të pastër e të sinqertë dhe sytë për të parë**”. Pra shembulli më i mirë e i përsosur për moralin shembullor është Muhammedi a.s. shih për këtë se çka thotë All-llahu xh. sh.: “*Vërtet ti ke moralin e madh (të përsosur)*”

## Brendia e edukimit moral

Synimet dhe detyrat kryesore të edukatës morale kanë vlerën e tyre, por familja e së bashku me të e gjithë shoqëria duhet formojë tek fëmijët dhe të rinjtë konceptet dhe njojuritë me bazë morale, këto të kthehen në bindje, në shprehi dhe zakone të sjelljes dhe e gjitha kjo të çojë në formimin e ndërgjegjes morale islame.

Synime edukimit moral kanë një përbajtje, kanë një brendi. Prindi dhe e gjithë familja në punën e përditshme për edukimin moral duhet të dijë se çfarë do t'u mësojë fëmijëve të vet në fushën e moralit islam. Këtu

përfshihen tiparet morale, ndjenjat morale islame, idetë, kategoritë dhe normat e mirësjelljes.

Morali islam përcakton qartë parimet, rregullat e marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe All-llahut xh. sh. xh.sh., njeriut dhe njerëzve tjerë, njeriut dhe krijesave të tjera të gjithësisë dhe ndërmjet njeriut dhe thellësisë së ndërgjegjes së vet. Myslimani duhet të kontrollojë sjelljen dhe veprat, fjalët dhe mendimet, si dhe ndjenjat e qëllimet e tij. Është detyrë e tij ta miratojë atë që është e drejtë dhe të luftojë kundër asaj që është e keqe, ta kërkojë të vërtetën dhe t'i shmanget së padrejtës, ta ushqejë të bukurën dhe të shëndoshën dhe t'i largohet të turpshmes dhe të shëmtuarës. Qëllimet e tij janë e vërteta dhe virtuti. Përulësia dhe thjeshtësia, përzemërsia dhe mëshira janë natyra e dytë e tij. Arroganca dhe zbrazësia, vrazhdësia dhe indiferenca janë të pahijshme, ofenduese për të dhe të papranueshme nga Zoti. Marrëdhëniet e myslimanit me All-llahun janë të lidhura ngushtë me dashurinë, adhurimin dhe dëgjinin, me besimin e plotë dhe me ndershëmërinë, me paqen, rehatinë shpirtërore dhe veprimtarinë aktive. Në këtë mes mund të marrim vetëm një aspekt të marrëdhënieve të njeriut me atë që është themelore, mbështetja tek Zoti xh.sh. Ky problem në familjet tona ndeshet çdo ditë në të gjitha aspektet e veprimtarisë së familjes. Njeriu, prindi, madje edhe fëmija i vogël përpinqet të plotësojë nevojat e veta e për këtë duhet të kërkojë mbështetjen e All-llahut xh. sh. xh.sh. Është e njojur këshilla e Pejgamberit a.s. "*Lidbe derenë, pastaj mbështetu tek Zoti xh.sh.*" Njeriu nuk duhet të qëndrojë indiferent, duarlidhur, duke pritur riskun e vet. Njeriu, po të dojë Xhennetin, duhet të punojë mirë, po të dëshirojë arsimimin, duhet të mësojë, po të kërkojë pasuri e begati në familje, duhet të lodhet e të punojë shumë, po të ruhet nga sëmundjet, do të ketë shëndet të

mirë, po të kërkojë nderim e vlerësim nga të tjerët, duhet të sillet me edukatë e kulturë. Muslimani çdo gjë duhet ta bëjë për hir të All-lahut xh. sh. dhe të mbështetet vetëm tek Ai. "... *Dituria e Zotit ka përfshirë çdo gjë; ne vetëm të Zoti jemi mbështetur dbe vetëm te Ai kemi varur punët tonas...*" (Kur'ani: A'ruf, 89)

Një i urtë ka thënë se njeriu i lutet All-lahut të gjithmëshirshëm në dy mënyra: me fjalë dhe me punë. Lutjes së parë All-llahu xh. sh. mund t'i përgjigjet në këtë jetë apo në jetën tjetër. Kjo është në dorën e All-lahut xh. sh., por lutjes me punë Ai i përgjigjet menjëherë. Punëtorit që ngrihet herët në mëngjes dhe derdh të gjithë dijen dhe mundin e tij që ta kryejë punën sa më mirë, me ndershmëri e drejtësi, All-llahu i përgjigjet menjëherë shumëfish. Ideja është e qartë. Ai prind që dëshiron të rrisë fëmijë të edukuar mirë dhe me moral të shëndoshë, duhet të japë shembullin e tij në punë, duhet të përveshë mëngët e të derdhë shumë djersë. Nuk mund të ketë fëmijë të edukuar mirë pa treguar të gjithë kujdesin e përditshëm dhe të vazhdueshëm. Nuk mund të kenë shëndet të mirë fëmijët pa i mbrojtur nga sëmundjet e pa u kujdesur për jetën e tyre. Nuk mund të kenë përparim të lartë në shkollë pa i stërvitur që të mësojnë rregullisht dhe me intensitet të lartë. Jashtë punës e kujdesit nuk mund të kemi sukses të plotë e, pasi të kemi kryer të gjitha detyrimet tonas, pasi të kemi derdhur të gjithë mundin tonë, atëherë duhet t'i nënshtrohem vullnetit të All-lahut xh. sh. e t'i drejtohem për ndihmë.

## Marrëdhëniet e njeriut me shoqërinë

Hyrja e njeriut në marrëdhënie shoqërore në kuptimin e vërtetë të fjalës bëhet relativisht vonë, kur është në moshë të rritur dhe përgjegjës për veprimet e veta. Megjithatë elementet e para të lidhjeve dhe marrëdhënieve me të tjerët krijojnë që në fëmijërinë e hershme në gjirin e familjes. Kjo rrjedh, sepse njeriu, pra fëmija, është një krijesë e dobët, e brishtë që deri vonë ka nevojë për kujdesin e familjes, në fillim të nënës, pastaj të të gjithë pjesëtarëve të tjerë. Më vonë ai shkon në shkollë dhe nën kujdesin e mësuesve dhe të edukatorëve formohet dhe zhvillohet si një qenie e plotë shoqërore, i aftë të hyjë në veprimtarinë e gjerë të jetës që e rrethon. Ndërkohë ka shumë mjete e faktorë të tjerë që ndikojnë tek ai, në të dy kahet, për të mirë, për edukimin e tij dhe njëkohësisht për të keq, që përpiken ta fusin në vorbulloën e jetës, ku ziejnë si në një kazan ligësitë dhe veset që shpesh lënë gjurmë të fuqishme në jetën e të riut, gjurmë që shlyhen me shumë vështirësi.

Njeriu, fëmija, lind si një krije e përsosur, e paqtë, pa të meta, e pastaj nën kujdesin e familjes dhe ndikimin e saj ai merr një edukatë të caktuar. Përgjithësisht familja përpinqet që bijtë e vet t'i rrisë dhe edukojë nga e mira dhe e mbara, t'u mëkojë që herët sjellje të mira, por fëmija njëkohësisht pëson edhe deformime e shtrembërimë jo të pakta, gjë që varet nga shkalla e traditës familjare në edukatë, nga kushtet e saj, nga interesimi dhe përgatitja e prindërve, por edhe nga shumë faktorë të tjerë brenda e jashtë familjes. Fëmija gjithnjë ka nevojën e prindërve, që ata t'i gjinden pranë, të kujdesen për të, për problemet e zhvillimit fizik dhe të edukatës. Mendoni një fëmijë të sapolindur. Kush do ta ushqejë, kush do

ta lajë, ta veshë, ta mbathë, ta edukojë, shkurt ta trisë dhe ta nxjerrë në jetë? Në rastin më të mirë ky person është nëna, prindërit, pjesëtarët dhe tjerë të familjes, edukatorët. Fëmija është i dobët, madje shumë më i dobët se mjaft gjallesa të tjera. Mendoni një peshk ose një zog, sa të pavarur janë nga prindërit në krahasim me njeriun. Një fëmije i duhet një vit e më tepër të aftësoshet të flasë, të ecë apo të kryejë disa nevoja elementare. Në këtë proces të vështirë, të rëndë e të lodhshëm prindërit dhe të tjerët janë gati për të ndihmuar. Kjo është një lidhje e natyrshme, një lidhje vartësie e fëmijës, madje e jetës dhe e ekzistencës së tij ndaj nënës, ndaj familjes dhe gjithë botës që e rrëthon. Duke u rritur fëmija, këto lidhje zgjerohen, forcohen dhe marrin karakter të veçantë dhe më të ndërlikuar. Në fillim janë lidhje e vartësi nevoje, jete, fëmija është i nënshtuar dhe pret mëshirën dhe ndihmën e të tjerëve. Më vonë këto lidhje ndryshojnë karakterin dhe sensin, madje që në fëmijërinë e hershme te fëmijët lindin cilësi e sjellje disi të çuditshme për të rriturit, megjithë paaftësinë dhe pamundësinë e tyre. A i keni vënë re tekat dhe ledhat e tyre që, edhe kur të tjerët janë gati t'i ndihmojnë, ata shprehin kundërshti krejt të paarsyeshme. Fëmija me pamundësinë e vet i urdhëron të rriturit të ulen në gjunjë dhe sillet sipas dëshirës dhe tekave të tij. Kjo ngjet edhe për nevojat më elementare, për ushqim, veshje, gjumë, banjo etj.

Shpeshherë vihet re një interesim i tepruar i nënave dhe i të rriturve të tjerë, kështu që fëmijët mësohen që herët të hanë me lugën e mëkuar prej të tjerëve. Kjo është një e keqe e madhe që vazhdon për një kohë të gjatë. Ka fëmijë që arrijnë në klasat e larta të shkollës dhe vazhdojnë të kërkojnë praninë e të rriturve për t'u ushqyer, për t'u veshur dhe për të pasur gati gjërat elementare. Këta fëmijë rriten sakatë, të paaftë t'i dalin zot

vetes nē jetē. Sapo tē jenē tē lirē nga vartēsia e familjes, askush nuk ka pēr t'ua kryer nevojēt e tyre e pēr shumē kohē mund tē heqin keq derisa tē mēsohen t'i shērbejnē vetes.

Krahas familjes, fēmija qē heret bie nē kontakt me shokēt dhe mēsuesit nē shkollē dhe nē lagje. Tani lidhjet ndryshojnē: nuk e kanē karakterin e natyrshēm e tē vazhdueshēm tē kushteve tē shtēpisë. Nē shkollē lidhjet e marrēdhēniet me mēsuesit kanē karakter zyrtar, mēsue si eshtē mē i largēt se prindi, ai vērtetē cilēsohet si njē prind i dytē, por gjithmonē mbetet prind i dytē. Dhe kjo diferencē eshtē shumē e madhe. Megjithatē, qē heret fēmija (nxēnēsi) e kuption se ai ka nevojē pēr shkollēn, pēr mēsimin, pēr mēsuesin, prej tij varet nē njē farē shkalle e ardhmja e tij, pērgatitja dhe formimi i tij pēr jetēn, prandaj lidhjet e fēmijēs me mēsuesin kanē karakter tē thellē pēr nevoja cilēsisht mē tē larta. Nē kētē mēnyrē lidhjet mes nxēnēsit dhe mēsuesit megjithē pērpjekjet pēr t'i barazuar si role, mbeten nē njē farē mase lidhje varēsie dhe ndihme. Kjo e rrit vlerēn dhe rolin e mēsuesit nē drejtimin e jetēs sē fēmijēs. Nuk eshtē aspak rastēsi qē prindi del nē plan tē dytē nē njē periudhē tē caktuar nē rrugēn e formimit tē fēmijēs, ndērsa mēsuesi luan rolin kryesor. Kur njeriu pērparon nē njē fushē tē caktuar, pothuajse gjithnjē i referohen mēsuesit qē e ka pasur, e jo prindit. Sidoqoftē, si nē shkollē ashtu edhe nē shtēpi fēmija apo nxēnēsi nē marrēdhēnie me prindin ose me mēsuesin duhet tē kuptojē se cili eshtē caku i veprimtarisē sē tij, tē mos i kapērcejē rregullat dhe kufijtē qē i vihen. Jo trallē nē emēr tē lirisē fēmijēt veprojnē pa kontroll dhe larg kujdesit tē tē rriturve (prindēr apo mēsues), gjē qē krijon rreziqe tē shumta. Eshtē e domosdoshme qē fēmija tē kuptojē se çdo tē thotē urdhēr, ndalesē, porosi, detyrē qē duhet kryer patjetēr dhe pa mē tē voglin kundērshtim.

Fëmija duhet mësuar t'i zbatojë pa mëdyshje urdhërat e prindit në familje, madje ka urdhëra që jepen me autoritet pa qenë nevoja që prindi të hap gojën, bën një gjest, hedh një vështrim dhe kjo mjafton. Por ju e shihni që jo gjithnjë ngjet kështu. Ka fëmijë që ndonëse e dinë kë-shillën, porosinë apo urdhërin, përpiken t'i shmangen, ta vonojnë ose të mos e zbatojnë atë. Madje ka raste të harta kundërshtie, kryeneçësie dhe veprimi kundër rrëgullave. Në shumë raste ka një tendencë për ta përligjur këtë mënyrë veprimi në emër të edukimit të pavarësisë së fëmijës. Por këtu ngatërhojen dy gjëra të ndryshme: aftësia për ta kuptuar jetën në bazë të këshillave, porosive, urdhërave, ndalesave të më të rriturve dhe për të vepruar sipas përvojës së tyre të mirë dhe aftësia që duhet të fitojë fëmija për të vepruar në mënyrë të pavarur në jetë në bazë të përvojës së fituar. Vërtetë rruga e provave dhe e gabimeve është mjapt e dobishme, por kjo nuk do të thotë që në rrugën e edukimit të mos ecim gjithnjë nga e mbara, e drejta, e mira, e urdhëruara dhe të shmangim sa të jetë e mundur më shumë të gabuarën, haramin. Sidoqoftë, përvoja e mirë në edukim tregon se nuk është e lehtë të formohet aftësia që fëmija ta kuptojë drejt urdhërin dhe ta zbatojë atë me seriozitet. Fëmijët që rriten “të lirë”, që nuk dinë se ç'është ndalesa, penge-sa, por lëshohen gjatë gjithë ditës të bredhin jashtë kontrollit të më të rriturve e në radhë të parë të prindërve, kanë rrrezikun e madh që të bien pre e ndikimeve të dëmshme të shokëve dhe të mjediseve të pakontrolluara. Është shumë e vështirë të shmangen veset apo sjelljet e padenja morale, madje shumë më e vështirë sesa të edukohen sjelljet e cilësitë e mira.

Marrëdhënieve me prindërit në fushën e edukatës is-lame u kushtohet një vemendje e veçantë. Këto marrëdhënje përbëjnë bazën e harmonisë familjare, të gjëzimit

të familjes, të së ardhmes së saj të lumtur. Pleqëria e lumtur e prindërve sigurohet nga fëmijët që në të ardhmen bëhen mbështetje dhe mbrojtje e tyre. Në gjirin e familjes në një cikël që rihapet në përjetësi, prindi kujdeset dhe i ndihmon fëmijët dhe këta të fundit, kur rriten u gjenden pranë prindërve, i ndihmojnë dhe u sigurojnë pleqëri të mbarë e të qetë. Kjo është tipike për shoqërinë shqiptare, pavarësisht nga ndryshimet e kohëve të fundit, kjo është tipike për bashkësinë islame në përgjithësi e për familjet myslimane shqiptare në veçanti. Këshillat morale islame në këtë fushë janë të qarta dhe të plota. Në ajete të ndryshme kuranore, në traditën pejgamberike dhe në këshillat e dijetarëve islamë problemeve të marrëdhënieve familiare u kushtohet e gjithë rëndësia e duhur. Atje janë trajtuar qartë marrëdhëniet me fëmijët në mosha të ndryshme, në fëmijërinë e hershme, në rini dhe në periudhën e pjekurisë, marrëdhëniet e nënës e të babait me djalin e vajzën, të drejtat dhe detyrat e tyre, gjithashtu janë trajtuar detyrat e bijve ndaj prindërve, të djemve, të bijave të martuara e kështu me radhë. Nuk ka aspekt të jetës familjare e të marrëdhënieve mes etërve dhe bijëve që të mos jepen këshilla e porosi me vlera të larta për të gjitha kohët. Këto probleme, si edhe ato të mjeteve të komunikimit masiv, si: radio, televizori, libri, filmi, teatri, interneti e të tjera mjetë me vlera edukimi sot janë shumë aktuale dhe me vlera të mëdha në formimin pedagogjik dhe edukativ të prindërve. Theksojmë se marrëdhëniet me shokët në mikromjedisin ku jetojnë fëmijët janë të çiltra, të besueshme, të lira, por nuk duhet harruar se ato shpesh janë të rrezikshme: fëmijët ose të rinjtë kanë prirje t'i largohen kontrollit, ndihmës dhe kujdesit të të rriturve. Mosha më kritike është ajo e adoleshencës. I riu kërkon ta afirmojë veten, të heqë tutelën e të rriturve, por edhe gabon. Në këtë

kohë lindin mjaft kontradikta mes etërve dhe bijve. Për këtë **Gëte** ka thënë: *Eshtë dëshirë e përjetshme e baballarëve që të shobin te bijtë e vet dy jetë, atë që u takon vetë të rinjve dbe atë që kanë lënë pa e bërë vetë në jetë.* Prindërit kërkojnë që fëmijët të mos i përsërisin gabimet e tyre, ndërsa të rinjtë duan të veprojnë sipas mundësive dhe aftësive të tyre. Të rinjtë gabojnë, të vjetrit shqetësohen. Këtu është burimi i mospërputhjeve në mendimet e breznive.

Marrëdhëniet me mjetet e komunikimit masiv kanë natyrë disi të veçantë. Ato janë shumë të fuqishme, teknikisht të larta, shumë masive, u drejtohen të gjitha moshave gjatë 24 orëve të ditës, priren pas interesave dhe dëshirave të të rinjve. Në marrëdhënie me këto mjete fëmijët dhe të rinjtë janë soditës, në mjaft raste imitues në veprime, në sjellje, në veshje, në pamje etj. Këto mjetet kanë shumë vlera edukative, por po të mos kontrollohen të rinjtë, ato mund të bëhen një shembull i keq degjenerimi moral.

Në familje fëmija duhet të edukohet që të jetë i përzemërt ndaj të afërmve të tij, ndaj fqinjëve të vet, të ketë nderim ndaj pleqve dhe mëshirë ndaj më të vegjelvë, të tregojë kujdes ndaj të sëmurëve dhe të japë të gjithë ndihmën e mundshme ndaj të varfërve, të jetë tolerant ndaj të paditurve dhe falës ndaj të pafuqishmëve, të mospajtohet me të keqen dhe të parëndësishmen. Veç kësaj, ai duhet t'i respektojë të drejtat legjitime të të tjera, aq sa i respekton edhe të drejtat e veta. Mendja e tij duhet të jetë e preokupuar me ide dhe kërkesa serioze, zemra e tij duhet të rrahë në paqe dhe qetësi, ndërsa këshilla e tij duhet të jetë e singertë dhe e përzemërt.

Askund më shumë se në familje fëmija nuk edukohet më mirë e më natyrshëm, që të jetë i ndershëm dhe i përsosur, t'i plotësojë dhe t'i zbatojë detyrat në mënyrë korrekte, të kërkojë dituri dhe virtyt me të gjitha mundë-

sitë që i krijon jeta në familje. Në veprimtarinë e përditshme fëmija duhet të korrigojë gabimet dhe të pendohet për mëkatet e tij, të zhvillojë një kuptim të drejtë të vetëdijes shoqërore dhe të ushqejë ndjenjën e përgjegjësisë njerëzore ndaj të varurve prej tij, t'i furnizojë me gjithçka u duhet pa kurrfarë mëzie. Që në moshën e njomë fëmija ndien dhe e kuption kujdesin që tregohet për të nga prindërit e posaçërisht nga nëna, pa kurrfarë interesit dhe pa pritur as më të voglin shpërbirim. Ai sheh kujdesin e përgjithshëm familjar ndaj të sëmurëve apo të moshuarve të pamundur, mësohet dita-ditës jo vetëm t'i nderojë, por edhe t'u shërbejë e të sakrifikojë për ta në mënyrë të natyrshme dhe pa mërsi.

Prindi duhet të ketë kujdes që parimet morale të fesë islame t'ua japë fëmijëve të vet si porosi dhe detyra që duhet të përbushen pa hezitim, p.sh., Shtyllat e islamit, kurse disa të tjera si udhëzime për t'u ruajtur nga gabimet. Këto vlejnë për ta mbrojtur të riun nga degjenerimi, nga dobësia dhe shfrenimi, nga turpi dhe joshja. Feja islame i ka ndaluar disa gjëra që kanë të bëjnë me ushqimin e pijet dehëse, me argëtimet e dëmshme e të kota si bixhozi etj., me marrëdhëniet seksuale jashtëmartese, si dhe me të gjitha sjelljet e pahijshme në të folur, të ecur, në paraqitje të jashtme etj. Këto do të shërbejnë që të krijojnë tek fëmijët një mendje të ndritur, një shpirt paqësor, një personalitet të fortë dhe një trup të shëndoshë.

Përbajtja e edukatës morale shtrihet në shumë fusha të jetës personale, familjare dhe shoqërore. Në familje nën shembullin e më të rriturve mësojnë të jenë me karakter të fortë, të mos bëjnë lëshime në asnjë fushë të jetës që nuk përputhet me normat e mirësjelljes islame në të dy krahët, në detyrimet, të lejuarat (hallall) dhe në të ndaluarat.(haram). Ajo që është e mirë, përkrahet, nxitet, mbështetet, ajo që është e ndaluar, e padenjë apo e

pahijshme, frenohet, ndalohet.

Fëmija në familje mësohet me konceptet e para të atdhedashurisë që nis nga nderimi dhe kujdesi për shtëpinë e vet, oborrin, rrugën, qytetin e shtrihet në konceptin atdhe. Mëson të nderojë të parët, njerëzit e shquar e të devotshëm të familjes së vet, të edukohet nga virtytet e tyre të larta. Në këtë mes, në Islam ka një qëndrim të drejtë mes universales, së përgjithshmes dhe nacionales e kombëtares.

Në familje fëmija edukohet me qëndrimin e drejtë ndaj punës. Puna është një mjet me shumë rëndësi për edukimin e formimin e shumë koncepteve e sjelljeve të larta morale. Gjithashtu në familje formohen konceptet e para për pronën. Familjet tona kanë nderuar dhe kanë treguar gjithnjë kujdesin e duhur për pronën e vet, por edhe të komshiut. Një nga gjërat më të turpshme dhe më të dënuara moralisht ka qenë përvetësimi i gjësë së tjetrit. Në periudhën kur u ndalua feja nga sistemi komunist, këto dy probleme me rëndësi të edukatës u dëmtuan rëndë. Koncepti për punën dhe pronën në përpjekjet për të krijuar idenë e punës dhe të pronës së përbashkët shoqërore, u prekën në themel e tyre. Puna në shtëpi-në e vet, kopshtin apo arën, në dyqanin apo në fabrikën e familjes u quajt e turpshme dhe u ndalua me ligj. Kjo solli shpronësimet dhe fukarallëkun e skajshëm. U shkaterruan pronat, u shtetëzuan tokat, fabrikat dhe të gjitha mjetet e punës. Kjo solli pasoja shumë negative në konceptet morale, lindën vese dhe qëndrime shumë të padenja për njeriun në përgjithësi e aq më shumë për një musliman.

Sjellja e kulturuar dhe tiparet e larta morale janë një fushë shumë e gjerë e veprimtarisë së familjes.

Të gjitha këto janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën, nuk mund të formohen të shkëputura e larg njëra-

tjetrës. Ato formojnë tiparet më të qenësishme të një besimtari të devotshëm islam.

Në një ajet të **Kur'anit** të madhërueshëm thuhet: “*O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz(lutje), bani dbe pini e mos e tepron, pse Ai (All-llahu) nuk i do ata që e teprojnë (shkaperderdhin). Thuaj:’Kush i ndaloi bukuritë dbe ushqimet e mira që All-llahu i krijoi për robërit e vet? ’...Thuaj: ‘Zoti im i ndaloi vetëm të këqijat e turpshmë, le të jenë të haptë ose të fshehta, ndaloi mëkatin, ndaloi shtypjen e tjetrit pa të drejtë, ndaloi t'i mvishni All-llahut shok pa patur për të kurrfarë argumenti dbe ndaloi të thoni për All-llahun atë që nuk e dini se është e vërtetë’.” (Kur'ani, 7:31-33)*

## **Metodat e edukimit**

### **Ç'janë metodat dhe çfarë kuptojmë me mjete edukimi?**

Metodat e edukimit janë têrësia e mënyrave dhe mjeteve që përdoren për tê formuar tiparet qenësore të personalitetit të njeriut, ndërsa mjetet e edukimit janë rrugët konkrete që përdoren për tê zbatuar në jetë një metodë të caktuar edukimi ose edhe disa prej tyre.

Të gjithë edukatorët, mësues apo prindër, duhet ta kenë tê qartë se metodat e edukimit lozin një rol me rëndësi në edukatë, në mjaft raste përbajtja e shëndoshë e edukimit nuk arrin qëllimet e dëshiruara, sepse nuk është transmetuar me metoda e mjete efikase. Theksojmë se metodat dhe mjetet e edukimit shërbejnë për tê realizuar qëllimet e edukatës në përgjithësi apo aspekte të veçanta të saj. Metodat e edukimit ndahen në dy grupe të mëdha:

- **në metoda** që ndikojnë në formimin e vetëdijes së fëmijëve, kryesisht në aspektin teorik të problemit (këtu kemi parasysh metodën e bindjes) dhe
- **në metoda** që ndikojnë në formimin e përvojës

jetësore, në sjelljen dhe në veprimtarinë e fëmijëve, që kanë të bëjnë me anën praktike të edukimit (këtu kemi parasysh metodën e ushtrimit dhe të stërvitjes). Kjo ndarje është e vështirë të bëhet në praktikë, sepse gjatë veprimtarisë edukative në familje metodat e edukimit janë një tërësi disi e pandashme.

Metodat e edukimit janë: **metoda e bindjes, e të ushtruarit, e nxitjes dhe e frenimit**, ndërsa mjetet e edukimit janë: **puna e prindërve dhe e gjithë jeta familjare, shkolla dhe mësuesit, letërsia fetare, edukative, artistike e shkencore, mjetet e komunikimit masiv (të shkruara, dëgjimore dhe pamore), shembulli, autoriteti, regjimi, lavdërimet, këshillat, detyrimet, ndëshkimet etj.** Në kushtet e bashkëjetesës familjare, të natyrshmërisë së edukimit, të vazhdimësisë maksimale të saj edhe metodat janë të lidhura ngushtë dhe përdoren së bashku, shpeshherë në mënyrë aq të natyrshme, saqë prindi as nuk mendon se cilën metodë po përdorë por vepron thjeshtë duke shkelur nëpër ato rrugë ku ai është stërvitur gjatë jetës në traditën edukative të familjes së vet. Sidoqoftë ne po japim një paraqitje të shkurtër të metodave dhe mjeteve më të përdorshme të edukimit.

## Metoda e bindjes

Bindja si koncept pedagogjik ndryshon nga metoda e bindjes. Bindjet janë koncepte dhe ide të përvetësuara në mënyrë të vetëdijshme, që kanë forcë vepruese dhe që e udhëheqin njeriun në jetë, ndërsa bindja si metodë

synon edukimin e tyre, synon t'i sqarojë fëmijët për detyrat që kanë dhe për kërkesat që u paraqiten, që t'i kupojnë dhe t'i përvetësojnë këto në mënyrë të vetëdijshme, saqë të mos kenë as dyshimin më të vogël dhe të mos lëkunden për t'i zbatuar. Kjo metodë është themelore në punën edukative të prindërve. E theksojmë këtë, sepse fëmijët janë të vegjël, janë në formim e sipër dhe jo çdo gjë mund ta kuptojnë në mënyrë të vetëdijshme. Në familje fëmija duhet të zbatojë kërkesat e nënës, të babait dhe të të gjithë pjesëtarëve të familjes. Prindi parësisht nga mosha u jep fëmijëve porosi, u kërkon të bëjnë ose të zbatojnë një detyrë që në dukje është e thjeshtë, por ka vlera të mëdha bindëse. Fëmija gjithnjë është nën kujdesin e pandërprerë të prindit. Ai duhet ta kuptojë se ky kujdes është i pérhershëm, edhe kur prindi nuk ndodhet prezent. Kështu fëmija përpinqet të veprojë brenda kërkesave, brenda rregullave që ka familja, në fillim ndoshta duke hezituar, me përtesë, pa u menduar mirë dhe pa ndërgjegje, por pastaj vepron me dëshirë, me rregull, me bindje dhe jo rrallë bëhet krenar për atë që kryen.

Në shtëpi prindi e ka për detyrë që fëmijëve t'ua sqarojë detyrat që kanë, t'ua shpjegojë qartë dhe hap pas hapi, të formojë tek ata gradualisht koncepte dhe bindje të vetëdijshme nga të cilat duhet të udhëhiqen. Në familjet tona prindërit dhe sidomos nënët përdorin shumë këshilla, shumë sqarime, shumë qarje dhe ankime, madje jo rrallë dëshpërohen. Fjalët e tepërtë dhe ato që quhen moralizime të thata në edukatë, nuk kanë vlerën e duhur, ato bëhen pengesë në edukatë, i bezdisin fëmijët të cilët dalëngadalë fillojnë dhe mësohen me to, u shmangen, shprehin haptazi shqetësimë dhe veprojnë në kokë të tyre duke i anashkaluar shqetësimet e prindërve që më shumë flasin sesa veprojnë. Kjo është edhe një nga arsy-

et që metoda e bindjes nuk mund të përdoret e vetme dhe e shkëputur nga metodat e tjera e mjetet e shumta edukative. Bisedat mes prindërve, diskutimet e shumta për zgjidhjen e problemeve të ndryshme, atmosfera e gjë-zueshme familjare, marrëdhëniet, autoriteti, shembulli i prindit (mënyra si flet ai, si shprehet, si sillet, si rri, si qesh, si i zgjidh hallet dhe problemet e familjes, si i kryen detyrat e përditshme, si i pret miqtë dhe si sillet me ta etj. etj shfaqje të jetës familjare), kërkesat e urdhrat e tyre, koha që shpenzojnë ata për fëmijët dhe zgjidhjen e detyrave të tyre, marrëdhëniet e prindërve me shkollën dhe faktorët tjerë edukativë janë mjete me rëndësi. Këto duke u përdorur së bashku e në lidhje të ngushtë me metodën e bindjes jasin rezultate me vlerë në edukimin e fëmijëve.

## Kërkesa pedagogjike

Është një ndër metodat më të vjetra që njihet në shekuj për vlerat e saj. Në jetën e përditshme pjesëtarët e familjes jasin porosi për kryerjen e detyrave nga fëmijët. Kjo është më e dukshme në fazat fillestare të jetës, kur fëmija ka filluar të marrë mend. Hap pas hapi nëna disa punë fillon dhe ia kalon fëmijës. Ai tashmë po rritet dhe nuk është nevoja që gjithçka ta presë nga nëna ose më i rrituri. Fillon vetë të lajë duart, fytyrën, këmbët, të vendosë rrrobat në raftin e duhur, të ndihmojë në shtrimin e tavolinës, në rregullimin e shtëpisë etj. etj. punë të vogla, por që fëmija duhet të mësohet t'i kryejë vetë dhe sa më herët që të jetë e mundur. Mësohet t'i shërbejë vetes edhe të tjerëve, prindërve, gjyshit apo gjyshes. Për të

gjitha këto gjëra të vogla fëmijët duhen porositur, duhen urdhëruar, u duhen shtruar kërkesa të vazhdueshme gjithmonë të lidhura me mundësitë e tyre, me aftësitë fizike dhe intelektuale. Disa shkathësi, shprehi apo zakone të mira të marra në fëmijëri kanë vlera të mëdha për tërë jetën, kanë lidhje me vullnetin, me karakterin dhe marrjen përsipër të përgjegjësive familjare. Kjo do të jetë një mirësi e madhe, një pasuri e pashoqe që familja u jep fëmijëve, të cilët do të vazhdojnë tërë jetën mbarë e drejt në realizimin me korrektësi të punëve të tyre të përditshme. Jo çdo gjë që thuhet prej prindërve, jo çdo kërkesë e tyre do të zbatohet mirë e shpejt nga fëmija, patjetër që do të ketë zigzage, dredha, anashkalime, harresa me qëllim e paqëllim, prandaj në realizimin e kërkesave ka shumë rëndësi këmbëngulja për kryerjen e porosive të dhëna, për kryerjen e detyrave, për respektimin e përpiktë të regjimit dhe të disiplinës familjare, për të zbatuar shpejt dhe pa hezitime çdo urdhër të drejtë që jepet nga prindi apo edhe nga shkolla për në familje. Prindi duhet të shohë nëse porositë kryhen sa për sy e faqë apo kjo është e vetëdijshme dhe e vazhdueshme, në shtëpi dhe jashtë saj, në prezencën e të rriturve dhe kur fëmijët janë larg vëzhgimit të tyre. Në praktikën e punës së shumë prindërve shtrohen kërkesa për fëmijët, që shpesh shprehen me tone të ashpra, në formën e urdhavrave kategorikë, i fyejnë dhe i mërzisin ata. Jo rrallë shtrohen me të qeshur e si për lojë, gjoja për t'i provuar fëmijët. Natyrisht, nëse prindërit nuk kanë përvojën e mjaftueshme dhe seriozitetin e duhur, ata nuk duhet të habiten nëse marrin përgjigje dëshpëruese nga fëmijët. A i keni vënë re fëmijët që ndonjëherë as nuk ua vënë veshin fjalëve të prindërve. Nëna apo babai porosit, kërkon apo urdhëron diçka e fëmija bën sikur nuk dëgjon, sepse gjoja është i habitur në lojë apo ka diçka tjeter për të bërë. Jo,

nuk është kështu, ai dëgjon fare mirë, kupton mirë, por është mësuar t'i shmanget detyrës në të njëjtën formë edhe herë të tjera. E nëse një herë tjetër e ka kaluar me sukses (negativ) këtë provë, ai vazhdon në këtë mënyrë dhe ia merr dorën prindit. Njëri flet dhe urdhëron e tjetri (fëmija) bën të veten pa ia vënë veshin prindit. Në këtë rast kërkesa nuk zbatohet, sepse ajo nuk ndiqet, sepse prindi nuk është këmbëngulës në ndjekjen e saj.

Ka rëndësi që fëmija të edukohen të dëgjojnë kërkesa dhe t'i zbatojnë ato. Për këtë Gëte ka thënë: "Ai që nuk di as të urdhërojë, as të dëgjojë, nuk i duhet gjë askujt." Në jetën familjare kujdesi i prindit që fëmijët të dëgjojnë e të zbatojnë kërkesat është pjesë me shumë vlerë e edukatës, madje kjo është quajtur një nga sukset kryesore të edukimit familjar. Natyrisht, sot kjo ka shumë rëndësi, sepse vihet re tendenca që të çon drejt humbjes së autoritetit, autoritetit të prindit, të mësuesit, të shoqërisë e madje edhe të shtetit. Nuk janë të paktë të rinjtë të cilëve iu duken si të mykura këshillat dhe porositë e të rriturve.

Ka shumë rëndësi që fëmija të mësohet të dëgjojë urdhrat e porositë e All-llahut xh. sh. të madhërueshëm, të dëgjojë prindin, mësuesin, edukatorin, prijësit fetarë, ndërgjegjen e pikëpamjet e veta të arsyeshme. Dëgjesa është e lehtë kur të gjithë urdhërojnë në një drejtim, por është e vështirë kur urdhrat dhe urdhëruesit janë në kundërshtim, kur njëri urdhëron atë që tjetri e ndalon. Kjo mjerisht ngjet në familjet tona, kur babai urdhëron për një punë e nëna një tjetër. Aq më keq kur shkolla e shtëpia kanë kundërshti e mospajtime në kërkesa e porosi. Shkolla e në mjaft raste familja jepin mësimë që janë në kundërshtim me mësimet e fesë, me urdhrat e të madhit Zot. Mjafton të vështrojmë me pak kujdes tematikat e mësimeve të leximit në klasat e shkollës 8 vjeçare

për të kuptuar sesa larg jemi me kërkesa të njëjta në fushën e edukatës mes shkollës e familjes, mes shkollës dhe mësimeve të ndritura të fesë islame. Prandaj prindi duhet të ndjekë me shumë kujdes punën e shkollës dhe të bashkërendojë edukatën familjare duke i ruajtur fëmijët nga ndikimet e dëmshme shoqërore, ndikime që vijnë me shumë intensitet nga programet televizive, nga filmat, librat e pakontrolluar për moshën etj., etj. Fëmijët mund t'i dëgjojnë prindërit, mësuesit apo edhe edukatorët për hatër apo nga frika, mund edhe t'i shtrohen kërkësës, por kurrë nuk do të jenë të zotët të sundojnë e të rregullojnë veten.

Prindi për të formuar tek fëmijët aftësitë për të dëgjuar dhe zbatuar urdhurat duhet të ketë parasysh disa këshilla:

- Kupto ç'farë dëshire ka fëmija dhe përpiqu që ai ta përdorë në veprimtarinë e përditshme. Ai është i varur nga prindi, ia ka nevojën e më të rriturve, prandaj edhe e kupton se duhet t'u bindet dhe t'u nënshtrohet. Prindit apo edhe edukatorit i duhet të kuptojë nevojat që ka fëmija, t'ia plotësojë, të fitojë besimin e tij, por të mos bëhet më fëmijë se fëmija. Në shumë familje prindërit iu nënshtrohen kërkësave dhe tekave të fëmijëve, gjë që sjell pasoja negative, sepse fëmijët mësohen të hanë me lugën e të tjerëve, u hipin në qafë prindërve.

- Përpiqu që fëmija të plotësojë kërkësat, porositë dhe urdhrat në mënyrë të vullnetshme. Çdo fëmijë vlon nga dëshira për ta shfaqur veten si më i rritur, për ta shprehur personalitetin e tij. Ai ka si të themi brenda vetes zekthin e lirisë, prandaj kërkesa, urdhri apo porosia nuk duhet dhënë në mënyrë kategorike. Prindi mund ta shprehë kërkësën me fjalë të buta, pa e vrarë apo pa e në-përkëmbur krenarinë që çdo fëmijë e ka në natyrën e vet.

- Fëmija duhet të kuptojë se ti nuk lyp tanë një punë

e pastaj një tjetër. Ai në bazë të kërkesave të vazhdueshme duhet të kuptojë se prindi e di më mirë se askush ç'është më e drejtë për të, prandaj me endje i nënshtronhet kërkesës apo urdhrit. Urdhrat duhet të jenë të matur e kurrë të kundërt. Është me pasoja të rënda për edukimin e fëmijës, nëse sot jep leje për një punë që dje e kendaluar.

- Prindi duhet të bëhet shembull me punë duke kryer detyrat. Do të ishte gabim, nëse prindi, vëllai apo motra më e madhe kryejnë një porosi duke shprehur pakënaqësi. Nëse i rrituri nuk bindet edhe në punët më të imta para fëmijëve, ai bëhet pa dashje një shembull i keq për ta. Mos harroni se ju jeni çdo ditë nën vëzhgimin e vazhdueshëm të tyre. Ata duken si të harruar në lojërat e veta, por papritur japid përgjigje apo edhe ndërhyjnë edhe atëherë kur ne mendojmë se nuk po shohin apo dëgjojnë.

- Në jetën familjare vihen re fëmijë kryeneçë, të llastuar dhe me teka. Këta nuk kanë lindur të tillë, por janë edukuar keq nga vetë prindërit. Nuk duhet të lejojmë në asnjë rast të plotësohen tekat e fëmijëve, madje kur fëmijët ngulmojnë në të tyren, duhen përdorur dënimet dhe ndalesat kategorike për ta. Prindërit zakonisht bëjnë lëshime e kjo ngjet sidomos me nënrat e gjyshërit, të cilët i marrin nën mbrojtje gjoja nga zemërimi i babait apo nga urdhrat e tij.

- Të silleni me fëmijët pa u shtirë, të afërt, të njerëzishëm dhe të ëmbël. Butësia dhe zemra e mirë e zbusin edhe më të egrin. Urdhrat kategorikë e të rreptë duhen përdorur shumë trallë.

## **Ushtrimi**

Është një metodë e lashtë edukimi. Ajo në mjaft raste quhet edhe metodë e stërvitjes. Përmes ushtrimesh formohen tek fëmijët shkathësitë, shprehitë e sjelljes dhe zakonet e nevojshme. Rregullat apo normat e ndryshme të sjelljes së bukur islame nuk mund të zbatohen qorrazi nga fëmijët. Ata në radhë të parë duhet të kuptojnë domethënien e tyre, të jenë të vetëdijshëm për domosdoshmërinë e zbatimit të tyre, prandaj nuk mjaf-ton vetëm kuptimi dhe bindja pa u shoqëruar me ushtrime dhe stërvitje.

Edukimi fillon përmes ushtrimesh. Fëmijët sa më të vegjël që të jenë, aq më mirë stërviten dhe ushtrohen si të flasin, si të sillen, si të paraqiten bukur dhe hijshëm në mjedisin familjar apo shoqëror etj. etj. Ky është një proces i përditshëm, i vazhdueshëm, i gjatë dhe i vështirë. Fillon në familje e vazhdon në shkollë e prej këtej gjatë gjithë jetës. Sapo fëmija rritet dhe futet në shkollë, prindërve u shtohen shqetësimet në fushën e edukimit. Në të vërtetë shumë prindër sikur e lehtësojnë barrën e vet duke ia mbështetur shkollës edukimin e fëmijëve të tyre. Kjo nuk është e drejtë. Me kalimin e fëmijës në një etapë tjetër, në atë të jetës shkollore, puna e familjes hynë në një fazë të re më të vështirë. Tani duhen më shumë ushtrime, më shumë kujdes sepse fëmija ndodhet në situata të reja para të cilave nuk është stërvitur të veprojë. Prandaj edhe shumë fëmijë në këtë periudhë pësojnë shumë ndryshime në raport me jetën disi të ndryrë dhe individuale të familjes. Ju të gjithë keni vënë re se fëmijë me shumë teka në familje, sapo futen në shkollë, në praninë e mësuesve aq më tepër të rrëthit të gjerë të shokëve dhe shoqeve moshatarë, ndryshojnë shumë në sjellje. Por ka

raste që fëmijë të shkathët në jetën familjare, në shkollë stepen, bëhen të heshtur, kanë shumë vështirësi të përballojnë mësimet e aq më tepër të ushtrohen në kryerjen e detyrave të shtëpisë. Kështu puna e prindërve futet në një etapë të re më të lartë cilësisht, natyrisht edhe më të vështirë. Prandaj ushtrimet kanë rol të madh në familje.

Prindi në veprimtarinë për ushtrimin duhet të ketë parasysh:

- Veprimet e mëparshme të ushtrohen shpesh, sepse kështu ato kryhen me siguri, mirë, bukur dhe shpejt.

- Veprimet të kryhen gjithnjë në një mënyrë sepse vetëm kështu fuqitë e fëmijës përqendrohen, vështirësitet në punë apo në sjellje bëhen gjithnjë e më të vogla, rezultatet janë më të qarta.

- Ndër rastet më të vështira duhen bërë më shumë ushtrime, më shumë stërvitje, sepse ka rrezik që fëmija sapo të ndeshë një pengesë dhe duhet të marrë një vendim për të vepruar, në vend që të arrijë rezultatin e prishëm, ulë përpjekjet, mërzitet dhe i shmanget punës. Në familje prindërit i mësojnë keq bijtë e tyre duke ua bërë gjithçka gati, pa u lënë kohë fëmijëve të mendohen, të përpiken dhe të lodhen vetë.

- Ka mjaft raste kur fëmijët me ndryshimin e rrethanave, sillen në mënyrë krejt tjetër. A nuk keni vënë re që fëmijët në shtëpi janë të shkathët e veprojnë drejtë në përputhje me rrethanat, ndërsa mpihen, turpërohen dhe fshihen pas fustanit të nënave në një mjedis jashtë familjes, ose më keq veprojnë si të zgjidhur e jo rrallë i habisin prindërit me sjelljen e tyre të padenjë. Fëmijët të ushtrohen e të stërviten që të veprojnë me bindje në rrethana të ndryshme nga ato të familjes. Syri i prindit duhet të vështrojë me shumë kujdes sjelljen e fëmijëve të vet kur ata janë të lirë sidomos mes shokësh në lojë e sipër larg të rriturve.

- Fëmijëve u duhet dhënë rasti që të vetëveprojnë, të zgjidhin ata vetë punët që kanë në ngarkim, të sillen me liri të plotë sipas shembullit dhe udhëzimeve që kanë marrë. Shpesh prindërit u rrinë shumë mbi kokë fëmijëve, i këshillojnë dhe i udhëzojnë në çdo hap që hedhin, shkurt i kapin për hunde, pa u dhënë shkas atyre për veprimitari të lirë.

Ushtrimi realizohet nëpërmes shumë mjeteve të edukimit, mes tyre përmendim rregullin, disiplinën, regjimin në familje, shembullin e më të rriturve sidomos të nënës dhe të babait etj.

Stërvitja dhe ushtrimi është një punë e vështirë që kërkon shumë punë dhe durim. Shpesh në familje kemi shumë qarje dhe ankime, moralizime e fjalë të thata pa vlerë të cilave fëmijët ua marrin dorën dhe dinë t'u rrëshqasin. Prindi duhet të lodhet shumë në fillim sepse shprehitë dhe zakonet e formuara shërbejnë si mbështetje e fuqishme për të arritur që atë të cilën e mendojnë fëmijët ta zbatojnë në jetë, në këtë rast synohet të arrihet një përputhje sa më e plotë mes ndërgjegjes morale dhe sjelljes së tyre.

## **Metoda e nxitjes dhe e frenimit**

Nxitja dhe frenimi kanë vlerë sidomos në fushën e edukimit moral. Thelbi i tyre qëndron në nxitjen e mëtejshme të veprimitarisë së frytshme të fëmijës duke ngjallur emocione pozitive ose në kufizimin e veprimitarisë e tij, duke ngjallur emocione frenuese. Nxitja dhe frenimi nuk ndikojnë drejt për se drejti në formimin e vullnetit të fëmijëve, por ata nxisin deri në një farë masë dëshirën

për punë apo për vepra të mira, ose në të kundërtën i bëjnë të têrhiqen apo të kundërshtojnë një veprim që nuk është i drejtë a i pëlqyeshëm.

Nxitja apo stimulimi moral bëhet me mjete të tilla, si: miratimi dhe mbështetja, lavdërimi, falënderimi etj. Në praktikën familjare kjo metodë shpesh nuk gjënë përdorimin e duhur. Fëmijët e çmojnë shumë vlerësimin dhe nxitjen e nënës, të babait në familje, të mësuesit apo të edukatorit në shkollë apo në shoqëri. Në familje duke qenë pak fëmijë, e aq më tepër kur janë të vetëm, nënët e jo më pak baballarët jepen shumë mbas fëmijës, kanë tepër debulesë, tregojnë kujdes të madh jashtë arsyesh aq sa edhe i llastojnë. Në shumë raste ata bëhen shkak për lindjen e tekave apo të shumë sjelljeve dhe tipareve të këqija të karakterit tek fëmijët. Gatishmëria e tepruar e nënave për t'ua plotësuar nevojat e fëmijëve jo rrallë i bën ata sakatë, fëmijët ngadalë por në mënyrë të pashmangshme bëhen tiranë mbi prindërit, bëjnë gjithfarë provash me to, aq sa u hipin në qafë. Që herët mësohen të hanë me lugën e të tjerëve. Nënët përgjërohen për ta, janë gati t'u nënshtrohen tekave të shumta të tyre, i ledhatojnë me tepri e pa shkak. Frikësohen se mos u ngjet gjë bijve të vet, prandaj bëjnë çdo sakrificë në emër të dashurisë për ta. Këta forma të nxitjes që përdorin prindërit në veprimtarinë e tyre të përditshme, shpesh kanë efekt negativ. Krejt papritmas janë pikërisht këta fëmijë që për habinë e madhe të nënave, tregojnë sjellje brutale ndaj tyre. E nënët të tmerruara lëshojnë kujën. "Mua që të kam bërë kryet, po ma thua këtë, po ma bën kështu apo ashtu ?" Dhe lotët në këto raste janë shprehje e dëshpërimit dhe provojnë qartë paaftësinë në edukatë, janë shpërbirim i merituar i lëshimeve të tyre.

Për nxitjen, e posaçërisht për shpërblimin si mjet i kësaj metode, prindi duhet të ketë parasysh disa këshilla:

1. Shpërblimi nuk duhet përdorur shpesh e me tepri, sepse humbet vlerën e vet.

2. Kur fëmija lavdërohet apo shpërblehet duhet vërejtur që ai të mos veprojë vetëm për hir të tij. Një fëmijë që është mësuar të punojë mirë vetëm për shpërblimin e pritshëm, kur të rritet do t'i duhet të përballojë vetë vështirësitë e jetës e në këto raste nuk ka për të pasasnje shpërblim, prandaj edhe mund të priret nga e keqja.

3. Nga lavdërimet apo shpërblimet ka raste që fëmijëve u hyn vetja në qejf. Prandaj duhet pasur shumë kujdes sepse dalin mjaft probleme që shpesh herë kalojnë pa u vënë re. Mes tyre po përmendim:

- Fëmija nuk duhet shpërblyer kur kryen një detyrë që është e natyrshme dhe e përditshme. Në se kryhen me rregull të gjitha punët e përditshme të shtëpisë, kryhen me rregull e me radhë detyrat mësimore, nderon e respekton të rriturit në familje apo te tjerët që vijnë përvizitë e të tjera veprime të zakonshme, fëmija duhet mësuar që për këto të mos presë shpërblim. Nuk duhet të lavdërohet fëmija për çdo punë të vogël që kryen, për çdo fjalë të thënë me vend, apo për përgjigje të drejta apo për sjellje të përditshme të hijshme. E pra ka shumë raste që orë e çast prindi u bën premtim fëmijëve edhe përgjëra krejt të rëndomta, krejt të zakonshme të cilat ai e ka përdetyrë t'i kryej.

- Në raste shpërblimesh fëmija e kupton se ai është i preferuar dhe shumë i nderuar mes tjerëve, por kjo e vë atë në një pozitë disi të privilegjuar në raport me të tjerët. Vërehet se vëllai apo motra, shoku apo shoqja e sheh disi vëngër fëmijën që shpërblehet qoftë edhe me një lavdërim. A keni vënë re që edhe fyhen, zemërohen, qajnë, e madje e shohin disi me sy të keq shokun apo vëllain që shpërblehet apo lavdërohet. Ka shumë rëndësi drejtësia e prindit apo e mësuesit para fëmijëve, në të

kundërt do të lindin shumë shqetësimë, prandaj do të ishte më mirë të mos jepej ai shpërblim për të cilin drejtësia është e dyshimtë.

- Ka tepër vlerë miratimi i veprimeve të fëmijëve me gjeste apo shprehje të mimikës se sa me fjalë. Një buzë-qeshje, një miratim me kokë, një përkëdhelje e lehtë shpesh është më e vlershme se shumë fjalë të tepërtë që jo rrallë i mërzisin fëmijët.

- Nganjëherë fëmijëve u bëhen dhurata si shpërblim i veprimeve të tyre. Këto bëhen nxitje për punë edhe më të mira por vihen re mjaft gabime. Fëmijëve u mbushet grushti me para dhe ai mësohet t'i shpenzojë ato pa kriter, pa dhimbje, nuk di se janë fituar me shumë vështirësi prej prindit. Madje ka fëmijë që u kërkojnë me këmbëngulje të holla nënave tash e parë e kështu ato mësohen pa farë rregulli në ekonominë familjare. Mendoni se sa do të shpenzojnë kur të rriten! Dhurata përfëmijët duhet zgjedhur me kujdes nga prindi, që ajo t'i përshtatet moshës apo nevojave të fëmijës. Në shumë familje ka aq lojëra të blera pa nevojë sa mund të furnizohej një kopsht fëmijësh, ka djem e vajza që kanë aq shumë rroba, sa treten sepse fëmija rritet shpejt dhe rrobat u falen të tjerëve. Por në se ka mjaft gjëra të tilla me tepriçë, ka pak libra, ka pak mjete lëvizore dhe lojëra që venë në punë mendjen apo shqisat e fëmijëve.

## Frenimi dhe ndëshkimi

Janë metoda që krijojnë tek fëmijët emocione negative dhe i nxisin t'iu shmanget veprimeve të papëlqyeshme. Në rastin më të mirë ata krijojnë një atmosferë të

papranueshme ndaj së keqes, së padrejtës, të ndaluarës, haramit. Kur kjo gjendje është e vetvetishme në ndërgjegjen e fëmijës dhe aq më tepër të familjes dhe të shoqërisë atëherë e keqja kuptohet më shpejt, nuk zë vend dhe dënohet nga opinioni ku jeton fëmija. Në se veprimet e papëlqyeshme nuk pranohen, bien në kundërshtim me veprimet e zakonshme të jetës për rreth, dënohen nga vetë fëmijët apo rrathi, atëherë në të gjithë këtë atmosferë të shëndetshme, e keqja luftohet më lehtë e më shpejt. Kemi thënë një herë tjetër se është më e lehtë të edukosh se sa të luftosh një të keqe që ka zënë vend në veprimtarinë e përditshme të fëmijëve. Në se edukatori (prindi apo mësuesi etj.) siguron mbështetjen e të gjithëve, kur të gjithë veprojnë njëlloj në një drejtim, atëherë veprimet e keqja të fëmijëve nuk pranohen, gjë që i bën ata të turpërohen e t'i ruhen së keqes.

Për të arritur këtë në veprimtarinë edukative të familjes ka shumë mjete, mes të cilave është edhe dënim, apo ndëshkimi. Prindi duhet të ketë të qartë se ka shumë ndryshime mes dënimive në edukatë dhe atyre në shtet, dënimive morale dhe atyre ligjore. Për një veprim të vogël të pamoralshëm ligji nuk të dënon. Për një grusht kumbulla që fëmija merr fshehtas në kopshtin e komshit, ai nuk dënohet nga ligja, por kur zihet me kumbulla në xhep është shumë e turpshme për atë fëmijë apo për prindërit e tij, morali apo opinioni shoqëror e dënon. Dënimet nga drejtësia jepen vetëm atëherë kur dikush shkel ligjin, kur kryen një vepër penale, kështu që shumë punë të mbrapshta mbesin pa u dënuar vetëm përfaktin se ligji nuk i përfshin, ndërsa në edukatë edhe një gjest, edhe një fjalë, edhe një veprim sado i vogël, dënohet dhe nuk pranohet nga një opinion i shëndoshë.

Në veprimtarinë edukative është e këshillueshme që ndëshkimi mundësishët të mos përdoret kurrë, sepse

edhe kur e dënojmë fëmijën duke e ndaluar nga vepri- met e padenja, kjo nuk do të thotë se ai u edukua. Fëmi- ja duhet të nxitet më fort që të veprojë mirë, duke i kri- juar kushtet e duhura që të mos punojë keq. Ju e veni re se nënët i kanë në maje të gjuhës ankimet, lutjet e madje edhe thuprën ndaj fëmijëve vetëm sepse ata nuk mbajnë mend porosinë e dhënë. Edhe kur i bije në mend, ai ha- bitet dhe nuk di si të veprojë, prandaj në vend që t'i thu- het mos kështu e mos ashtu, fëmija duhet ushtruar e më- suar se si të veprojë. Fëmijët pësojnë ndëshkime për shumë veprime ndaj të cilave shpesh nuk janë fare fajto- rë, për shumë prej tyre e kanë fajin vetë prindërit. Kjo nuk do të thotë që gabimet dhe fajet të anashkalohen, të merren për asgjë e të mos dënohen.

Kur fëmija gabon apo kryen një faj duhet që tek ai të ngjallet ndjesia e pendimit, ai duhet ta kuptojë fajin dhe të kërkojë falje, të bëjë teube (pendim). Nuk ka njeri që nuk gabon, gabojnë edhe të rriturit, por ka shumë rëndësi që fëmija dhe njeriu në përgjithësi ta kuptojë fajin, të pendohet dhe të nxitet për të mirë. Në të njëtin moment kur fëmija bën fajin, po atëherë tek ai lind kuptimi i fajit, lind pendesa, nxitet së brendshmi dëshira për të mos vepruar keq. Kush arrin të njohë, të kontrollojë, ta frenojë vetveten apo edhe të ketë ndjesinë e gabimit e të përmirësimit të tij, ka shumë mundësi të edukohet mbarë e mirë. Prindi duhet ta kuptojë se dënimet apo ndëshkimet që japidjanë ndërhyrje të jashtme ndaj fëmijës. Ai në shumë raste nuk pajtohet me ndëshkimin, e kundërshton atë, pra edhe dënimet nuk ndikojnë për mirë, përkundrazi nxisin ndjenjën e kundërshtisë, të kryeneçësisë në sjellje e veprime të ndaluara.

Në përdorimin e ndëshkimeve prindi duhet të ketë parasysh:

- Të shqyrtojë mirë se cili është shkaku i një munge se apo i një veprimi të papëlqyeshëm. Shpesh fëmijët nuk kanë vullnetin e duhur sepse vuajnë nga një sëmundje (shpirtërore apo trupore) apo nuk janë të aftë në kryerjen e detyrës. Disa veprime të gabuara, mungesa e vullnetit, harresa etj. që shpesh hasen në fëmijë mund të kenë si burim disa sëmundje, prandaj prindi duhet t'i shohë me shumë kujdes veprimet e fëmijës së vet dhe të këshillohet me mjekun. Ne kemi vënë re në shkolla fëmijë që kanë shikim apo dëgjim të dobët dhe fëmija ndonëse është rritur në gjirin e familjes, në prani të prindërve, kjo sëmundje nuk është hetuar. Jo çdo gabim i fëmijës vjen nga karakteri i dobët apo edukata e keqe. Për këtë mund të bëhet shkak një sëmundje, prandaj mendoni se sa hidhërim ndjen fëmija kur dënohet për diçka që nuk është fajtor.

-Kur fëmija nuk arrin të kuptojë fajin, kur nuk dallon cila është e mira apo e keqja, edhe po qe se bën ndonjë veprim të padenjë, ai nuk duhet dënuar. Kjo është koha që fëmija ka nevojë për mësim e për drejtim, për kujdes e mbikëqyrje nga prindi.

-Kur jepet ndëshkimi, duhet që fëmija ta qortojë gabimin. Në rastet kur përsëritet faji, ai duhet dënuar përsëri. Në shumë familje nuk ka konsekuençë në zbatimin e detyrimeve, të porosive, të urdhreve, të ndalesave. Shpesh bëhen dallime mes fëmijësh, ai që quhet i mirë edhe kur gabon i falet, ndërsa për tjetrin dënim i jepet me rreptësi. Kështu ngjet edhe në shkollë. Ka plot raste kur njëri ndalon e tjetri lejon, kjo ngjet jo vetëm brenda shtëpisë, por edhe mes familjes dhe shkollës, mes mësuesve dhe prindërve. Nuk duhet lejuar që ndër fëmijë të krijohet përshtypje se dënimet jepen vetëm kur t'i teket edukatorit.

-Nuk duhen dhënë dënimë kur prindi është i zemë-

ruar. Kur t'i kalojë gjendja e acaruar nervore, ai gjykon më i qetë dhe veprimi i fëmijës nuk duket dhe aq i keq. Dënimet e dhëna në zemërim e sipër mund ta kalojnë cakun e të ngjallin në zemrën e fëmijës pakënaqësi, mosbesim edhe kundërshti.

- Dënimet apo ndëshkimet duhen përdorë me radhë dhe pa teprime. Janë krejtësisht të ndaluara dënimet fizike. Në natyrën e shumë prindërve vjen më përshtat një thupër, një shpullë apo një ngrehje veshi. Madje ka një shprehje mjaft të njojur që “Thupra ka dalë prej Xhennetit”, me kuptimin që jep efektin në çast. Dënimet fizike ulin personalitetin e fëmijës, e fyejnë atë, në mjaft raste e poshtërojnë. Fëmijëve “u trashet lëkura” dhe kështu e marrin si me të lehtë dënimin, qeshin e tallen para prindërve, përpiken t'i zbusin me gjithfarë lajkash të cilat në shumë raste kanë efekt. Një edukator i madh ka thënë se: “Më lehtë ndreqet një asht i thyem se sa një zemër e ligështume”. Dënimet fizike thyejnë kryesisht zemrën e fëmijëve, cenojnë lirin e natyrshme që u ka falë Zoti xh.sh.

-Dënimet nuk duhen dhënë para të tjerëve. Prindërit në zemërim e sipër i fyejnë fëmijët pa marrë parasysh në se janë vetëm apo aty pranë ka miq e të afërm. Kështu ata tregojnë kryesisht paaftësinë që ta zotërojnë veten.

-Dënimet, sikurse këshillojnë disa edukatorë të mëdhënë, duhet të janë rrjedhojë e gabimit. Fëmija është këshilluar që të mos hajë kumbullat të papjekura. Ai i han. Fillon t'i dhëmbë stomaku. Ose prek shporetin, digjet. Nuk ka rregull në vendosjen librave apo të mjeteve tjera mësimore, i kërkon, nuk i gjen, vonohet, humbet shumë kohë të çmueshme për të filluar detyrat. Këto dënlime, janë krejt të natyrshme. Prej tyre fëmija, pa qenë nevoja e dënlimeve të jashtme, kupton lidhjen shkak-pasojë në mes gabimit dhe rrjedhimit. Kështu lidhet ngushtë

ndëshkimi me ndëshkuesin. Por kjo formë e dënimit nuk është e vlefshme në të gjitha rrethanat. Një fëmijë që mbyt një zog të vogël të pambrojtur apo një flutur që sa po e zë ia këput krahët, nuk ka si të presë dënim të natyrshëm. Kjo shprehje e egërsisë së tij duhet dënuar në forma tjera jo të natyrshme.

Të gjithë dënimet apo masat ndëshkimore kanë karakter edukativ, si të tilla duhen kuptuar nga vetë i dënuari (fëmija), por edhe nga rrathi familjar apo ai shoqëror. Përgjithësisht kur jepet një dënim nga prindi, bëhen përpjekje nga nëna, vëllezërit e motrat apo rrathi i afërm për falje, ka gjithfarë ndërhyrjesh dhe shpesh i arrihet qëllimit. Kjo krijon tek fëmijët një përvojë negative. Ata gjejnë strehë tek nëna, gjyshi apo gjyshja.

Të nderuat lexues! Ne trajtuam shumë probleme të edukatës familjare: parimet, përbajtjen dhe metodat e edukimit. Ne synuam që të japim një pamje të përgjithshme të problemeve duke theksuar se në vatrën familjare rriten breznitë e reja me virtute të larta, me besim të fortë, me mendje të ndritur e me zemër të pastër. Gjendja e edukatës islame sot ia rritë shumë përgjegjësinë prindërve, kjo nuk përmirësohet me qarje dhe ankesa, por me punë edukuese të pareshtur. Lusim të Madhin Zot që t'ua ndriçojë rrugën prindërve për të kuptuar de-tyrën e tyre para All-llahut dhe para atdheut të vet. E ardhmja e fesë islame dhe e ardhmja e ndritur e atdheut është në duart e breznive të reja që po rriten.

ISLAM DIZDARI  
BAHRI ALIU

EDUKATA FAMILJARE

Boton: Logos-A  
Biblioteka: Mendimi islam

Për botuesin: **Adnan Ismaili**  
Kryeredaktor: **Husamedin Abazi**  
Redaktor biblioteke: **Nexhat Ibrahim**


Redaktor artistik: **Edi Agagjyshi**  
Redaktor teknik: **Afrim Gashi**

Mbikëqyrës i shtypit: **Imer Gogjufi**  
Përgatitja kompjuterike: **Focus Pro - Shkup**  
Shtypi: **Focus - Shkup**

Copyright©Logos-A, 2007

Shënim i CIP katalogut i këtij libri gjendet  
në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare  
**ISBN 9989-58-216-5**

[Www.logos-a.com.mk](http://www.logos-a.com.mk)





ISBN 998958216-5



9 789989 582165

Copyrighted material